

KOMUNITETI MUSLIMAN I SHQIPERISE



E DREJTA ISLAME

(FIKH)

III

Tekst mësimor për shkollat e mesme fetare islame

KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË

E DREJTA ISLAME

(FIKH)

III

Tekst mësimor për shkollat e mesme fetare Islame

Përkthyes: Dr. MITHAT HOXHA

STAMBOLL, 2013

Përpunimi kompjuterik

dhe kapakët: Mustafa KAYAN

Shtypur në Shtëpinë Botuese ERKAM

Tel.0090 212 671 07 07

Tirazhi : 2.000

Viti i Botimit: Stamboll, 2013

Ky tekst është përgatitur nga një komision pranë
Qendrës së Studimeve Shkencore Islamike
Stamboll

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

PJESA I

FAMILJA NË ISLAM

ÇËSHTJET

- A. Rëndësia e familjes
- B. Dobitë e martesës
- C. Cilësitë themelore që duhet të ketë familja
- D. Rëndësia e edukimit të fëmijëve në familje

PUNË PËRGATITORE

1. A mund të bëhen popujt të qetë e të lumtur pa familjen?
Diskutojeni.
2. Ç'probleme krijohen në popujt ku përhapet prostitucioni?
Kërkoni ta mësoni.
3. Kush ka më shumë rëndësi për rritjen dhe edukimin e fëmijëve, familja apo mjedisi? Diskutojeni.

A. RËNDËSIA E FAMILJES

Familja është njësia më e vogël e shoqërisë dhe guri i themelit të saj. Ç'është qeliza te gjallesat, është edhe familja për shoqërinë. Në jetën e shoqërisë, mbrojtja, zhvillimi dhe fuqizimi i vlerave fetare, kombëtare, moral-etike si dhe i vlerave të tjera shoqërore realizohen me një familje të shëndoshë.

Familja është institucioni që i bashkon mashkullin me femrën të krijuar të dëshiruar për njëri-tjetrin, që i jep zemrës kënaqësi dhe trupit, prehje e qetësi. Familja është fusha e begatë ku ekspozohen dashuria, respekti, përgjegjësia, solidariteti dhe sakrifica. Allahu i Lartë na bën të ditur se qetësia dhe lumturia në familje të mbështetura në dashurinë dhe besimin reciprok, janë argument i madhështisë së Tij: **“Dhe njëri prej argumenteve të ekzistencës, fuqisë dhe forcës së Allahut është krijimi prej llojit tuaj i bashkëshorteve me të cilat ju gjeni qetësi dhe jetoni në lumturi. Ai vuri mes jush ndjenjat e dashurisë dhe dhembshurisë. Këtu ka argumente paralajmëruese për ata që mendojnë dhe vërtetuese të ekzistencës së Allahut!”**¹

Siç kuptohet nga ky ajet, kur njeriu martohet dhe bëhet zot familjeje, arrin tri dhunti, të cilat janë: qetësia ndjesore, dashuria dhe mëshira. Nga martesat e ngritura mbi dashurinë dhe mëshirën, formohen familje të lumtura dhe shoqëri të qeta.

Ndihma pa shpërblim dhe virtyti i plotësimit të nevojave të të tjerëve kanë shumë rëndësi për njeriun dhe shembulli më i mirë i kësaj mund të shfaqet në familje. Brezat e rinj i fitojnë këto vlera në mjedisin familjar. Për rrjedhojë, për formimin dhe përhapjen e virtyteve si dashuria, respekti, ndihma reciproke dhe solidariteti, shoqëritë e kanë të nevojshme të kenë një strukturë familjare të shëndoshë.

B. DOBITË E MARTESËS

Martesa ka shumë dobi. Një pjesë prej këtyre mund t'i radhisim me pika kështu:

1. Siguron vazhdimësinë e brezit. Sipas fesë sonë, synimi më i madh i martesës është shtimi i ummetit, bashkësisë së Hz. Muhammedit, që u del për zot vetes dhe shoqërisë dhe që përpiqet t'i çojë në vend urdhrat e Islamit. Duke e nxitur martesën në shumë hadithe, porosi të tij, Profeti ka bërë të ditur se, në Ditën e Kiametit, do të krenohet me shumicën e ummetit të tij.

1 Kurani, Err-Rrum: 21.

Në një ajet kuranor, Allahu i Lartë urdhëron: “...ata që thonë: “Zoti ynë, na jep neve nga gratë tona dhe fëmijët tanë pasardhës që të bëhen drita e syve tanë dhe na bëj ne prijës të të devotshmëve!”²

Këto argumente na tregojnë se synimi më i rëndësishëm i martesës është rritja dhe përgatitja e brezave të dobishëm.

2. Ia mbyll derën prostitucionit. Feja jonë ka vënë si parim mbrojtjen e këtyre pesë gjërave: mendjes, fesë, jetës, pasurisë dhe brezit. Për ta mbrojtur brezin, ka ndaluar me forcë adulterin, marrëdhënien seksuale jolegjitime. Në anën tjetër, duke inkurajuar martesën, ka vënë si synim rritjen dhe përgatitjen e brezave të shëndoshë shpirtërisht dhe trupërisht.

Martesa është rruga për t'u mbrojtur nga shejtani, djalli, dhe për te shpëtuar nga dëshirat epshore. Pa asnjë dyshim, mjetet më tërheqëse që përdor djalli për ta çorientuar njeriun dhe për ta larguar nga adhurimi ndaj Allahut, është epshi. Me anë të martesës, njeriu plotëson me rrugë hallall (të lejuara, të bekuara) dëshirën epshore që përmbahet në krijimin e tij. Bisedat dhe dëfrimet e bashkëshortëve me njëri-tjetrin u bëhen pengesë furisë dhe teprimeve ndjesore. Duke mos rënë në kurthin e djallit, ata i çojnë në vend urdhrat e fesë. Në lidhje me këtë, Profeti ka porositur kështu: “*Kush martohet, ka plotësuar gjysmën e fesë, kurse gjysma tjetër është të ketë frikë nga Allahu!*”

3. Mbron nderin e shoqërisë dhe siguron qetësinë e saj. Një tjetër dobi e martesës, e cila ushtron ndikim të madh për mbylljen e dyerve të hapura për adulterin, është mbrojtja e nderit. Njeriu që i plotëson dëshirat epshore me rrugë hallall (të lejuara, të bekuara), nuk u drejtohet rrugëve të palejuara, të pabekuara, nuk i vë syrin nderit të të tjerëve!

Bashkë me martesën, perversitetet seksuale mënjanohej e asgjësohen. Në popujt dhe shoqëritë ku s'ka martesë ose ku martesës s'i krijohen lehtësira, perversitetet shtohen, nderi mbetet nën kërcënim. Në përfundim të të gjitha këtyre, krimet dhe vetëvrasjet arrijnë kulmin. Si rezultat, shumë familje shemben ose bëjnë një jetë të trazuar e të tronditur. Ja, pra, për qetësinë dhe lumturinë e shoqërisë dhe individit, feja Islame ka ndaluar të gjitha rrugët jolegjitime dhe ka nxitur dhe inkurajuar martesën.

4. E nxit personin për bindje dhe adhurim ndaj Allahut. Adhurimet i vijnë të vështira vetes, egos. Po qe se egoja detyrohet të bëjë adhurime, tërbohohet dhe urren. Por, po qe se kohë pas kohe qetësohet me anë të kënaqësive hallall, fiton dëshirë dhe

2 Kurani, El-Furkan: 74.

gëzim ndaj adhurimeve. Biseda mes bashkëshortëve i qetëson zemrat dhe i heq shqetësimet. Nga afërsia dhe dashuria e formuar mes tyre, zemrat mbushen me prehje e qetësi. Në lidhje me këtë, Allahu urdhëron: **“Nga provat e Allahut është edhe krijimi i bashkëshorteve nga vetja juaj që të gjeni prehje me to, edhe krijimi mes jush i dashurisë dhe mëshirës. Pa dyshim, ne këto ka mësim për popujt që mendojnë!”**³

5. Martesa bëhet pretekst për ndarjen e hidhërimeve dhe gëzimeve. Njerëzit kanë nevojë për njerëz me të cilët të ndajnë hidhërimet dhe gëzimet. Të martuarit i ndajnë së bashku hidhërimet dhe gëzimet, e ndihmojnë njëri-tjetrit kur është nevoja, ia lehtësojnë shqetësimet njëri-tjetrit, kohët e vuajtjeve dhe dëshpërimeve i kthejnë në lumturi. Kurse meshkujt dhe femrat që bashkëjetojnë në mënyrë jolegjitime, kur plaken dhe u humbin bukuritë, e presin vdekjen të vetmuar dhe në mjerim.

6. Martesa është për bashkëshortët pretekst mirësish. Synimi më i madh i bashkëshortëve është që kohën e shkurtër mes lindjes dhe vdekjes ta kalojnë duke bërë punë që fitojnë pëlqimin e Allahut. Martesa është burim mirësish meqë është mjet për mbylljen e rrugëve të hapura ndaj haramit (akteve dhe produkteve të dëmshme, të palejuara, të pabekuara, të ndaluara), për pengimin e meshkujve dhe femrave që të mos bien në haram, për plotësimin e dëshirave epshore në rrugë të lejuara dhe për mbrojtjen e nderit. Veç këtyre, martesa është pretekst për fitim mirësish në çështje të tilla si plotësimi nga burri i nevojave të gruas, plotësimi nga gruaja i kërkesave legjitime të burrit, interesimi për fëmijët, etj.

7. Martesa rrit vlerën e femrës. Islami e rrit vlerën e femrës dhe bën që ajo të fitojë identitetin e saj të vërtetë. Në shoqëritë para Islamit femra nuk kishte asnjë vlerë. Femra përdorej si mjet epshi dhe reklame. Me Islamin, femra fitoi identitetin e saj të vërtetë, u bë zonja e shtëpisë dhe nëna e fëmijëve, u bë pjesëtare e respektuar e shoqërisë.

Islami nuk është mjaftuar vetëm me lartësimin e nderit të femrës, por edhe ka mbrojtur të gjitha të drejtat e saj shoqërore. Në këtë kuptim, martesa është nga mjetet dhe faktorët që e rrisin vlerën e femrës dhe i sigurojnë asaj që të fitojë të drejtat që i takojnë. Në sajë të së drejtës që i jep martesa femrës, të drejtat që fiton ajo gjatë martesës ose pas marrjes fund të saj, janë përcaktuar në Kuran dhe Sunnet. Në asnjë mënyrë femra nuk mbetet e dëmtuar.

Veç dobive që u përmendën gjër këtu, martesa ka edhe shumë dobi të tjera. Një pjesë e tyre janë: mbrojtja në pleqëri, përfitimi nga martesa dhe falënderimi për këtë, shijimi i dashurisë së fëmijës, pengimi i lindjes së fëmijëve jolegjitimë, ndihma reciproke në punët e shtëpisë, shtimi i fisit dhe edukimi i egos.

3 Kurani, Err-Rrum: 21.

C. CILËSITË THEMELORE QË DUHET TË KETË FAMILJA

Islami ka vënë disa parime për anëtarët e tij që do të krijojnë familje. Në kuadrin e këtyre parimeve, cilesitë kryesore që duhet të ketë një familje myslimane janë këto:

1. Sipas Islamit, para së gjithash, familja mbështetet mbi një kurorë legjitime. Institucioni i kurorës është ruajtur në të gjitha fetë qiellore dhe në to janë vendosur një sërë parimesh në lidhje me martesën. Islami nuk i ka quajtur familje ata që bashkëjetojnë pa kurorë, dhe i ka nxitur për martesë. Kështu, besimtarët që ngrenë familje me anë të martesës legjitime, mbrohen edhe nga marrëdhëniet jolegjitime dhe prostitucioni, dhe nga një sërë sëmundjesh, që e kanë burimin prej marrëdhënieve jolegjitime dhe prostitucionit. Me anë të martesës parandalohen edhe ngatërresat faktike dhe ligjore që kanë të bëjnë me gjenealogjinë, birësinë dhe pasojat e tyre civile, trashëgimore, etj. Profeti ka thënë: *“Janë katër gjëra nga tradita e profetëve: ndjenja e turpit, lyerja me erëra të mira (aromatike), pastrimi i dhëmbëve (me misvak) dhe martesa.”*

2. Synimi: pjesëtarët e familjes të kenë një besim të shëndoshë dhe të bëjnë punë të mira. Në lidhje me këtë, Islami i ka ngarkuar kryetarit të familjes përgjegjësi. Allahu i Lartë urdhëron: **“O ju që keni besuar, mbrojeni veten dhe familjen nga zjarri, lëndë e të cilit janë njerëzit dhe gurët!”**⁴ Kurse Profeti na ka porositur: *“Secili prej jush jeni një çoban dhe përgjigjeni për tufën tuaj. Kryetari i shtetit (imami) është një çoban dhe ka përgjegjësi për njerëzit që drejton. Burri është çobani i familjes dhe përgjigjet për pjesëtarët e saj. Gruaja është çobaneshë e shtëpisë dhe përgjigjet për njerëzit brenda shtëpisë, për punët, shërbimet dhe mirëmbajtjen e saj. Shërbëtori është çoban i mallit të të zot dhe përgjigjet për përdorimin e mirë të tij.*

Është e domosdoshme që prindërit t'i rrisin dhe përgatisin fëmijët sipas natyrës Islame me të cilën kanë lindur, dhe për jetën e pasosur. Hadithi profetik thotë kështu: *“Çdo fëmijë lind me natyrë Islame, pastaj prindërit e bëjnë atë çifut, të krishterë ose zoroastrian!”* Pasi e ka përcjellë këtë hadith, Ebu Hurejre ka kënduar këtë ajet: **“O Muhammed! Ktheje ti fytyrën nga feja e drejtë (hanif), nga natyra me të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. Në krijimin e Allahut nuk ka asnjë ndryshim. Ja, kjo është feja e vërtetë, por shumica e njerëzve nuk e dinë!”**⁵

3. Marrëdhëniet burrë-grua mbështeten në parimin e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit të dyanshëm. Lart e përcakton kështu domosdoshmërinë e mbështetjes së familjes në parimin e “mirëkuptimit të dyanshëm”: **“Shkoni mirë me**

4 Kurani, Et-Tahrim: 6.

5 Kurani, Err-Rrum: 30.

bashkëshortet tuaja. Po qe se nuk ju pëlqejnë ato, dijeni se nuk do t'ju pëlqejë edhe një gjë që Allahu do ta bënte shumë të mbarë në dobinë tuaj!”⁶

I Dërguari i Allahut ka porositur kështu: “*Më i dobishmi ndër ju është ai që është më i dobishëm për familjen e vet. Edhe unë jam i dobishëm për “familjen time!”* Profeti kishte marrëdhënie shumë të mira me bashkëshortet e tij. Ai sillej gjithmonë fytyrëqeshur dhe gjuhëmbël. Ai i lavdëronte pjesëtarët e familjes duke nxjerrë në pah cilësitë e tyre të mira. Hz. Aisheja e tregon kështu garën e vrapimit që kishte bërë Profeti me të: “I Dërguari i Allahut pati bërë garë vrapimi me mua dhe unë e pata kaluar. Kjo pati ndodhur një radhë kur unë isha e dobët. Por më vonë, kur pata shtuar në peshë, ai ma pati kaluar!”

Bashkëshortët që vendosin të jetojnë një jetë të tërë së bashku, duhet t’ia dinë vlerën njëri-tjetrit dhe të përpiqen për të fituar pëlqimin e Allahut të Lartë duke respektuar parimet e përcaktuara nga Islami me mirëkuptim dhe sakrificë të dyanshme.

4. Marrëdhëniet mes prindërve dhe fëmijëve mbështeten në parimin e dashurisë dhe respektit të dyanshëm. Profeti sillej me shumë dhembshuri dhe mëshirë ndaj fëmijëve dhe nipërve të vet si dhe ndaj fëmijëve të sahabëve. Edhe sahabët, shokët, i nxiste të silleshin kështu. Siç rrëfen Hz. Aisheja, te Profeti kishte shkuar një arab dhe i kishte thënë: “Ju i puthni dhe i perkëdhelni fëmijët tuaj, kurse ne, jo!” Dhe Profeti i ishte përgjigjur: “*Ç’mund të bëj unë nëse Allahu ta ka nxjerrë mëshirën nga zemra?’*

Nga ana tjetër, edhe fëmijët duhet t’u tregojnë prindërve dashurinë, respektin dhe bindjen e duhur. Kjo gjë fiton rëndësi të veçantë në pleqëri të tyre. Allahu i Lartë urdhëron: “**Zoti yt ju urdhëron ta adhuron vetëm Atë dhe të silleni mirë me prindërit. Po qe se njëri prej tyre ose të dy plaken pranë teje, të mos u thuash as “of”, të mos i qortosh, por t’u thuash të dyve fjalë të mira. Hapi krahët me bujari dhe kokulësi mbi ta dhe lutu: “Zoti im, mëshiroji ata siç më patën mëshiruar ata mua kur isha i vogël dhe më rritën!”**”⁷

Ndërkaq, nuk duhet harruar se respektimi i urdhrave të dhëna nga njerëzit është kusht që të mos bjerë në kontradiktë me urdhrat dhe ndalimet e Allahut. Edhe bindja ndaj prindërve mbështetet mbi këtë parim.

5. Në familje, në hyrje-daljet në shtëpi respektohen disa rregulla të caktuara të etikës dhe edukatës. Para se të hyhet në shtëpi, lajmërohet duke i rënë ziles, kur hyhet brenda jepet selam (përsëndetet), pyeten njerëzit e shtëpisë për shëndetin, etj., fëmijët nuk hyjnë pa leje në dhomën e gjumit të prindërve; këto janë disa nga rregullat e etikës dhe edukatës brenda shtëpisë dhe familjes.

6 Kurani, En-Nisa: 19.

7 Kurani, El-Isra': 23-24.

D. RËNDËSIA E EDUKIMIT TË FËMIJËVE NË FAMILJE

Sigurimi i të ardhmes së shoqërisë varet nga rritja dhe përgatitja e pasardhësve të mirë dhe bijve të dobishëm që u rrahin zemrat me dashurinë për Allahun. Islami që prodhon zgjidhje për çdo çështje me një trajtim të gjithanshëm të saj, është përqendruar me konsekuencë edhe mbi çështjen e rritjes dhe përgatitjes së pasardhësve të dobishëm. Allahu i Lartë urdhëron: **“O ju që keni besuar, ruajeni veten tuaj, gratë dhe fëmijët tuaj nga zjarri i xhehennemit, lënda e të cilit janë njerëzit dhe gurët!”**⁸ Pas zbritjes së këtij ajeti, Hz. Omeri pyeti:

“O i Dërguari i Allahut, e dimë se duhet ta ruajmë veten nga ndëshkimi i xhehennemit duke iu bindur urdhrave të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij, por nuk e dimë se si duhet t'i ruajmë gratë dhe fëmijët!”

I Dërguari i Allahut iu përgjigj: *“Po qe se i urdhëroni ata me urdhrat e Allahut dhe i ndaloni për ato gjëra që i ka ndaluar Allahu, kjo sjellja juaj bëhet pretekst që ata të ruhen nga xhehennemi!”*

Fëmijët janë amanet në duar të prindërve. Zemrat e pastra dhe të kulluara të fëmijëve janë margaritarë, janë si dheu. Ç'të mbjellësh në tokën e pastër, atë do të korrësh. Mbrojtja e fëmijëve nga zjarri i xhehennemit ka më rëndësi se mbrojtja nga zjarri i kësaj bote. Mbrojtja nga zjarri i xhehennemit bëhet duke u mësuar fëmijëve besimin, farzet (detyrimet fetare) dhe haramet, duke i praktikuar me adhurim dhe duke i ruajtur nga mjediset larg fesë dhe moralit.

Nëna dhe babai janë për fëmijën modeli më i bukur që, si një libër i gjallë, praktikon rregullat e moralit. Allahu i Lartë urdhëron: **“Urdhëroje familjen të falin namaz. Edhe ti vazhdo me namaz!”**⁹ Në këtë urdhër hyjnor që, në personin e Profetit, i drejtohet gjithë ummetit, bashkësisë së myslimanëve, Allahu i Lartë tregon se rruga e rritjes dhe përgatitjes së fëmijëve të dobishëm është të bëhesh shembull dhe model për ta dhe të veçosh kohë për t'u marrë me ta. Kështu, pas zbritjes së këtij ajeti, Profeti, një muaj me radhë pati shkuar çdo mëngjes në shtëpinë e së bijes Fatime për t'i bërë zë, “ngrihuni në namaz!” Sepse çdo njeri përgjigjet për ata që ka nën përgjegjësi, sepse është përgjegjës për edukatën dhe virtytet e tyre. Në lidhje me këtë çështje ka shumë urdhra fetare:

“Trajtojini fëmijët me bujari dhe mirësi, sepse ata janë dhuratë e Allahut për ju!”

“Gruaja myslimane që merret në shtëpi me edukimin e fëmijës së saj, është bashkë me mua në xhennet!”

8 Kurani, Et-Tahrim: 6.

9 Kurani, TaHa: 132.

T'i edukosh fëmijët do të thotë t'i rritësh ata si bij të dobishëm dhe anëtarë të shoqërisë si njerëz myslimanë. Profeti na porosit: *“Asnjë nënë ose baba nuk i ka dhënë fëmijës gjë më të dobishme se morali i bukur!”*

Kurani i përmbledh kështu në porosinë e Lukmanit për të birin vetëdijen e robit ndaj Zotit dhe identitetin shoqëror që kërkohet t'i rrënjosen fëmijës i cili kërkohet të bëhet pasardhës i dobishëm:

“Biri im, kryeje namazin ashtu siç duhet dhe përhape mirësinë! Përpiqu ta pengosh të keqen dhe duroji të këqijat që mund të të bien mbi kokë! Këto janë punë që kërkojnë vendosmëri dhe qëndresë. Mos u sill me mendjemadhësi dhe mos i shih njerëzit me mospërfillje. Kur të ecësh rrugës, mos ec duke u mbajtur me të madh, sepse Allahu s'i do njerëzit që mbahen me të madh dhe lavdërohen!”¹⁰



10 Kurani, Lukman: 17-18.

Lexim letrar

Mirëkuptimi në familje

Mirëkuptimi në familje

“Gruaja që vdes pasi ka jetuar me mirëkuptim me burrin, është për në xhennet!”

Vajza me emrin Esma, e bija e Jezidit nga sahabet, ishte një zonjë që fliste drejt dhe bukur. Një ditë, gratë e sahabëve e zgjodhën Esmanë si përfaqësuese të tyre për ta dërguar te Profeti me qëllim për të mësuar mbi një çështje që u interesonte. Esmaja shkoi te Profeti dhe i tha:

“Nënë e babë t’u bëfshin kurban, o i Dërguari i Allahut! Unë jam përfaqësuese e grave që me zgjodhën e më dërguan tek ti. Allahu i Lartë të ka dërguar ty përfaqësues të të gjithë burrat dhe gratë. Ne të shprehëm besimin ty dhe Zotit tënd. Por ne, si gra, mbetemi mbyllur në shtëpitë tuaja. Ju plotësojmë dëshirat seksuale. Mbajmë në bark fëmijët tuaj. Kurse ju, burrat, keni shumë përparësi ndaj nesh, sepse falni namazin e xhumasë, shkoni në xhami me xhemaat, vizitoni të sëmurët, merrni pjesë në përcjelljen e të vdekurve, shkoni në haxh shumë herë me radhë dhe, më e rëndësishmja, luftoni në rrugën e Allahut! Veç kësaj, është edhe një e vërtetë tjetër që, kur ju dilni nga shtëpia për haxh ose umre ose për të luftuar kundër mohuesve, ne jua ruajmë mallin e pasurinë, endim rrobat tuaja, ushqejmë fëmijët tuaj. Atëhere, a s’na takon ne pjesë nga e mira e punëve të mira që bëni ju?”

Esmaja kishte folur shumë bukur. Pasi e degjoi me vëmendje gjer në fund, Profeti u kthye nga sahabët që ndodheshin të pranishëm aty dhe u tha:

‘A keni dëgjuar ju fjalë më të bukur nga një grua që bëri një pyetje mbi fenë?’

Pastaj Profeti i tha kështu Esmasë:

“O Esma, kuptoje mirë këtë dhe tregojua edhe grave që të kanë dërguar, se mirëkuptimi i një gruaje me burrin dhe fitimi i pëlqimit dhe kënaqësisë së tij vlen si mirësi sa të gjitha ato adhurime që përmende ti!”

Esmaja që mori përgjigjen që kërkonte, bëri një lutje dhe u largua.

Duhet qëndruar me vëmendje dhe duhet menduar gjatë e gjerë mbi këtë mesazh që u solli, në emër të grave të sahabëve, gjithë grave myslimane Esmaja, gruaja e njohur si ligjëruesja e grave, e cila, në luftën e Jermukut pati shkullur një çadër dhe, me shkopin qendror të saj pati vlarë nëntë bizantinë! Pra, gruaja që rri në shtëpi dhe kryen detyrat e përmendura nga Esmaja, fiton po aq mirësi sa ç’fitojnë burrat që i kryejnë ato detyra që i përshkroi përsëri po ajo!



PËRMBLEDHJE

1. Shpjegoni vendin dhe rëndësinë e familjes në shoqëri.
2. Thoni me pika dobitë e martesës.
3. Cilat janë cilësitë themelore që duhet të ketë familja?
4. Tregoni rëndësinë e edukimit të fëmijës në familje.

PJESA II

KURORA DHE SHKURORËZIMI

ÇËSHTJET

- I. KURORA (NIKAH)
 - A. Termi dhe kuadri i kurorës (nikah)
 - B. Argumentet mbi legjitimitetin e martesës
 - C. Kushtet e vlefshmërisë së kurorës
 - D. Të drejtat dhe përgjegjësitë e lindura nga martesë legjitime
 - E. Mehri dhe nafaka
- II. SHKURORËZIMI (TALAK)
 - A. Shkurorëzimi me kthim të mundshëm ose të pamundshëm
 - B. Shkurorëzimi sipas rregullave e jo sipas rregullave
 - C. Shkurorëzimi me kundërshtpërblim
 - D. Zgjidhja e martesës

PUNË PËRGATITORE

1. Kërkoni të mësoni rëndësinë e institucionit të familjes
1. Si formohet familja?
1. Në ç'kushte dhe me ç'mënyra e mjete mund t'i jepet fund një familjeje të formuar?
1. Cilat janë detyrat e bashkëshortëve dhe fëmijëve ndaj njëri-tjetrit?

A. TERMI DHE KUADRI I KURORËS (NIKAH)

Fjala arabishte “nikah” si paskajore e foljes “nekeha”, do të thotë lidhje martësore mes një mashkulli dhe një femre që i plotësojnë kushtet për t'u martuar. Martesa është akti kontraktual që bëhet mes një mashkulli dhe një femre që nuk e kanë të ndaluar ligjërisht (fetarisht) për t'u martuar dhe që krijon lidhjen e duhur për bashkëjetesë dhe vazhdim të brezit.

Në Islam, akti kontraktual i kurorës është edhe një trajtim qytetar, edhe një adhurim, sepse Islami i përcakton elementet përbërës dhe kushtet e kurorës dhe premton se, si rrjedhojë e kurorës dhe martesës, bashkëshortet do të marrin shpërblime shumë të mëdha.

B. ARGUMENTET MBI LEGJITIMITETIN E MARTESËS

Legjitimiteti i martesës mbështetet mbi argumentet e Kuranit, Sunnetit dhe mendimit të njëzëshëm të autoriteteve (ixhma).

Në Kuran urdhërohet kështu:

“Martojini beqaret dhe sklevërit tuaj me skllavet dhe shërbëtoret tuaja të ndershme. Nëse janë të varfër, Allahu i pasuron me bujarinë dhe mirësinë e Tij. Allahu di çdo gjë dhe ka fuqi për çdo gjë!”¹

Janë përcjellë shumë hadithe mbi martesën. Duke iu drejtuar të rinjve, i Dërguari i Allahut i ka porositur kështu:

“O ju të rinj! Kush t'i plotësojë përgjegjësitë e martesës, të martohet, sepse martesa e mbron më shumë syrin dhe nderin ndaj haramit. Por kush të mos ketë mundësi për t'u martuar, të agjërojë, sepse agjërimi është mburojë!”

Tre vetë nga sahabët i kishin pyetur gratë e Profetit mbi adhurimet që bënte ai natën. Pastaj ata i kishin shtuar shumë adhurimet e tyre. Njëri kishte vendosur të falte namaz gjithë natën, tjetri, të agjëronte ditë për ditë, i treti, të mos martohej asnjëherë. Profeti që kishte dëgjuar se ç'kishin biseduar dhe vendosur tre shokët, tha kështu: *“Disa kanë thënë kështu e ashtu... Por unë edhe fal namaz, edhe fle; agjëroj, por ndodh edhe që të mos agjëroj. Unë martohem dhe krijoj familje. Kush e braktis sunnetin tim, s'është nga të mijtë!”*

1 Kurani, En-Nur: 32.

C. KUSHTET E VLEFSHMËRISË SË KURORËS

Kurora realizohet me anë të kërkesës dhe pranimit. Kërkesa bëhet nga njëri prej bashkëshortëve, p.sh., nga burri, në këtë formë: “Po të marr ty si grua me kurorë!” Kurse gruaja përgjigjet: “Edhe unë po vi tek ti si gruaja jote me kurorë”.

Që kurora të jetë e vlefshme, duhen plotësuar këto kushte:

1. Gruaja nuk duhet të jetë ndër femrat me të cilat burri që ka për të marrë ajo, e ka të ndaluar (haram) të martohet, të cilat janë këto:

a- Nëna dhe gjyshet nga nëna dhe babai.

b- Vajzat si dhe mbesat nga të bijtë (nga vajzat dhe djemtë).

c- Motrat si dhe mbesat nga motrat dhe vëllezërit.

d- Hallat.

e- Tezet.

f- Vjehrra.

g- Thjeshtrat (vajzat e gruas me burrin e parë).

h- Nuset e djemve.

j- Femrat idhujtare, femrat adhuresse të zjarrit dhe yjeve.

Përgjithësisht:

k- Lejohet (është xhaiz) martesa e meshkujve myslimanë me femrat krishtere dhe hebreje, por nuk lejohet (nuk është xhaiz) martesa e femrave myslimane me meshkuj krishterë dhe hebrej.

l- Burri i martuar me njerën prej dy motrave, nuk mund të martohet me kumatën (motrën tjetër) pa u ndarë nga gruaja e vet ose pa i vdekur ajo.

m- Gruaja e martuar nuk mund të bëjë një martesë të dytë pa u ndarë nga burri që ka ose pa i vdekur ai.

2. Mes burrit dhe gruas nuk duhet të ketë vëllazëri qumështi

a) Vëllazëria e qumështit

Po qe se një grua tjetër veç nënës i jep gji një fëmije gjer në dy vjet, ajo bëhet nëna e tij e qumështit, kurse djemtë dhe vajzat e saj bëhen vëllezërit dhe motrat e tij të qumështit.

Në lidhje me këtë, në Kuran thuhet:

“(Edhe) nënat tuaja të qumështit janë haram për ju.”²

b) Kushtet e realizimit të vëllazërisë së qumështit:

a- Fëmija që pi gji nuk duhet t'i kapërcejë dy vjetet. Për fëmijët që vazhdojnë të pijnë edhe pas moshës dy vjeç, nuk ka ndonjë vlerë.

b- Qumështi duhet të zbresë në stomak nëpërmjet gojës dhe hundës. Nuk ka vlerë qumështi i pikuar në vesh ose në plagë ose i shtënë në trup me anë të shiringës. Nuk ka ndryshim nëse qumështi i gruas i jepet fëmijës nga gjiri apo nëpërmjet një ene. E rëndësishme është që ky qumësht të kalojë në stomakun e fëmijës nëpërmjet gojës dhe hundës.

c- Qumështi i gruas nuk duhet të përzihet me ndonjë gjë tjetër. Po qe se në qumështin e gruas është përzierë ndonjë lëng tjetër, për vlerësim merret për bazë sasia. Po qe se qumështi është në sasi më të madhe ose të barabartë me lëngun tjetër, përzierja konsiderohet qumësht; po qe se lëngu tjetër është në sasi më të madhe, përzierja konsiderohet lëng tjetër, për rrjedhojë, vëllazëria e qumështit nuk realizohet.

d- Po qe se qumështi i gruas i jepet fëmijës i përzierë me ushqim, vëllazëria e qumështit nuk realizohet.

e- Vëllazëria e qumështit realizohet pavarësisht nga sasia e qumështit të pirë nga gjiri i gruas. Vëllazëria e qumështit quhet e realizuar sikur fëmija ta ketë thithur gjirin qoftë edhe një herë.

c) Konkluzioni mbi thithjen e gjirit

Konkluzioni mbi thithjen e gjirit është, me pak përjashtime, si konkluzioni mbi afërsinë e gjakut. Kjo do të thotë që ndalimet martesore për shkak të afërsisë së qumështit janë, me pak përjashtime, po ndalimet martesore për shkak të afërsisë së gjakut.

Profeti (a.s.) ka thënë:

“Ato që janë të ndaluara për soj, janë të ndaluara edhe për qumësht!”³

Si rregull:

Gruaja që jep gji, bëhet e ndaluar për sojin (të afërmit në gjak) e fëmijës që i jep gji, kurse fëmija që pi gji, bëhet i ndaluar për gruan që i ka dhënë gji. Sipas kësaj, gru-

2 Kurani, En-Nisa: 23

3 Buhari, Nikah, 20.

aja që i jep gjë një fëmijë, bëhet nëna e tij e qumështit. Për rrjedhojë, të gjithë fëmijët (të vetë apo të huaj) që u ka dhënë gjë kjo grua para tij e që mund t'u japë gjë pas tij, janë ose bëhen vëllezër (vëllezër e motra) qumështi të tij. Kështu, një mashkull, siç nuk mund të martohet me nënën dhe motrat e tij të gjakut, nuk mund të martohet as me nënën dhe motrat e tij të qumështit. Por një mashkull mund të martohet me nënën e qumështit, motrën e qumështit dhe hallën e qumështit të djalit të vet.

3. Kurora nuk duhet të jetë e përkohshme

Kurorat e përkohshme (muvakkat dhe mut'a) nuk janë të lejueshme (xhaiz).

Këto kanë qenë kurora të praktikuara para Islamit. Profeti i pati ndaluar në mënyrë të prerë dhe të përjetshme këto kurora të përhapura në shoqërinë e asaj kohe.

4. Marrëveshja e kurorës nuk duhet bërë pa dëshmitarë

Është kusht që në lidhjen e kurorës të marrin pjesë më e pakta dy dëshmitarë. Kurora e lidhur pa dëshmitarë është e pavlefshme.

Si përfundim, pasi mashkulli dhe femra që nuk kanë ndonjë pengesë për të lidhur kurorë mes tyre, të deklarojnë në prani të dëshmitarëve se e kanë pranuar njëri-tjetrit për bashkëshortë, martesë realizohet formalisht dhe, pasi plotësohen edhe aktet zyrtare që vërtetojnë bashkëshortësinë mes tyre, martesë realizohet zyrtarisht.

D. TË DRETAT DHE PËRGJEGJËSITË E LINDURA NGA MARTESA LEGJITIME

Akti i martesës që i ka të plota të gjitha kushtet dhe elementet, bëhet i detyruar për palët. Akti i martesës i lidhur në prani të dy dëshmitarëve nga mashkulli mysliman i rritur dhe me zhvillim mendor normal me femrën myslimane të rritur e me zhvillim mendor normal, mes të cilëve nuk ekziston ndonjë pengesë martesë, bëhet efektiv dhe shkakton këto përfundime:

1. Bën të lejueshëm që, brenda kriterëve Islame, bashkëshortët të përfitojnë nga veçoritë seksuale të njëri-tjetrit.

2. Me martesën, gruaja fiton të drejtën e prikës.

3. Gruaja fiton të drejtën e ushqimit, veshmbathjes dhe banesës.

4. Secili nga bashkëshortet bëhet i afërt në gjak në brezni të parë e të dytë në vijë të drejtë me njerëzit e bashkëshortit tjetër. Sipas kësaj, burri i martuar me një grua, nuk mund të martohet me nënën ose gjyshet e saj si dhe me bijat ose mbesat e saj. Gjithashtu, gruaja e martuar me një burrë, nuk mund të martohet me të atin ose gjyshërit e tij si dhe me djemtë dhe nipërit e tij. Ky ndalim vazhdon edhe nëse martesë ndërpritet me ndarje ose vdekje.

5. Birësia e fëmijëve përcaktohet nga babai.

6. Vazhdimi i trashëgimisë mes bashkëshortëve. Po qe se njëri nga bashkëshortët vdes ndërsa martesë vazhdon, ose vdes ndërsa pret plotësimin e periudhës së pritjes në ndarjen e kthyeshme, ose gruaja e ndarë me ndarje të pakthyeshme e burrit të sëmurë në shtratin e vdekjes, vdes ndërsa pret plotësimin e periudhës së pritjes, bashkëshorti tjetër bëhet trashëgimtar.



Lexim letrar Detyrat në familje

A. Detyrat e gruas. Gruaja duhet:

1. Të jetë e bindur ndaj burrit dhe të kalojë mirë me të.
2. Të sillet mirë me nënën dhe familjen e burrit.
3. Ta dojë burrin dhe të përpiqet për të fituar pëlqimin e tij.
4. Të mos i zbulojë të fshehtat e burrit, të mos ta përgojë dhe tallet me të.
5. T'i japë mbështetje burrit, të bëhet pjesëtare e pikëpamjeve të tij.
6. Ta nxisë burrin për të dhënë në rrugën e Allahut.
7. Ta ndihmojë burrin në çështjen e bindjes ndaj Allahut.
8. Të tregojë kujdes për veshjen e saj dhe të zbukurohet vetëm për të shoqin.
9. Ta presë dhe përcjellë burrin me buzë të qeshur dhe gëzim.
10. Të ndajë me burrin gëzimet e hidhërimet.
11. Ta mbrojë nderin dhe dinjitetin e tij.
12. Të mos bisedojë me burrin për gratë e tjera.
13. T'i sigurojë burrit prehje e qetësi.
14. Të përpiqet të tregojë mirëkuptim dhe falje.
15. Të ketë një personalitet të fuqishëm dhe punët e saj të jenë me vend.
16. Të tregojë ndjeshmërinë e duhur në pastërti dhe gatim.
17. Të jetë e suksesshme në punët e shtëpisë dhe administrimin e saj me ekonomi.
18. Të përpiqet t'i rrisë fëmijët në bazë të edukatës Islame.
19. Të marrë leje prej burrit atje ku duhet.

20. Të shmangët nga debatet e panevojshme dhe kritika.
21. Ta respektojë dhe gostisë mikun apo vizitorin që u shkon në shtëpi.

B. Detyrat e burrit. Burri duhet:

1. Në jetën martesore të mos largohet nga rruga e përvijuar nga Islami.
2. Të punojë dhe përpiqet për të siguruar jetesën e familjes.
3. Të ushqejë dashuri ndaj gruas dhe të tregohet besnik ndaj saj.
4. Të bisedojë me gruan dhe të tregohet i gëzuar në shtëpi.
5. Të dijë t'i vlerësojë sjelljet e mira të gruas.
6. Të mos ndjekë gjërat e ndaluara (haram) dhe të kujdeset të jetë i ndershëm.
7. Të jetë i durueshëm, i mirëkuptueshëm dhe falës.
8. Të merret me edukimin dhe arsimimin Islam të anëtarëve të familjes.
9. Të sillet me arsye dhe mirëkuptim ndaj gruas.
10. Ta mbështesë dhe ndihmojë gruan.
11. Ta kënaqë edhe nënën, edhe gruan.
12. Të marrë pjesë në hidhërimin e gruas dhe ta ngushëllojë dhe qetësojë atë.
13. Të tregojë respekt ndaj të afërmeve të gruas dhe t'u bëjë vizitë atyre.
14. Ta mbrojë intimitetin e familjes.
15. Të mos flase keq për gruan dhe punët e saj.
16. Ta bëjë zakon që të lutet për pjesëtarët e familjes.
17. T'i japë rëndësi veshjes dhe pastërtisë së vet para gruas.
18. Të tregojë dashuri për fëmijët në familje dhe të luajë e bëjë shaka me ta.
19. Të mos shmangët nga këshillimi me gruan.
20. Të përpiqet ta ndihmojë gruan në punët e shtëpisë.
21. Të shmangët nga debatet dhe kritikën.

E. MEHRI DHE NAFKA

1. Mehri

Mehri ose prika është dhurata në monedhë ose mall që i bën burri gruas në martesë. Mehri nuk është kundërvlera e gruas ose shpërblimi i mundësisë për të përfutur prej saj, por shenjë simbolike e dëshirës për të bashkëjetuar një jetë të tërë, shenjë simbolike e kërimit të dorës së gruas nga burri.

a) Konkluzioni juridik i mehrit

Mehri ose prika është e drejta pasurore që i siguron gruas mundësi materiale për të mos rënë në gjendje të vështirë gjatë martesës ose pas ndërprerjes së saj. Allahu i Lartë urdhëron: **“Jepeni mehrin e grave që moret me gjithë zemër dhe si një dhuratë të Allahut. Po qe se ato ju falin diçka juve me pëlqim, hajeni me shëndet!”**⁴

b) Lloji dhe masa e mehrit

Çdo gjë, shitja ose përdorimi i së cilës në Islam nuk është i ndaluar, mund të jepet si mehr ose prikë. Por nuk mund të vlejë si mehr gjëra të tilla të ndaluara nga Islami, si pijet alkoolike, mishi i derrit ose mishi i kafshëve të ngordhura.

Kufiri më i ulët i masës së mehrit ose prikës është vlera monetare e dy deleve (ose deshve) që vlejë për kurban. Kjo masë është për atë që e ka këtë mundësi. Kështu, një personi nga sahabët, shokët e tij, i cili dëshironte të *martohej me një grua, Profeti i pati kërkuar disa gjëra, por, kur e pati parë sa i varfër ishte, i pati thënë të kërkonte në shtëpi qoftë edhe një unazë hekuri e ta sillte*. Dhe, kur personi s'e kishte sjellë as këtë, Profeti e pati martuar duke konsideruar si mehr, prike, pjesën që dinte përmendësh nga Kurani.

Ndërkaq, nuk ka ndonjë kufi më të lartë të masës së mehrit ose prikës. Ai që ka mundësi dhe dëshiron, mund të japë sa të dojë. Në Kuran thuhet: **“Edhe sikur t'i jepni njerës prej tyre mehr (prikë) me barrë, mos merrni gjë prej saj!”**⁵

Nga shqyrtimi tërësor i ajeteve dhe haditheve mbi mehrin është arritur në këtë konkluzion: Profeti nuk ka dhënë leje për kontraktimin e asnjë martese pa prikë!

4 Kurani, En-Nisa: 4.

5 Kurani, En-Nisa: 20.

c) Llojet e mehrit:

1. *Mehri i caktuar nga palët (musemma - i titulluar)*. Ky është mehri (prika) i caktuar nga të dy palët me pëlqim të dyanshëm gjatë aktit të kurorës ose më pas. Për këtë lloj mehri thuhet kështu në Kuran: **“Po qe se ju i ndani ato pa hyrë në marrëdhënie seksuale me to ndërsa u keni dhënë mehri, gjysma e mehrit u takon atyre.”**⁶

Ky lloj mehri i caktuar (i titulluar) mund të jepet në dorë ose më pas.

1/a. *Mehri në dorë (muaxhxhel)*: Është mehri ose prika që jepet e tëra në çastin e lidhjes së kurorës.

1/b. *Mehri i shtyrë (muexhxhel)*: Është mehri ose prika e caktuar për t'u dhënë ose me rastin e ndërprerjes së martesës (nëse për shkaqe të ndryshme ndërpritet), ose në një kohë, bie fjala, pesë ose dhjet vjet më vonë, ose po të vdesë burri. Në këto kushte, gruaja nuk mund ta kërkojë mehrin (prikën) pa i ardhur afati i përcaktuar edhe më pëlqimin e saj. Mehri i titulluar si masë por me afat pagese të papërcaktuar, kur në lidhje me veçoritë e tij nuk ekziston as dhe ndonjë zakon ose traditë vendore, paguhet aty për aty në rastin e ndarjes (divorcit) si dhe të vdekjes së njërit nga bashkëshortët.

2. *Mehri i pacaktuar*. Mehri, masa e të cilit nuk caktohet në çastin e lidhjes së kurorës, caktohet më pas duke marrë për bazë mehrin e grave të mjedisit dhe shkallës shoqërore-ekonomike të gruas për të cilën bëhet fjalë. *Ky quhet mehri i krahasuar*.

Për caktimin e mehrit të krahasuar merret si masë baze mehri i marrë më parë nga gra të afërme të gruas që martohet, si motra, mbesa apo halla.

d) Kuptimi dhe urtësia e mehrit (prikës)

Mehri (prika) është si një para e vënë mënjanë nga gruaja gjatë kohës së martesës. Në rastet e humbjes së papritur të të shoqit ose divorcit, mehri i siguron gruas mbështetje financiare gjersa të përgatisë një jetë tjetër. Po të mbahet parasysh se masa minimale e mehrit është sa vlera e dy dhenve të vlefshëm për kurban, kurse masa maksimale, sa 80 dhen (400 derhem argjend), mund të thuhet se mehri vlen më të vërtete si mbështetje financiare për gruan.

Ndërkaq, siç u theksua më lart, mehri nuk është kundërvlera e gruas ose shpërblimi i mundësisë për të përfutur prej saj, por shenjë simbolike e dëshirës për të bashkëjetuar një jetë të tërë, shenjë simbolike e kërimit të dorës së gruas nga burri.

6 Kurani, El-Bekare: 237.

Po të mbahet parasysh dimensionin e dhurimit të kurorës dhe fakti që Profeti nuk ka dhënë leje për lidhjen e kurorës pa mehr (prikë), mehrin ose prika është një detyrim që burri duhet ta plotësojë edhe në qoftë se gruaja ka mundësi dhe garanci të tjera. Ky detyrim nuk ndryshon sipas kohës dhe kushteve shoqërore.

2. Nafaka

a) Ç'është nafaka

Kuptimi leksikor i fjalës *nafaka* është ushqim, veshmbathje dhe banesë. Kurse në të drejtën Islame, nafaka është përgjegjësia e personit (kryefamiljarit) për të siguruar jetesën e pjesëtarëve të familjes dhe të afërmeve të tij.

Detyrimet materiale të familjes i janë dhënë burrit. Në Kuran urdhërohet: **“Ushqimi dhe veshmbathja e nënave i takon babait me aq sa ka mundësi!”**⁷ **“Ai që ka mundësi të gjera, të shpenzojë sipas mundësive, kurse i varfëri me të ardhura të pakta, të japë nafakë sipas asaj që i ka dhënë Allahu. Allahu s'e ngarkon askënd me më shumë se ç'i ka dhënë mundësi. Pas vështirësisë, Allahu fal lehtësi!”**⁸

Profeti ka porositur: *“Në fillim ushqije veten tënde, pastaj personat, ushqimi i te cilëve të takon ty!”*

Pas martesës dhe vendosjes së gruas në shtëpinë e burrit, shpenzimet e ushqimit, veshmbathjes dhe banesës së saj i takojnë burrit. Këto shpenzime përcaktohen sipas nivelit shoqëror të bashkëshortëve pa kaluar në dorëllirësi (shpenzim të tepërt) ose koprraci (shpenzim me të pakët se normalja). Po që se të dy bashkëshortët janë të pasur; shpenzimet e tyre do të jenë sipas gjendjes dhe mundësive që kanë, po që se të dy janë të varfër, gruaja nuk mund t'i kërkojë burrit shpenzimet që bën një grua e pasur. Kurse po që se njëri është i pasur kurse tjetri, i varfër, ndiqet një rrugë e mesme. Ndërkaq, disa dijetarë juristë kanë thënë se për masën e nafakasë duhet marrë parasysh vetëm gjendja e burrit.

Pamundësia e burrit të varfër për t'ia siguruar jetesën gruas nuk është quajtur shkak për ndarje. Si argument për këtë është marrë ajeti kuranor: **“Po që se personat që do të martohen janë të varfër, Allahu i bën të pasur ata me bujarinë e Tij!”**⁹

7 Kurani, El-Bekare: 233.

8 Kurani, Et-Talak: 7.

9 Kurani, En-Nur: 32.

Burri është i detyruar t'i sigurojë gruas edhe veshmbathjen. Edhe këtu, si masë merret niveli shoqëror dhe tradita e përshtatshme ndaj Islamit. Termi “ma'ruf” (në masën sa ka mundësi) i ajetit këtë gjë shpreh. Duhet marrë parasysh gjykimi i vlerave dhe kushtet e mjedisit të çdo periudhe dhe shoqërie të veçantë. Gruaja ka të drejtë të ketë të paktën dy palë rroba: verore dhe dimërore. Në veshmbathje futen si plaçkat e shtëpisë, shtrojet e fjetjes, etj., ashtu dhe qefini pas vdekjes që është vazhdim i mbulesës.

Burri është i detyruar t'i sigurojë gruas një banesë të pavarur, me pajisje dhe shtrojë në përshtatje me gjendjen shoqërore si dhe me fqinj të mirë. Banesa duhet të jetë e sigurtë për mbrojtjen e mallit, jetës dhe nderit të gruas si dhe e përshtatshme për jetën bashkëshortore të burrit dhe gruas.

Në Kuran urdhërohet: **“Gratë që i ndani, me sa të keni mundësi, i veni të banojnë në një të ndarë të vendit ku banoni. Mos i detyroni ato ta ndiejnë veten ngushtë në atë shtëpi!”**¹⁰

Po qe se gruaja, sipas nivelit shoqëror që ka, duhet të ketë shërbëtore (siç kanë edhe gratë e tjera të të njejtit nivel shoqëror) ose ka nevojë për shërbim, në nafakë futet edhe sigurimi nga burri i shërbëtores për gruan.

b) Gjendjet kur gruaja e fiton të drejtën e nafakës

1- Po qe se gruaja nuk shkon te shtëpia e burrit pavarësisht nga ftesat e tij të përsëritura ose nëse gruaja, duke mos treguar bindje ndaj burrit, del nga shtëpia e tij dhe ikën, burrit i hiqet detyrimi i nafakës për të.

2- Nafaka e ditëve të kaluara bie. Po qe se nafaka bëhet e domosdoshme por pa u konsideruar me vendim gjykatësi ose me pëlqim të dyanshëm si borxh për ditët e kaluara, nafaka e ditëve të kaluara bie.

3- Rasti kur njëri nga bashkëshortët vdes. Po qe se burri vdes pa ia dhënë nafakën gruas, gruaja nuk mund ta marrë atë nga malli i burrit. As trashëgimtarët e gruas nuk mund të bëjnë një pretendim të tillë nëse gruaja vdes. Gruas që pret plotësimin e afatit të pritjes pas vdekjes së burrit, nuk i jepet nafaka, sepse, me vdekjen e burrit, e gjithë pasuria e tij u kalon trashëgimtarëve. Gruaja vetë bëhet trashëgimtare e tij në masën një të katërtën ose një të tetën.

4- Kur gruaja del nga feja. Kur gruaja largohet nga feja, detyrimi i burrit për nafakën e saj bie, por i rilind detyrimi i nafakës nëse ajo rikthehet në fe. Ndërkaq, nëse gruaja me burrin u përkasin qysh në fillim feve të ndryshme, ndryshimi fetar mes tyre nuk bëhet pengese që gruaja të ketë të drejtën e nafakës.

10 Kurani, Et-Talak: 6.

5- Ndarja e shkaktuar nga gruaja për tradhti bashkëshortore ose ndonjë akt tjetër të ulët, ia humb asaj të drejtën e nafakës.

c) Shpenzimet për rritjen e fëmijëve

Nafaka ose ushqimi, veshmbathja dhe banimi i fëmijëve të mitur djem e vajza i përket babait.

Në suren Et-Talak, ajeti 5, thuhet: **“Po qe se ato (nënat) u japin gjë fëmijëve tuaj, jepuni atyre pagesën e plotë të gjirit!”** Këtu bëhet fjalë për pagesën për gruan e ndarë pasi ka plotësuar periudhën e pritjes pas ndarjes, e cila vazhdon ta ushqejë me gjë fëmijën, nafaka e të cilit i takon të atit.

Babai bëhet i detyruar t'u sigurojë nafakën fëmijëve nëse ka mundësi për këtë gjë. Babai bëhet i aftë për të dhënë nafakën e fëmijëve me pasurinë që ka nëse është i pasur, ose duke punuar. Po qe se fëmija ka pasuri të vet, shpenzimet e nafakës për të mund të merren prej asaj pasurie.

Babai është i detyruar të kujdeset për fëmijën mashkull gjersa të mbushë moshën e pubertetit. Por nëse fëmija mashkull që ka mbushur moshën e pubertetit nuk është në gjendje të punojë për të mbajtur veten sepse është i sëmure, i gjymtuar, i paralizuar, etj., detyrimi i kujdesit të babait vazhdon.

Babai është i detyruar të kujdeset për fëmijën femër (për vajzën) pa kufizim moshe dhe pjekurie, gjersa vajza të martohet. Pas martesës së vajzës, detyrimi i nafakës së saj i kalon burrit. Nëse burri i vdes ose ndahet, vajza rikthehet në shtëpinë e të atit. Vajza apo gruaja nuk mund të shtrëngohen për të punuar e fituar. Por lejohen të punojnë dhe fitojnë nëse kjo bëhet sipas kriterëve Islame.

d) Shpenzimet e jetesës së prindërve dhe personave të tjerë të afërt

Po qe se nëna dhe babai varfërohen ose plaken e bëhen të paaftë për të punuar, përgjegjësia për kujdesin, shërbimin dhe jetesën e tyre bie mbi fëmijët. Në Kuran thuhet: **“Zoti yt ju urdhëroi ta adhuronit vetëm Atë si dhe t'u beni mirë nënës dhe babait!”**¹¹ **“Falënderomë Mua dhe falënderoji edhe prindërit, por mos iu bind atyre në kundërshtim me Islamin. Dhe kujdesu për ta në këtë botë me sa të kesh mundësi (ma'ruf)!”**¹²

Xhabir b. Abdil-lah percillet të ketë thënë kështu: *“Te i Dërguari i Allahut erdhi një njeri bashkë me të atin dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut! Unë kam mallin tim si*

11 Kurani, El-Isra': 23.

12 Kurani, Lukman: 14-15.

dhe kam tim atë që ka mallin e tij. Im atë kërkon të marrë mallin tim!” I Dërguari i Allahut iu përgjigj: “Ti dhe malli yt i përkisni tyt eti!”

Nafaka për të afërmit e tjerë bëhet e detyrueshme kur:

- 1) I afërmi është i varfër. Kjo varfëri është pasojë ose e mungesës së pasurisë, ose e paaftësisë së tij për të punuar.
- 2) Dhënësi i nafakës për të afërmin e varfër duhet ose të ketë pasuri të mjaftueshme, ose të ardhura të siguruara duke punuar, të mjaftueshme për t'ia siguruar jetën të afërmit të varfër.
- 3) I afërmi që do t'i jepet nafakë, duhet të jetë i afërm në gjak.



Lexim letrar

Molla

Ishin kohët kur bukuria e Islamit shkëlqente si dritë. Një i ri që përpiqej ta jetonte Islamin, po merrte abdest në breg të lumit Tiger, që kalon mes-përmes Bagdatit. Në këtë mes, para tij kaloi një mollë. Ai u zgjat, e mori dhe e kafshoi pa u menduar gjatë. Por s'e kishte mbaruar mollën kur e ndërpreu të ngrënët dhe tha i dëshpëruar:

“Bobo, ç'bëra unë! Kjo mollë nuk është imja!..”

I riu mbaroi së marri abdest dhe u nis në të kundërt të rrjedhës së lumit me mendimin për të gjetur kopshtin e mollëve nga kishte rënë molla që hëngri. Dhe pa shkuar shumë, hasi në një kopsht mollësh që u vareshin degët mbi ujërat e lumit. Mollët e tyre i ngjanin shumë mollës që kishte ngrënë ai. I riu kërkoi me sy pronarin e kopshtit dhe e gjeti tek po mbledhte mollë. Pronari e dëgjoi me vëmendje djaloshin. Pasi mbaroi së treguari, i riu iu lut pronarit t'ia bënte hallall mollën e ngrënë. Pronari u bë papritmas serioz dhe i tha:

“Jo! Punë që s'bëhet! Kam një kusht. Pranoj të ta fal pasi të punosh një vit argat në këtë bahçë!”

I riu u mendua thellë për fjalët e pronarit dhe e tha vendimin e tij:

“Më mirë punoj këtu si argat një vit se sa të dal para Allahut më të drejtën e një njeriu të shkelur dhe të vuaj ndëshkimin e Tij! E pranoj propozimin tënd!”

Koha kaloi si ujë dhe u plotësua një vit shërbim. Djaloshi ia kujtoi këtë gjë pronarit dhe i kërkoi t'ia bënte hallall mollën që kishte ngrënë.

Por pronari nuk pranoi dhe i vuri një kusht tjetër. Ai i tha të riut:

“Unë kam një vajzë për martesë. Por ajo, për fat të keq, është topalle, qorre dhe e shurdhër. As duart s'i bëjnë. Mbi të gjitha, është edhe shumë e

shëmtuar. Mendohu mirë dhe vendos. Po e pranove për grua, do të ta bëj hallall mollën që hëngre!”

Kushtet e pronarit s'kishin fund!

Djaloshi mendoi se kështu paska qenë e shkruar për të dhe pranoi. Ai kishte frikë nga përgjegjësia morale e shpirtërore e mollës që kishte ngrënë.

Djaloshi e pranoi edhe këtë kusht!

Nga njëra anë vazhdonin përgatitjet e dasmës, nga ana tjetër dhëndëri i ardhshëm i kalonte ditët i zymtë e i hidhëruar.

Më në fund, dita e dasmës erdhi. U lidh kurora dhe u shtruan të ngrënat. Dhe, kur erdhi koha, dhëndërin e mbyllën me të gjitha zakonet.

Dhëndëri fali dy rekate namaz para se t'ia zbulonte fytyren nuses. Megjithëse e dinte se nusja e tij ishte shumë e shëmtuar, ai ia ngriti duvakun me shumë delikatesë e mirësi. Po ç'të shihte? Para tij qëndronte një bukuri e rrallë!

Djaloshi doli menjëherë jashtë për t'u thënë njerëzve se duhej të ishte bërë ndonjë gabim se ajo s'ishte nusja e tij. Por pronari i kopshtit dhe, tani, vjehrrin e tij, i cili e priste këtë veprim të djalit, i tha:

“Këtu nuk ka asnjë gabim! Qysh në çastin e parë të takimit me ty unë e kuptova se ti ishe një njeri shumë i drejtë. Prandaj u solla ashtu me ty edhe për të të provuar, edhe për të të lidhur pas vetes. Unë kisha një vajzë shumë të bukur e shumë të edukuar, por s'dija kujt t'ia jepja megjithëse ma kërkonin djem nga dyert më të shquara, por kur të njoha ty, vendosa ta martoj me ty. Allahu ju bekoftë e ju dhëntë lumturi në të dy botët!

Dy të rinjtë u martuan e kaluan jetë të lumtur. Allahu u dha edhe një djalë të bukur e të mençur që e priste një e ardhme e madhe.

Biri i tyre ishte ai që u bë një nga mendimtarët më të shquar të Islamit: **Imam Adhami Ebu Hanife!**



II. NDARJA (TALAK)

Ndarja është dy llojesh:

1. Ndarja me mundësi rikthimi në martesë pa bërë ndonjë aktmartesë të re
2. Ndarja sipas rregullave e jo sipas rregullave.

A. Ndarja me kthim të mundshëm ose të pamundshëm

1. Ndarja me kthim

Është ndarja me rikthim në martesë pa bërë ndonjë akt martesë të re. Burri që e ndan gruan në këtë mënyrë, po qe se ndryshon mendim brenda periudhës së pritjes (iddet), e njofton gruan për këtë dhe jeta e tyre martesore fillon nga e para. Që ndarja të jetë e kthyeshme, duhet:

1. Gjer në çastin kur e ndan gruan, burri duhet të ketë hyrë në marrëdhënie seksuale me të.
2. Sipas hanefitëve, ndarja duhet të jetë bërë me fjalë të qarta e të mos jënë përdorur fjalë të ashpra e të rënda.

Po s'u plotësuan këto kushte, ndarja fiton cilësinë e ndarjes së pakthyeshme.

2. Ndarja pa kthim

Ndarja që e ndan gruan nga burri, që i jep fund jetës martesore, që nuk jep mundësi rikthimi në jetën e mëparshme martesore pa bërë një akt martese të re, quhet “ndarje pa kthim”.

Që ndarja të jetë pa kthim, duhet të plotësojë këto kushte:

1. Të jetë bërë pas aktit të martesës, pa u realizuar bashkëjetesa e vërtetë e çiftit dhe pa pasur marrëdhënie seksuale mes tyre.
2. Sipas hanefitëve, ndarja duhet të jetë bërë duke përdorur fjalë të paqarta (fjalë me nënkuptim) ose fjalë të ashpra e fyese.
3. Me kërkesë të gruas, burri t'i ketë dhënë fund jetës martesore si kundërshtpërblim për një interes.
4. Ndarja qoftë me kthim, qoftë pa kthim, të jetë përsëritur tri herë. Pas përdorimit nga burri i të drejtës për ta ndarë gruan tri herë, rikthimi në jetën martesore duke bërë vetëm një akt-martese, është i pamundur.

B. Ndarja sipas rregullave e jo sipas rregullave

1. Ndarja e rregullt (sunni)

Ndarje e rregullt është ndarja sipas sunnetit, domethënë në përshtatje me porosinë e Profetit (a.s.). Megjithatë Islami e lejon ndarjen, e trajton si veprim të papëlqyer dhe ka vënë masa që e bëjnë të vështirë ndarjen. Parimi i ndarjes së rregullt vjen në krye të masave vështirësuese të ndarjes.

Duke u mbështetur në dogmën dhe në praktikën, të gjithë ideatorët e së drejtës Islame kanë rënë në të njëjtin mendim se “ndarja pas të përmuajshmeve pa hyrë në marrëdhënie seksuale dhe me një ndarje, është e rregullt”. Hanefitët, krahas pajtimit me ideatorët e tjerë se ndarja tri herë brenda një pastrimi është në kundërshtim me sunnetin, janë distancuar prej tyre duke thënë se ndarja tri herë brenda tre pastrimeve të njëpasnjëshme me intervale sipas intervaleve mes të përmuajshmeve, nuk është në kundërshtim me sunnetin. Forma e ndarjes së rregullt mbështetet në porosinë e Profetit (a.s.) sipas Kuranit (et-El-Talak: 65/1) dhe një çështjeje të paraqitur nga Hz. Omeri.

2. Ndarja e parregullt (bid'i)

Është ndarja jo në përshtatje me sunnetin dhe jo në përputhje me rregullin. Ndarja e gruas gjatë të përmuajshmeve ose pas marrëdhënies seksuale ose tri herë brenda një pastrimi është në kundërshtim me sunnetin. Ka një mendim të njëzëshëm që se ndarja në kundërshtim me sunnetin është fetarisht jo e lejueshme (jo xhaiz) dhe se burri që e ndan gruan në këtë mënyrë, bën gjynah, Ndërkaq, në çështjen e përfundimit juridik të kësaj lloji ndarjeje janë parashtruar dhe mbrojtur pikëpamje të ndryshme.

a. Ndarja e gruas duke qenë me të përmuajshme ose pas kryerjes se marrëdhënies seksuale gjatë periudhës së pastrimit të saj, sipas ideatorëve juristë, si: Xhafër es-Sadik, Ibni Tejmijje, Ibn el-Kajjim, Ibn Hazm dhe Shevkani, është e parregullt, e papranueshme dhe nuk lind asnjë përfundim juridik. Kjo pikëpamje e parapëlqyer edhe nga juristi bashkëkohës Ebu Zehra, mbështetet në ajetet që e ndalojnë një ndarje të tillë si dhe në praktikën dhe zbatimet e Profetit.

b. Ndarja tri herë brenda një pastrimi ose në të njëjtin vend.

Sipas ideatorëve mes të cilëve ndodhen edhe imamët e katër shkollave juridike-fetare, ndarja e formës me tri ndarje, edhe sikur të jetë e parregullt, është e pranueshme, duhet të merret në konsideratë. Ndarja realizohet me anë të numrit të përdorur gjatë komunikimit ose përsëritjes së komunikimit. Çështja nuk ndryshon

nëse komunikimi bëhet në të njëjtin vend ose në vende të ndryshme. Po qe se dikush i thotë gruas “je ndarë, je ndarë, je ndarë” ose “tri herë je ndarë, je ndarë me tri herë, je ndarë nga treshi gjer te nënta”, gruaja bëhet e ndarë me tri komunikime ndarjeje dhe bashkëshortët nuk mund të kthehen më në jetën martesore. Rruga e vetme e rikthimit, tahlil, do të trajtohet më tej.

Përballë këtij opinionioni ka edhe dy opinione të tjera.

Ideatorët e shkollave imamite dhe zahirite, meqë kjo ndarje është e parregullt, kanë dhënë mbi të të njëjtin konkluzion si për ndarjen e llojit të parë dhe kanë thënë: “Një ndarje si kjo nuk ka vlerë!”

Sipas sahabëve, tabiinëve dhe shumë ideatorëve të brezave të mëvonshëm si dhe sipas ideatorëve dhe dijetarëve të tillë si Ibn Tejmijje, Ibn Kajjim, Shevkani, Sajis dhe Ebu Zehra, ndarjet e komunikuar në të njëjtin vend ose brenda një pastrimi, mes dy të përmuajshmeve, kanë vlerën e një ndarjeje të vetme; me një trajtim të tillë gruaja konsiderohet e ndarë një herë dhe, po deshi burri, mund të rikthehet në jetën martesore brenda një periudhe të caktuar pa bërë një akt martesë të ri.

Ideatorët që mbrojnë pikëpamjen se “ndarja brenda një pastrimi quhet një ndarje pavarësisht se sa herë është përsëritur”, ndërmjet shumë argumenteve, mbështeten në këto dy argumente të fuqishme:

Ajeti që thotë se **“ndarja është dy herë, pastaj, ose duhet kaluar me të mirë, ose duhet ndarë me të mirë...”**¹³, duke e bashkuar me ajetin **“O i Dërguar, kur t'i ndani gratë, ndajini duke mbajtur parasysht periudhat e tyre të pritjes duke i numëruar edhe ato”**¹⁴, i cili bën të ditur se gratë duhen ndarë duke respektuar periudhat e tyre të pastrimit dhe të të përmuajshmeve, del në shesh se nuk duhen bërë tre ndarje menjëherë dhe se Islami nuk e do një gjë të tillë.

C. Ndarja me kundërshtëpërblim (muhalaa)

Fjala “muhalaa” rrjedh nga rrënja “hulu”. Kuptimi leksikor i fjalës hulu është dalje, nxjerrje, largim. Si term i së drejtës Islame, muhalaa do të thotë “shkëputja e gruas nga lidhja martesore me kundërshtëpërblim”. Kjo ndarje bëhet me marrëveshje mes burrit e gruas.

13 Kurani, El-Bekare: 229.

14 Kurani, Et-Talak: 1.

E dime se, në kushte normale, e drejta e ndarjes ndodhet në dorë të burrit. Po qe se është gruaja ajo që kërkon ndarjen dhe burri nuk pranon, janë disa rrugëzgjdhje për problemet që shfaqen në këto kushte, nga të cilat, njëra është ndarja me kundërshpërblim. Kurse zgjidhjet me arbitra dhe ndërmjetësimin e arbitrave do t'i shohim më tej.

Në Kuran thuhet:

“Nuk është hallall për ju ta merrni prapë mehrin që u keni dhënë grave, por përjashtohet rasti kur palët kanë frikë se nuk janë në gjendje të ruajnë kufijtë (rregullin e familjes) e vënë nga Allahu. Po të keni frikë se nuk do të mund t'i ruani kufijtë e vënë nga Allahu, nuk ka ndonjë të keqe sikur gruaja të japë diçka për të shpëtuar nga martesë...”¹⁵

Jo vetëm ky ajet tregon se është e lejueshme (xhaiz) që burri t'i japë fund jetës martesore me kundërshpërblim, por edhe hadithet që reflektojnë zbatimin përkatës, i kanë sjellë qartësi çështjes.

E veçanta që të tërheq vëmendjen në ajetet dhe hadithet, është se iniciativa për t'i dhënë fund jetës martesore me kundërshpërblim duhet marrë kur, me gjithë përpjekjet, bëhet e pamundur të vazhdohet martesë dhe të respektohen të drejtat e dyanshme.

D. Zgjidhja e martesës (me anë të gjykates)

Megjithëse në disa raste janë burri dhe veprimet e tij që kërkojnë ndërhyrjen e gjykatësit dhe dhënien fund të jetës martesore, është gruaja ajo që e përdor me shumë këtë rrugë. Kur shfaqen shkaqet përkatëse, gjykata është rruga më e rëndësishme që përdor gruaja për ta zgjidhur martesën, po qe se ajo nuk e zotëron të drejtën e ndarjes për shkak se s'e ka marrë nga i shoqi gjatë aktit të martesës ose më vonë ose për shkak se s'e zotëron atë të drejtë drejtpërsëdrejti.

Zgjidhja e martesës nga gjykatësi bëhet mbi bazën e kërkesës së anës përkatëse si dhe të ekzistencës së shkaqeve të ndarjes.

15 Kurani, El-Bekare: 229.

Lexim letrar

Bëhu mysliman, të martohem

Për arritjen e organizimit të një jete martesore të bukur e të kënaqshme dhe sigurimin e vazhdimësisë së saj, duhet që marrëdhëniet burrë-grua të jenë të shëndosha, lidhjet familjare, të fuqishme dhe familja të ngrihet mbi themelin e shëndoshë të një zgjedhjeje të drejtë.

Në historinë e Islamit ka një shembull që është model për ne. Është zonja Ummu Sulejm binti Milhan.

Ummu Sulejm është gruaja e parë ndër medinasit ensarë që pati pranuar Islamin. Ajo qe martuar me Malik b. Nadrin, nga i cili pati një djalë që ia patën vënë emrin Enes.

Kur Ummu Sulejm pranoi Islamin, i shoqi nuk e duroi dot një gjë të tillë dhe e braktisi. Kishin kaluar shumë vite kur erdhi lajmi se Malik b. Nadri kishte vdekur. Ajo ishte ende shumë e re. Pavarësisht nga të gjitha këto, ajo duroi duke e pritur shpërblimin nga Allahu.

Në këtë mes, asaj i propozoi për martesë i riu medinas Ebu Talha, një i ri simpatik, i zgjedhur, i pasur dhe i fuqishëm, por që ende s'ishte bërë mysliman. Ky djalë, emrin e të cilit vajzat medinase s'e nxirrnin prej goje, pandehte se Ummu Sulejm do ta pranonte me vrap propozimin e tij. Ummu Sulejm iu përgjigj kështu:

“O Ebu Talha! Ti nuk je mysliman, ti u falesh idhujve. Prandaj nuk mund ta pranoj propozimin tënd. Dhe a e di ti se idhulli që ti i falesh ka qënë një dru i mbirë nga toka dhe i prerë e i gdhëndur nga dora e një zezaku etiopian?”

Ebu Talha i foli gjerë e gjatë asaj se do t'i jepte një shpërblim të madh kurore dhe se pranë tij ajo do të kalonte një jetë plot begati e komoditet. Pasi e degjoi, Ummu Sulejm iu përgjigj:

“Betohem në Allahun se një njeri si ti sigurisht që nuk refuzohet. Mirëpo ti je një qafir, kurse unë jam një myslimane. Unë e kam të ndaluar të martohem me ty. Po qe se ti hyn në Islam, fakti që ti do të bëhesh mysliman mjafton si pagesë kurore për mua! Dhe nuk kërkoj asnjë pasuri tjetër prej teje!”

Ditën tjetër Ebu Talha e takoi Ummu Sulejmin me propozime për dhurata më të pasura, por ajo ia përsëriti se nuk do të martohet me të po qe se s'bëhet mysliman dhe shtoi:

“Zotat që u faleni ju i kanë bërë maragozët që janë skllëvër të këtij e atij. A nuk digjen ata po t'i hidhni në zjarr?”

I ndikuar shumë prej këtyre fjalëve plot kuptim, Ebu Talha nisi të mendonte me vete:

“A digjet ai që është Zot? Pse, a s'i kishin bërë ata zotat e tyre me të vërtetë me duart e tyre?...”

Dhe, nderkaq, prej buzëve të tij nisen të derdheshin fjalët e deshmisë dhe Ebu Talha u bë mysliman!

Menjëherë Ummu Sulejm çoi të birin, Enes, të thërriste dëshmitarët, u lidh kurora dhe u shpall martesë e tyre.

Ebu Talha dëshiroi ta vinte gjithë pasurinë e tij para këmbëve të Ummu Sulejmes, por ajo s'pranoi dhe duke treguar një vetëmohim që do të mbetet historikisht model për të gjitha gratë, i tha:

“O Ebu Talha! Unë u martova me ty për pëlqim të Allahut! Unë nuk dua shpërblim tjetër veç këtij!”

Ummu Sulejm e dinte fare mirë se, duke u martuar me Ebu Talhane, ajo nuk fitoi vetëm një burrë të një sere me të, por, mbi gjithçka, një shpërblim të madh në lartësinë e Allahut! Për ta kuptuar këtë, mjafton të kujtojmë porosinë e Profetit që thotë:

“Fakti që, me pretekstin tënd, Allahu e futi një njeri në rrugë të drejtë, vlen për ty më shumë se sa të bëheshe pronare e deveve të kuqe!” (Buhari, Muslim)



Lexim letrar Shko pajtohu!

Në kohën e kalifatit të Hz. Omerit, gruaja e njërit prej sahabëve e kishte kundërshtuar të shoqin dhe ata të dy ishin grindur ca. I mërzhitur nga kjo gjë, personi kishte menduar të shkonte e të ankohej te kalifi.

Sapo arrin te dera e kalifit, personi sheh se edhe te kalifi po behej një grindje e tillë. Edhe kalifin që ishte kalif po e kundërshtonte e shoqja! Personi ndenji pak, u mendua dhe vendosi të kthehej pa e takuar kalifin.

Kalifi e vuri re njeriun dhe i foli:

- O ti, filan! Pse erdhe gjer këtu dhe po kthehesh prapë?

- O kalifi i myslimanëve! Unë erdha të të ankohem ty për gruan time që më kundërshtoi, por pashë këtu se edhe gruaja jote po të kundërshtonte njëlloj si ajo. "Eh, thashë me vete, halli im i paska rënë në kokë edhe kalifit. Pse të ankohem?" Dhe desha të kthehem prapë!

Pas këtyre fjalëve, Hz. Omeri i foli kështu burrit:

- Gruaja ime kujdeset për fëmijët, ma mban shtëpinë, ma ruan mallin e pasurinë, gatuan, lan rrobat... A mos duhet t'ia mohoj këto shërbime pse më kundërshtoi pak?

Dhe burri iu përgjigj:

- Këto shërbime i bën edhe gruaja ime...

Atëherë, Hz. Omeri i tha:

- Në është kështu, shko e pajtohu me gruan!

Dhe burri u kthye në shtëpi e u pajtua me gruan!



PËRMBLEDHJE

1. Ç'do të thotë kurorë?
2. Cilat janë kushtet e duhura që kurora të jetë e vlefshme?
3. Cilat janë të drejtat e bashkëshortëve ndaj njëri-tjetrit?
4. Sa lloje ndarjesh ka?
5. Ç'do të thotë "ndarje me kundërshpërblim"?
6. Ç'do të thotë "zgjidhje e martesës"?

PJESA III

TREGTIA NË ISLAM

ÇËSHTJET

- A. Tregtia në Kuran dhe Sunnet
- B. Tregtia dhe rrugët e fitimit në Islam
- C. Gjërat që duhet të ketë kujdes tregtari mysliman
- D. Porositë e profetit tonë mbi tregtinë

PUNË PËRGATITORE

1. Në librat bio-bibliografike (sijer) shqyrtoni pjesët mbi moralin tregtar të Profetit tonë.
2. Cilat janë gabimet që bëjnë njerëzit në tregti në ditët tona?
3. Ç'kuptoni me konceptin "moral tregtar"? Diskutoni.
4. Lexoni në Kuran ajetet që kanë të bëjnë me tregtinë.

A. TREGTIA NË KURAN DHE SUNNET

Përveç konkluzioneve dhe vendimeve mbi fushat familjare, shoqërore dhe juridike, Islami ka bërë edhe rregullimin e veprimeve dhe marrëdhënieve ekonomike e tregtare. Islami ka ndaluar rrugët e padrejta të fitimit, si: kamata, tregu i zi, gënjeshtër, mashtrimi, etj., dhe ka ngritur një sistem ekonomik të mbështetur mbi të drejtën dhe drejtësinë.

Në lidhje me këtë çështje, në Kuran ka ajete të ndryshme:

“O ju që keni besuar, mos e hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të padrejtë, por vetëm hallall (të lejuar) me anë të tregtisë që e bëni me pëlqimin tuaj...”¹⁶

“Allahu e ka lejuar tregtinë, por e ka ndaluar kamatën!”¹⁷

“Nuk është mëkat për ju të kërkonit begati nga Zoti juaj (të bëni tregti) gjatë haxhit...”¹⁸

Kurse për ata që mashtrojnë në matje e peshim, thotë kështu:

“Mjerë për ata që, kur marrin prej të tjerëve, matin e peshojnë me të plotë, kurse kur u japin të tjerëve, matin e peshojnë me mangësi!”¹⁹

“Kur të jepni e të merrni, mbani dëshmitarë...”²⁰

Janë edhe shumë porosi të Profetit (a.s.) në lidhje me jetën ekonomike e tregtare:

*“Tregtari i drejtë, i ndershëm, që i besohet në fjalë dhe punë, në ditën e kiametit do të jetë bashkë me profetët, dëshmorët dhe besnikët!”*²¹

*“Tregtari që e mban fjalën dhe vepron drejt, në ditën e kiametit do të jetë nën hijen e arshit.”*²²

16 Kurani, En-Nisa: 29.

17 Kurani, El-Bekare: 275.

18 Kurani, El-Bekare: 198.

19 Kurani, Mutaaffin. 1-3.

20 Kurani, El-Bekare: 282.

21 Tirmidhi, Buju, 4.

22 Ibni Maxhe, Tixharat, 1.

“Po qe se një njeri grumbullon lëndë ushqimore dhe e shet me çmimin e ditës, shpërblehet sikur t’ua kishte ndarë atë falas nevojtareve!”²³

Një herë, Profeti ua pati tërhequr vëmendjen esnafëve dhe tregtarëve kështu: «O ju tregtarë, meqë në tregti përzihen shumë fjalë boshe dhe betime në gënjeshtëri, plotësojeni këtë duke dhënë sadaka!»²⁴ Kurse kur e patën pyetur se cili fitim është më i pastër, pati dhënë këtë përgjigje: “Është fitimi me punën e vet dhe me tregti ku s’është përzierë gënjeshtria!”²⁵

Edhe vetë Profeti ka bërë tregti, ka marrë borxh, ka lënë peng, ka bërë ortakëri. Në këtë mënyrë ai u ka treguar sahabëve, shokëve të tij, në praktikë, se si duhet bërë tregtia hallall (e lejuar, e bekuar).

B. TREGTIA DHE RRUGËT E FITIMIT NË ISLAM

Feja Islame ka porositur që njerëzit të punojnë dhe fitojnë sipas mundësive të tyre si dhe të shpenzojnë sipas nevojave të tyre. Ndërkaq, me anë të rregullave dhe një regjimi të caktuar marrëdhëniesh, Islami ka bërë që veprimtaria tregtare të zhvillohet në siguri.

Puna dhe fitimi, sigurimi i pasurisë së tundshme e të patundshme janë konsideruar farz në Islam ashtu si dhe marrja e diturisë. Puna, përpjekja dhe fitimi me rrugë dhe me mënyra legjitime me qëllim për të jetuar dhe për të mbajtur familje pa ia pasur nevojën kujt, janë cilësuar në Islam të vyera e të shenjta po aq sa dhe adhurimi (ibadet) dhe xhihadi.

Në të gjithë veprimtarinë tregtare, në të drejtën për të fituar dhe për të zotëruar pasuri të tundshme e të patundshme, Islami ka vënë si parim kryesor fitimin hallall, pra, në mënyrë legjitime e të bekuar. Duke u mbështetur në këtë parim, Islami i ka ndaluar vjedhjen, grabitjen, kamatën, marrëdhëniet seksuale të paligjshme dhe prostitucionin, bixhozin dhe rushfetin (mitën) dhe nuk u ka dhënë asnjë vlerë fitimeve dhe pasurive të arritura me këto rrugë.

Sipas fesë Islame, puna është mjeti dhe mënyra bazë dhe e natyrshme e fitimit. Në një hadith, Profeti ka thënë se “*askush nuk ka ngrënë gjë më të dobishme e të*

23 Ibn Maxhe, Ruhun, 16.

24 Ebu Davud, Buju, 1.

25 Ahmed b. Hanbel, III, 466.

*bekuar se gjëja e fituar me punën e duarve të veta*²⁶ dhe, kur e kanë pyetur se cili është fitimi më i pastër, ka thënë se *“është fitimi me punën e duarve të veta si dhe me tregti të drejtë e të ndershme.”*²⁷ Punën e duarve të veta për të cilën bëhet fjalë me kaq vlerësim në këto hadithe, duhet ta kuptojmë jo vetëm si punë fizike në arë, artizanat apo industri, pra, në profesione të ndryshme të bazuara në punën fizike, por edhe si punë mendore, në përgjithësi, si punë dhe përpjekje që japin drejtpërdrejt një produkt të vlefshëm material apo ideor.

Islami nuk i ka bërë të ditura veç e veç rrugët, mënyrat dhe mjetet legjitime e të bekuara (hallall) të fitimit, por vetëm ka treguar se cilat janë rrugët, mënyrat dhe mjetet jolegjitime dhe të ndaluara të fitimit. Në këtë mënyrë, Islami i ka dhënë mundësi zhvillimit të punës produktive, tregtisë dhe fitimit në ecurinë e vet të natyrshme. Për këtë, Islami ka vënë si parim themelor pëlqimin dhe marrëveshjen e lirë mes palëve, ka urdhëruar besnikërinë ndaj kontratës dhe fjalës së dhënë, ka ndaluar gënjeshtëri, deklaratën e rremë, shtrëngimin, tregun e zi, përfitimin nga gjendja e vështirë e palës tjetër, fitimin nëpërmjet shfrytëzimit të paqartësive dhe rreziqeve. Islami ka ndaluar kamatën që është fitim pasiv, shfrytëzues dhe shkatërrues, fitimin me përvetësim siç janë vjedhja, grabitja, rushfeti (mita), mashtrimi në matje dhe peshim, lojrat e bixhozit. Islami ka ndaluar fitimin e siguruar me anë të haramit të drejtpërdrejtë si prostitucioni ose të anasjelltë si tregtimi i pijeve alkoolike. Siç është shprehur edhe Profeti në Hutben e tij të Lamtumirës, fitimi i arritur duke respektuar këto kufizime dhe ndalime të Islamit, është i respektueshëm e i paprekshëm sikurse muajt e shenjtë, vendet e shenjta, jeta dhe nderi i myslimanëve.²⁸

Sipas Islamit, adhurimet dhe veprimet e trupit të ushqyer me gjëra haram, janë të pavlera e të padobishme, kurse fitimi i kapitalit të formuar me rrugë, mënyra e mjete jolegjitime bëhet joproduktiv. Fitimi jolegjitim s'i sjell personit gjë tjetër veç një jetë të paqetë e të palumtur në këtë botë si dhe një llogaridhënieje të vështirë në jetën e pasme, ahiret.

Profeti ynë i dashur, duke tërhequr vëmendjen mbi rëndësinë e fitimit hallall, ka thënë: “Do të vijë një kohë e tillë kur njeriu nuk do të dojë t'ia dijë nëse gjëja që ka marrë është hallall apo haram. Njerëzve të tillë nuk do t'u pranohet asnjë lutje!”²⁹

26 Buhari, Buju, 15.

27 Musned, IV, 141.

28 Ibn Maxhe, Ikame, 78.

29 Buhari, Buju, 7, 23.

Kurse në një hadith tjetër e ka shprehur kështu fundin e hidhur të fitimit haram të arritur me rrugë jolegjitime: *“Një pjesë njerëzish përpiqen të përvetësojnë nga pasuria e Allahut mall me mënyra të padrejta e të pandershme, mirëpo kjo, në ditën e kiametit, do të jetë për ta zjarr, jo tjetër gjë!”*³⁰

Detyra e myslimanit është jo të fitojë me çdo kusht, pavarësisht nga rruga, mënyrat apo mjetet që përdor, por të fitojë në mënyrë hallall dhe fitimin ta shpenzojë brenda kufijve të vënë nga Krijuesi. Po të veprojë kështu, edhe në këtë botë bëhet i qetë e i kënaqur, edhe në jetën e pasme arrin lumturinë e përjetshme!

C. GJËRAT QË DUHET TË KETË KUJDES TREGTARI MYSLIMAN

1. Zgjedhja e profesionit

Personi që kërkon të bëjë tregti, para se të hidhet në aktivitet, duhet të zgjedhë një fushë tregtie të pandaluar fetarisht. Ndërkaq, mund të bëhet tregti në fusha për të citat nuk ka ndalime të konkluduara në ajete dhe hadithe. Sipas Islamit, prodhimi dhe tregtimi i gjërave legjitime për ushqyerje, për përdorim dhe për përfitim prej tyre, është legjitim, sepse në Islam, urdhrat (lejimet) dhe ndalimet mbështeten mbi parimin “urdhërim (lejm) i gjësë së dobishme dhe ndalim i gjësë së dëmshme”.

2. Qëllimi i mirë dhe sinqeriteti

Personi që zgjedh profesionin (fushën e aktivitetit tregtar) dhe fillon investimin dhe aktivitetin tregtar, duhet të ketë për qëllim parësor sigurimin e jetësës së vet e të familjes, krahas kësaj, edhe ndihmën për të afërmit, në radhë të parë, dhe të tjerët. Nuk ka dyshim se iniciatori që bën një ndarje pune të nivelit farz kifaje në favor të nevojave të shoqërisë, fiton shpërblim adhurimi. Në hadith thuhet:

*“Kush grumbullon lëndë ushqimore dhe i shet me çmimin e ditës, konsiderohet sikur ua ka dhënë sadaka të varfërve!”*³¹

Këtu flitet për “lëndë ushqimore”, por nënkuptohen edhe produkte të tjera të nevojave elementare të shoqërisë. Gjithashtu, sadaka konsiderohen edhe të gjitha shpenzimet që bën një punëdhënësi për të gjithë njerëzit e punësuar prej tij dhe familjet e tyre. Profeti ka porositur kështu:

30 Buhari, Hums, 7.

31 Ibni Maxhe, Ruhun, 16.

“Ajo që ha ti është një sadaka; edhe ajo që u jep për të ngrënë fëmijëve të tu, gruas tënde dhe punëtorëve të tu është sadaka!”³²

3. Zotërimi i njohurive të mjaftueshme profesionale

Punëdhënësi dhe punëtori duhet të zotërojnë njohuritë teorike-teknike dhe kufijtë hallall-haram përkatësisht për investimin dhe punën e tyre. Sepse mosnjohja mund ta çojë në haram punëdhënësin apo tregtarin edhe në paçin qëllim të mirë. Prandaj, sot, vendet e mëdha të punës duhet të kenë një këshilltar specialist të fushës fetare Islame në lidhje me marrëdhëniet e punës e të tregtisë. Islami e inkurajon besimtarin të specializohet në fushën e veprimtarisë së tij të punës.

“Allahu e pëlqen që, kur të bëni një punë, ta bëni sa më mirë e saktë!”³³

“Allahu i do ata që janë specialistë dhe të suksesshëm në punën apo profesionin e tyre!”³⁴

Në një qarkore të shpërndarë në kohën e kalifatit të vet, kalifi Omer u drejtohej kështu esnafëve dhe tregtarëve: “Personi që s'i njeh konkluzionet Islame mbi veprimtarinë e vet (prodhuese-tregtare), të mos bëjë shitje e blerje në tregun tonë!”

4. Këshillimi në vendimet me rëndësi

Këshillimi është marrja e mendimit të dikujt tjetër mbi një çështje të caktuar. Këshillimi është sunnet. Prandaj, afaristi, personi që zhvillon veprimtari tregtare apo prodhuese, para se të marrë vendime me rëndësi, duhet të këshillohet me njerëz të mençur, të ditur, me përvojë dhe qëllim të mirë. Në Kuran thuhet:

“Ata i bëjnë punët duke u këshilluar mes tyre.”³⁵

Profeti dhe sahabet janë këshilluar me njëri-tjetrin në çështjet dhe punët me rëndësi. Përcillet që Ebu Hurejre (r.a.) të ketë thënë kështu: “Nuk kam parë njeri që të këshillohet me shokët më shumë se i Dërguari i Allahut!”³⁶

5. Mbajtja e fjalës dhe ndershmëria

Në Islam është me rëndësi që fjala apo garancia e dhënë të mbahen në kohën e duhur. Tregtia mbështetet në konsideratë dhe besim. Tregtari duhet ta ketë fjalën po

32 Ahmed b. Hanbel, IV, 131, 132.

33 Sujuti, el-Xhamiu's-Sagir, II, 286.

34 Sujuti, po aty, II, 290.

35 Kurani, Esh-Shura: 38.

36 Tirmidhi, Xhihad, 35.

aq të sigurtë sa dhe nënshkrimin. Profetit i kanë bërë disa pyetje për cilësitë e besimtarit. Pyetjes nëse besimtari mund të jetë gënjeshtar, Profeti i është përgjigjur duke ngritur duart lart: *“Ummeti im nuk është gënjeshtar!”*³⁷ Në Kuran, duke bërë fjalë për profetë të ndryshëm, është tërhequr vëmendja veçanërisht mbi faktin se ata kanë qenë «shumë fjalëdrejtë».

Gjendja e tregtarëve dhe esnafëve të drejtë e të ndershëm në ahiret është para-shtruar kështu:

*“Tregtari i ndershëm në fjalë dhe veprime, në ditën e kiametit do të jetë nën hijen e arshit!”*³⁸

6. Besimi dhe mbështetja te Allahu

Allahu e ka marrë përsipër furnizimin (riskun) e njeriut për ushqyerje, veshje dhe strehim. Ndërkaq, për ta marrë furnizimin duhet kërkim dhe përpjekje. Në Kuran thuhet:

“Furnizimi (risku) i çdo qenieje të gjallë që ecën mbi tokë i takon vetëm Allahut!”³⁹

“Mos i vrisni fëmijët nga frika e varfërisë se jemi Ne që japim edhe riskun tuaj, edhe të atyre!”⁴⁰

Furnizimi (risku) herë mund të pakësohet, herë mund të shtohet. Në Kuran ka shumë ajete që bëjnë të ditur se Allahu ua shton riskun atyre që do (t'ua shtojë) dhe ua pakëson riskun atyre që do (t'ua pakësojë). Nga ana tjetër, Profeti ka bërë të ditur se mashtrimet e bëra në matje dhe peshim në një shoqëri, shkaktojnë pakësimin e riskut për atë shoqëri.

Pasi të kemi bërë punën dhe përpjekjet që na takojnë për të siguruar riskun, furnizimin, përfundimin duhet ta presim nga Allahu i Lartë. Kjo quhet tevekkul, dorëzani. Besimi dhe mbështetja te Allahu i jep zemrës prehje e qetësi, e mbron personin nga frika dhe shqetësimi, nga mungesa e shpresës dhe pesimizmi. Në Kuran thuhet:

“Kush beson dhe mbështetet te Allahu, Allahu i mjafton atij!”⁴¹

37 Malik, Muvatta, Kelam, 19.

38 İbni Maxhe, Tixharat. 1.

39 Kurani, Hud: 6.

40 Kurani, En'am: 151.

41 Kurani, Et-Talak: 3.

D. POROSITË E PROFETIT TONË MBI TREGTINË

Profeti ynë ka treguar se si mund të arrihet suksesi në tregti duke u qëndruar besnik parimeve të ndershmërisë dhe besueshmërisë dhe ka dhënë porosi të ndryshme në lidhje me tregtinë.

1. Ndershmëria duhet mbajtur si parim në tregti.

Shitësi nuk duhet ta lavdërojë mallin, kurse blerësi nuk duhet ta shajë. Pronari i mallit nuk duhet ta gënjejë blerësin në lidhje me mallin dhe nuk duhet të bëjë vepërime mashtruese ndaj blerësit. Në lidhje me këtë, Profeti ka porositur kështu:

“Fitimi i tregtarit që shet mall pa e lavdëruar dhe blen mall pa e sharë, është fitimi më i pastër!”

2. Në shitblerje dhe në pagesa duhet treguar mirëkuptim.

Klientit që nuk mund të paguajë në dorë, mund t'i jepet afat. Mund të hiqet dorë nga kërkesa e shlyerjes së borxhit ndaj atyre personave që nuk kanë mundësi ta shlyejnë. Gjatë tregtimit duhet sjellë me delikatesë dhe u duhen krijuar lehtësi nevojtarëve në pagesat e prapambetura. Në lidhje me këtë çështje, Profeti ka porositur:

“Allahu e ka caktuar në xhennet atë që krijon lehtësi gjatë blerjes, atë që krijon lehtësi gjatë shitjes, atë që krijon lehtësi gjatë pagesës, atë që krijon lehtësi gjatë kërimit të borxhit!”⁴²

3. Në shitblerje duhet ruajtur nga betimet e pavend.

Hadithet e Profetit mbi këtë çështje janë kështu:

“Betimi e shton fitimin, por e asgjëson begatinë.”⁴³

“Në ditën e kiametit, Allahu nuk ka për ta parë në sy shitësin që betohet shumë!”

Betimi ushtron presion mbi klientin. Betimi ia heq mundësinë klientit të zgjedhë mallin më të përshtatshëm. Veçanërisht betimi i panevojshëm ia humb betimit besueshmërinë. Prandaj, duhet të rezervohemi shumë nga betimi kur bëjmë tregti. Fundja, tregtari mysliman i besueshëm në fjalë dhe veprime nuk ka nevojë të betohet!

42 Tirmidhi, Bujii, 74.

43 Ebu Davud, Bujju, 6.

4. Shitësi duhet të tregohet shumë i kujdesshëm në matje e peshim.

Në lidhje me këtë çështje, në Kuran, në suren Mutaaffin thuhet:

“Mjerë për ata që, kur masin prej të tjerëve, matin e peshojnë me të plotë, kurse kur u japin të tjerëve, matin e peshojnë me mangësi! A mos pandehin ata se nuk do të ringjallen?”⁴⁴

Edhe Profeti i porositi kështu ata që matin dhe peshojnë:

“Nuk ka njeri që të mos i pritët furnizimi (risku) për shkak të mangësive në matje e peshim!”

5. Në tregti duhet shmangur nga ngushtimi i fushës së punës dhe fitimit të të tjerëve dhe nga konkurrenca që të çon në smirë dhe armiqësi.

Përpjekjet për t'i tërhequr klientët për vete duke i sharë tregtarët e tjerë janë veprime që nuk u kanë hije myslimanëve. Profeti na porositi:

“Mos kini zili, mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit, mos i prisni lidhjet dhe interesimin! O robtë e Allahut, bëhuni vëllezër siç ju ka urdhëruar Allahu!”⁴⁵

“Ashtu si zjarri e ha dhe e mbaron drurin, po ashtu zilia dhe smira i hanë dhe i mbarojnë punët e mira!”⁴⁶

6. Duhet shmangur nga tregu i zi.

Akaparimi (me leverdi) i mallrave dhe produkteve të nevojës së parë, duke shkaktuar krizë në treg, për t'i shitur në kohë krize (në tregun e zi) me çmime të larta (ihtikar) përbën faj sipas fesë sonë. Në lidhje me këtë, Profeti ka thënë:

“Kush e fsheh një lëndë ushqimore për dyzet net, largohet nga Allahu! Po qe se në një vendbanim, një njeri gdhiet i pangrënë e i uritur, Allahu e heq mbrojtjen nga ai vendbanim!”⁴⁷



44 Kurani, Mutaaffin: 1-4.

45 Ahmed b. Hanbel, Musned, I, 3-11

46 Ebu Davud, Edeb, 52.

47 Ahmed b. Hanbel, Musned, II, 33.

Lexim letrar Shko pajtohu!

Imam Adhami e pyeti gruan që kishte sjellë për të shitur një copë mëndafshi për veshje, për çmimin e copës. Gruaja iu përgjigj: “Njëqind dërhëmë, o imam!” Imam Adhami e kundërshtoi: “Jo, bën më shumë!” E habitur, gruaja e rriti çmimin po aq: “Dyqind dërhëmë!” Imam Adhami e kundërshtoi përsëri dhe gruaja e ngriti çmimin gjer në treqind dërhëmë. Imam Adhami e kundërshtoi përsëri dhe gruaja e bëri katërqind dërhëmë. Imam Adhami përsëri s'mbeti i kënaqur. Ai i tha gruas: “Jo, kjo bën edhe më shumë!” Kësaj radhe gruaja e shkretë që s'ishte ndodhur kurrë më parë në një situatë të tillë, i tha imam Adhamit: “O imam, a po kërkon të tallesh me mua?”

Atëherë imam Adhami dërgoi e thirri një njeri që merrte vesh nga çmimi i një malli të tillë. Njeriu tha se ajo copë vlente pesëqind dërhëmë dhe imam Adhami e bleu copën e mëndafshtë me atë çmim!

Një radhë tjetër, imam Adhami e dërgoi ortakun e vet, Hafs bin Abdurrahmanin, për të shitur një sasi pëlhure dhe e porositi: “O Hafs, malli ka këto e këto të meta. Prandaj ia thuaj myshterit dhe shite me këtë çmim!”

Hafsi e shiti mallin me çmimin e caktuar nga imam Adhami, por harroi t'ia tregonte myshterit të metat. Imami e pyeti Hafsin: “A e njeh myshteriu?”

Pasi Hafsi i tha se nuk e njohte myshteriu, imam Adhami e shpëmdau si sadaka gjithë fitimin e marrë nga shitja e atij malli, sepse e jetonte me tërë qenien e vet thënien e Profetit, “*sa i ka hije malli hallall njeriut të mirë!*”⁴⁸, dhe sillej ndaj hallallit dhe haramit sipas të gjitha kritereve të devocionit.



48 Ahmed b. Hanbel, IV, 197, 202.

PËRMBLEDHJE

1. Jepni shembuj të ajeteve të Kuranit mbi tregtinë.
2. Cilat janë rrugët e fitimit hallall?
3. Jepni të dhëna mbi çështjet që duhet të ketë kujdes tregtari mysliman.
4. Tregoni cilat janë parimet e sjella nga Profeti ynë mbi veprimtarinë tregtare.
5. Jepni shembuj nga hadithet e Profetit mbi tregtinë.

PJESA IV

SHITBLERJA DHE ORTAKËRITË

TREGTARE

ÇËSHTJET

- A. Kushtet e shitblerjes
- B. Format e shitblerjes
- C. Ortakëritë (shoqëritë) tregtare
 - 1. Kuptimi i ortakërive (shoqërive) tregtare
 - 2. Llojet e ortakërive

PUNË PËRGATITORE

- 1. Sipas Islamit, cilat mallra nuk mund të shiten e të blihen?
- 2. Vizitoni një shoqëri tregtare të qytetit tuaj dhe mblidhni të dhëna mbi organizimin dhe funksionimin e shoqërisë.

A. KUSHTET E SHITBLERJES

Feja jonë ka vënë disa kushte që shitblerja të jetë e vlefshme. Këto kushte mund t'i radhisim kështu:

1. *Malli që do të shitet e blihet, të mos jetë mall i ndaluar nga feja.* Mund të tregtohen (të shiten e blihen) mallrat që janë fetarisht të lejueshme (xhaiz) për t'u ngrënë, pirë dhe përdorur. Por nuk mund të tregtohen (të shiten e blihen) mallrat që konsiderohen fetarisht haram. Tregtia e mallit haram është haram. Në triumfin e Mekës, Profeti pati thënë kështu: *“Allahu dhe i Dërguari i Tij e ndaluan shitjen e verës (pijeve alkoolike), të mishit të derrit, të mishit të kafshës së ngordhur dhe të idhujve!”*⁴⁹

Islami i ka bërë haram si gjërat e dëmshme, ashtu dhe tregtinë e tyre, sepse ata që shesin mallra haram, u bëjnë të keqe njerëzve. Duke ndaluar tregtinë (shitblerjen) e mallrave të dëmshme, feja jonë ka parandaluar që njerëzit t'u bëjnë të këqija njëri-tjetrit me këtë rrugë.

2. *Malli duhet të ketë cilësi të dallueshme nuk duhet të ketë të meta të fshehta.* Profeti ynë porositi kështu: *“... po qe se shitësi dhe blerësi flasin drejt dhe i deklarojnë hapur cilësitë e mallit, shitblerja u bëhet e mbarë dhe produktive, por po qe se i fshehin, mbarësia e tregtisë së tyre zhduket.”*⁵⁰ Një shitblerje e tillë do të thotë mashtrim dhe dëmtim i njëres palë, gjë që nuk pritet me pëlqim dhe miratim nga feja. Nëse malli ka ndonjë të metë, ajo s'duhet fshehur, por duhet bërë e qartë hapur.

3. *Malli duhet të jetë i pranishëm.* E drejta juridike Islame e ka quajtur të përshtatshme shitjen e mallit që dorëzohet me të parë ose që ka mundësi të dorëzohet. Profeti ynë e ka ndaluar shitjen e frutave që mendohet se do të merren ose të frutave të porsalidhur apo ende pa filluar pjekjen, por ka lejuar shitjen e frutave në pjekje e sipër.⁵¹ Sepse gjer në pjekje, frutat mund të pësojnë shumë dëme për shkaqe klimaterike, sëmundjeje, etj., dhe në këtë rast dëmtohet blerësi. Nga ana tjetër, është shumë e vështirë të përcaktohet qysh në fillim sasia e frutave që do të merren në fund të pjekjes. Prandaj dhe është ndaluar shitja e tyre e parashikuar si dhe, në përgjithësi, shitja e mallit të paqenë.

4. *Malli dhe kundërvlera e tij duhet të jenë të përcaktuar.* Shitblerja është ndërrimi i mallit me kundërvlerën e tij. Kur njëri prej këtyre dy elementëve, pra, ose

49 Muslim, Musakat, 13.

50 Muslim, Buju, 11.

51 Muslim, Buju, 13.

malli, ose kundërvlera e tij (çmimi i tij) është i paqartë, shitblerja është jo e rregullt, joligjore. Klienti duhet ta shohë mallin që shitet, ta kontrollojë, të bëjë shqyrtimet e duhura mbi të. Edhe shitësi duhet ta dijë sasinë e monedhës ose të mallit që ka për të marrë si kundërvlerë të mallit që shet. Për shembull, nëse blerësi i propozon shitësit t'ia shesë një mall të caktuar me aq para sa ka në xhep (portofol), pa ia treguar sasinë e parave, dhe shitësi të pranojë, kjo shitblerje quhet fetarisht e palejueshme (jo xhaiz). Në këto lloj shitblerjesh ka patjetër mashtrim dhe rrezik për njërin nga palët. Profeti i pati ndaluar këto lloj shitblerjesh të përhapura dhe praktikuara para Islamit.

5. *Malli duhet të merret në dorëzim.* Blerësi duhet të ketë mundësi ta marrë në dorëzim mallin që e bleu. Marrja në dorëzim bëhet në disa mënyra. Për shembull, marrja në dorëzim e shtëpisë së blerë bëhet duke hyrë blerësi në të ose duke marrë në dorëzim çelësat e shtëpisë. Kurse mallrat që maten, peshohen apo numërohen, merren në dorëzim nga blerësi menjëherë pas matjes, peshimit apo numërimit.

B. FORMAT E SHITBLERJES

1. *Shitjblerja me monedhë (bej-un).* Pjesa më e madhe e shitblerjes bëhet me këtë formë. Blerësi e paguan kundërvlerën (çmimit) e mallit me monedhë.

2. *Shitblerja e monedhës (sarf).* Është blerja e një monedhë me anë të një monedhë tjetër. Këtu futet edhe këmbimi i monedhës sipas një raporti (kursi) të caktuar.

3. *Shkëmbimi i mallit me mall (mubadele).* Kësaj lloj tregtie, populli i thotë edhe trambë.

4. *Shitblerja me parapagim e një malli të pritur (selem).* Kjo është forma e shitblerjes që përdorin më shumë bujqit dhe industrialistët. Kur Profeti shkoi në Medinë, pa se medinasit ua shisnin çifutëve prodhimet bujqësore apo frutore qysh dy vjet më parë. Atëherë, Profeti ndërhyri e tha: “Kush do ta shesë hurmanë më parë (se ta marrë prodhimin), duhet ta shesë për një sasi të caktuar, për një peshë të caktuar dhe për një kohë të caktuar.”⁵²

Ndërsa është një shitblerje e konsideruar jo e lejueshme (joxhaiz), shitblerja me parapagim e një malli të pritur, domethënë të paqenë në çastin e shitblerjes e të pagimit të vlerës së saj në monedhë, është quajtur e lejueshme (xhaiz) në kushte të

52 Muslim, Musakat, 25..

veçanta nevoje e shtrëngese. Ndërkaq, për të mos u lënë shteg mosmarrëveshjeve, për lejueshmërinë e kësaj shitblerjeje është vënë si kusht që, në çastin e marrëveshjes për shitblerjen e mallit të caktuar, të përcaktohen në mënyrë të prerë sasia, pesha dhe afati i dorëzimit të tij.

Me këtë formë shitblerjeje, Islami ka parandaluar që blerësi ta marrë mallin me çmim shumë të ulët duke përfutur nga gjendja e vështirë financiare e shitësit. Gjithashtu, i ka dhënë mundësi prodhuesit ta vazhdojë prodhimin (bujqësor apo industrial), si dhe blerësit që, duke e marrë mallin pak më vonë, por në një kohë të caktuar, ta blejë me një çmim pak më të ulët.

Gjithashtu kjo formë e ruan shitësin, pra, prodhuesin (bujqësor-industrial) që ka nevojë financiare të çastit për ta vazhduar prodhimin, nga shtrëngesa për të marrë hua me kamatë.

5. *Shitblerja veresie*. Me këtë lloj shitblerjeje, pagesa në monedhë e mallit të blerë nuk bëhet në çastin e blerjes, por në një kohë më vonë. Por nuk lejohet (nuk është xhaiz) pagesa veresie e një malli me po atë mall, si, p.sh., e arit me ar, etj.

C. ORTAKËRITË (SHOQËRITË) TREGTARE

1. Kuptimi i ortakërive (shoqërive) tregtare

Ortakëri do të thotë bashkimi i disa vetëve në një aktivitet tregtar me detyrime dhe të drejta proporcionale kapitale, interesash, pune dhe fitimi. Në të drejtën Islame, të gjitha ortakëritë janë quajtur “sherikeh” (shoqëri, partneritet) dhe janë inkurajuar njerëzit për të marrë iniciativa të ndryshme tregtare ose për të krijuar ortakëri (shoqëri, partneritete) me struktura dhe funksione të ndryshme. Ndërkaq, e drejta Islame ka theksuar se ndershmëria, mirëbesimi dhe siguria janë elementë me rëndësi të madhe në ortakëritë tregtare. Në një hadith të shenjtë, Profeti ka komunikuar se Allahu ka thënë: *“Unë bëhem i treti ndër dy ortakë nëse ata nuk e tradhetojnë njëri-tjetrin. Por po qe se njëri i bën pabesi tjetrit, unë tërhiqem.”*⁵³

a) Të drejtat dhe detyrat në ortakëri duhet të jenë të qarta në mënyrë që të mos shkaktojnë mosmarrëveshje.

b) Në ortakëri nuk i duhet lënë shteg mashtrimit dhe padrejtësisë.

53 Ebu Davud, Buju, 2.

- c) Qysh më parë duhet përcaktuar qartë se si do të bëhet ndarja e të ardhurave.
- d) Të ardhurat nuk duhet të sigurohen me rrugë haram.
- e) Ortakëria nuk duhet të përmbajë kamatë ose rreziqe të papritura.

2. Llojet e ortakërive

Ortakëritë janë ndarë në lloje dhe kanë marrë emërtime të ndryshme.

a) *Ortakëria në kapital (shirketu emval)*. Secili nga ortakët vë një masë kapitali dhe së bashku e ndajnë fitimin e nxjerrë nga tregtia e bërë me kapitalin e përbashkët.

b) *Ortakëria në punë (shirketu a'mal)*. Është ortakëria në fuqi punëtore (ose punë) e ngritur nga dy a më shumë vetë për të bërë një punë të caktuar.

c) *Ortakëri kredie (shirketu vuxhuh)*. Është ortakëria pa kapital e dy a më shumë vetëve që përdorin kredi ose mall me këste për të nxjerrë fitime prej tyre.

d) *Ortakëria punë-kapital (mudarabe)*. Është ortakëria e ngritur nga dy a më shumë vetë duke futur kapital ose fuqi punëtore (ose punë) për ta ndarë fitimin në raporte të caktuara. Kjo lloj ortakërie, në ditët tona, orienton, qoftë edhe pjesërisht, praktikën bankare Islame.

e) *Ortakëri bujqësore (muzaraa)*. Është ortakëria e ngritur mbi bashkimin e arës (parcelës bujqësore ose frutikulturore) me fuqinë punëtore (ose punën) për ta ndarë fitimin në raporte të caktuara.

Siç u tha më lart, në të drejtën Islame, për të gjitha ortakëritë përdoret koncepti dhe emërtimi “sherikeh” (shoqëri, partneritet). Kurse sot, koncepti “sherikeh” përdoret për të emërtuar ndërmarrjet përpunuese e prodhuese të ngritura nga dy ose më shumë vetë.



Lexim letrar

Allahu mjafton si dorëzanës!

Profeti (a.s.) tregoi se, në kohë të të bijve të Izraelit, një person kërkoi një mijë dinarë hua nga një person tjetër. Ai i tha:

- Më sill dëshmitarët e tu që të dëshmojnë kur të t'i jap!
- Allahu mjafton si dëshmitar! - Tha huamarrësi.
- Atëherë sill dorëzanës për këtë! - I tha huadhënësi.
- Allahu mjafton si dorëzanës! - Tha përsëri huamarrësi.
- Drejt fole! - Iu përgjigj huadhënësi dhe ia dha paratë me një afat kthimi të caktuar.

Huamarrësi u nis për një udhëtim në det dhe e kreu punën që kishte. Pastaj kërkoi një anije edhe për t'u kthyer në vendin e vet, edhe për t'ia kthyer huadhënësit huanë në kohë, por nuk gjeti. Huamarrësi u vu ngushtë. Atëherë, mori një dru pak a shumë të trashë, e gërreu nga brenda dhe futi aty paratë që i detyrohej huadhënësit si dhe një letër ku ia përshkruante gjendjen në të cilën ndodhej dhe që e kishte detyruar të vepronte ashtu. Pastaj e hodhi copën e drurit në det.

Në breg të detit, ndërsa copa e drurit po notonte për në thellësi, huamarrësi iu drejtua Zotit:

“Allahu im! Ti e di se pata marrë një mijë dinarë hua nga aksh njeri. Ai më pati kërkuar dëshmitarë dhe unë i pata thënë se Ti mjafton për dëshmitar. Pastaj, për këtë, më pati kërkuar dorëzanës dhe unë i pata thënë se Ti mjafton për dorëzanës. Personi pati mbetur i kënaqur dhe m'i pati dhënë një mijë dinarët, por unë tani nuk po gjej dot anije për t'u kthyer e për t'ia dhënë në kohë. Paratë dhe një letër i futa në atë copën e drurit që po ta lë Ty amanet t'ia çosh!”

Ndërsa huamarrësi u kthye në qytet për të pritur një anije, në anën tjetër huadhënësi po priste në liman anijen që do ta sillte huamarrësin se ishte mbushur afati dhe ai duhej t'ia kthente paratë. Ndërkaq, huadhënësit ia tërhoqi vëmendjen në det një copë dru që po vinte drejt tij. Ai priti gjersa copa e drurit doli në breg dhe e mori. Por s'pa ndonjë gjë të jashtëzakonshme në të. Megjithëkëtë, e mori me vete në shtëpi për ta dje-gur. Pastaj, në shtëpi, kur e çau, doli në shesh letra me paratë. Huadhënësi e lexoi me shumë habi letrën që i drejtohej atij dhe i mori paratë. Huaja iu kthye në kohë!

Pas ca kohësh, huamarrësi gjeti një anije dhe u kthye në vendin e vet. Duke pandehur se huadhënësi mund të mos i kishte marrë letrën dhe paratë, plotësoi një mijë dinarë dhe u nis te shtëpia e tij.

- Erdha të të kthej paratë, - i tha huadhënësit. - U përpoqa shumë të gjej anije për t'u kthyer në kohë, por s'munda. Ja ku i ke të një mijë dinarët!

- Mirë, po ti sikur më ke dërguar diçka mua! - I tha huadhënësi.

- Unë po të them që kërkova anije për t'u kthyer në kohë, por s'gjeta, - iu përgjigj huamarrësi.

- Unë i mora paratë në kohë! - Tha huadhënësi. - Në emër tënd, Allahu që ti e nxore për dëshmitar dhe dorëzanës, m'i dërgoi ato brenda një cope druri. Ato një mijë dinarët që ke në dorë, janë të tuat!

Dhe huamarrësi u kthye në shtëpi i qetë e i lumtur!⁵⁴



54 Buhari, Buju, 10.

PËRMBLEDHJE

1. Cilat janë kushtet e domosdoshme që shitblerja të jetë e vlefshme?
2. Jepni njohuri mbi llojet e shitblerjes.
3. Përmendni me pika çështjet që duhen bërë kujdes në ortakëritë.
4. Cilat janë llojet më të përhapura të ortakërisë?

PJESA V

ÇËSHTJE TË NDRYSHME TË JETËS TREGTARE E SHOQËRORE

ÇËSHTJET

- A. Çështje të ndryshme lidhur me tregtinë
- B. Çështje aktuale lidhur me tregtinë
- C. Çështje të ndryshme lidhur me jetën shoqërore

PUNË PËRGATITORE

1. Diskutoni se ç'përfundime jep në shoqëri përhapja e tregtisë me gënjeshtër dhe mashtrim.
2. Kërkoni të mësoni se a ka në Islam kufi fitimi.
3. Ç'bëni ju kur gjeni ndonjë gjë të humbur?
4. Mendoni se cilat janë dëmet që u shkakton individëve e shoqërisë tregtia me ambicjen për të fituar pa kufi.
5. Mblidhni njohuri mbi veprat vakfnore të vendit ku ndodhëni.

A. ÇËSHTJE TË NDRYSHME LIDHUR ME TREGTINË

1. Kufiri i fitimit (Sâr haddi)

As në Kuran, as dhe në praktikën e sahabëve nuk ka një raport të caktuar për masën e fitimit. Çështja e kufirit të fitimit, si parim, u është lënë vetë myslimanëve si individë ose si shoqëri. Si rrjedhojë, kufiri i fitimit është një ndër çështjet që rregullohen sipas kushteve shoqërore-ekonomike.

Kur shqyrtohen veprimet dhe praktikat e Profetit, duket qartë se ai është shmangur nga ndërhyrja në çmimet duke dashur që ato të krijohen vetvetiu në varësi të ekuilibrit kërkesë-ofertë të tregut.

Megjithëkëtë, që fitimi, pavarësisht nga masa, të jetë legjitim, është kusht që në fitim të mos jenë përzierë gënjeshtra, mashtrimi, kamata, tregu i zi dhe shtrëngimi, pra, të mos ketë padrejtësi. Për shembull, në shitjet e shoqëruara me fshehje të të metave të mallit, me reklama mashtruese që ndikojnë mbi klientët, ka padrejtësi. Çfarëdo madhësie të ketë fitimi i arritur në këto kushte, është jolegitim.

Nga ana tjetër kur shihet e nevojshme ose e domosdoshme, shteti mund të ndërhyjë në fitimet duke caktuar një masë të lejueshme për to. Në këto raste, kio masë shtetërore e marrë në interes të përgjithshëm, duhet respektuar. Për rrjedhojë, shitja me çmime të larta ose të skajshme duke nënvleftësuar kriteret e arsyeshme zakonore e tradicionale si dhe duke përfituar nga mosnjohja apo mirëbesimi i njerëzve, konsiderohet e padrejtë.

Si përfundim, në Islam nuk është vënë ndonjë kufi i sipërm apo i poshtëm i caktuar për fitimin, duke ia lënë këtë kushteve të natyrshme e morale si dhe, kur duhet, rregullimeve ligjore.

2. Mashtrimi i skajshëm (gabn-i fahish)

Është shitja apo bierja me mashtrim e një malli me një çmim shumë më të lartë ose më të ulët se çmimi i tregut. Kur malli blihet me një çmim shumë më të lartë se çmimi i tregut, dëmtohet blerësi, kurse kur shitet me një çmim shumë më të ulët se çmimi i tregut, dëmtohet shitësi. Në këtë rast, pala e dëmtuar mund t'i drejtohet gjyqit për kompensimin e dëmit, sepse mbrojtja e njerëzve nga padrejtësia dhe dëmtimi është parim në Islam. Kur dikujt i bëhet padrejtësi ose i shkaktohet dëm, e drejta duhet të shkojë në vend dhe dëmi duhet kompensuar në mënyrën më të drejtë dhe nëpërmjet organeve të drejtësisë.

3. Gënjeshtra dhe mashtrimi i qëllimshëm (tagrir)

Tagrir është gënjimi dhe mashtrimi i qëllimshëm i njëres palë nga pala tjetër me anë të fjalëve, gjeسته e sjelljeve.

Rastin kur një person që do ta shesë një kafshë që milet duke e lënë disa ditë pa e mjelë para se ta nxjerrë në treg me qëllim që në gjinjtë e saj të mblidhet qumësht për t'u dukur si kafshë që jep shumë qumësht, Profeti e ka cilësuar tagrir, mashtrim i qëllimshëm.⁵⁵ Gjithashtu, konsiderohet gënjim dhe mashtrim i qëllimshëm, kur shitësi deklaron të dhëna të gabuara ose mashtruese mbi cilësinë, veçoritë, vlerën e mallit si dhe raportin e fitimit ose kur hesht kur është e domosdoshme të deklarojë mbi një çështje të caktuar. Edhe deklaratat e tipit, "më dhanë këtë çmim, por nuk e dhashë", "kaq e ka vlerën, më poshtë nuk bën, del me dëm" etj., konsiderohen si gënjeshtra dhe mashtrime të qëllimshme.

Sigurimi i fitimeve në tregti me rrugë dhe mënyra të tilla bie në kundërshtim të hapur me ajetin kuranor, *"mos e hani mallin e njëri-tjetrit me rrugë të padrejta"*⁵⁶ si dhe me hadithin profetik, *"kush na gënjen ne, nuk është prej nesh"*.

Një ditë, kur kishte dalë në treg, Profeti kaloi pranë një burri që kishte nxjerrë një thes me grurë për ta shitur. Nga jashtë, gruri dukej shumë i mirë. Por kur Profeti e futi dorën dhe nxori grurë nga brenda, ai ishte me lagështirë. *"Ç'është kjo?"* - e pyeti ai burrin. "O i Dërguari i Allahut, e zuri shiu dhe mori lagështirë!" - iu përgjigj burri. Atëherë Profeti i tha: *"Nxirre sipër pjesën me lagështirë që ta shohin njerëzit! Kush na gënjen ne, nuk është prej nesh!"*⁵⁷

Një herë tjetër, te Profeti shkoi një njeri që, megjithëse e kishte humbur ekulibrin mendor për shkak të një goditjeje në kokë, vazhdonte të merrej me tregti. Ai iu ankua Profetit se e kishin gënjyer. Profeti u lut për të, e këshilloi të mos merrej me tregti dhe, më në fund, i tha: *"Megjithëkëtë, po deshe të vazhdosh të merresh me tregti, kur të blesh, thuaj: "Pa gënjeshtra!" Pastaj prit tri ditë; po qe se të pëlqen malli, mbaje, po qe se s'të pëlqen, ktheje brenda këtyre tri ditëve!"*⁵⁸

Si përfundim, në Islam, çdo lloj fitimi i arritur me gënjeshtra dhe mashtrime është haram. Ndërkaq, është jashtë çdo diskutimi se ky lloj fitimi ka për të ndikuar negativisht mbi adhurimin e personit, mbi jetën e tij individuale e familjare. Për

55 Buhari, Buju, 64.

56 Kurani, El-Bekare: 188.

57 Muslim, Iman, 164.

58 Taxh, II, 196.

rrjedhojë, nëse është bërë një gabim dhe është marrë një fitim i tillë, ai duhet t'i kthehet të zotit. Po qe se nuk mundet të bëhet kjo, ky fitim duhet hequr dorë sa më shpejt, duke e përdorur për ndonjë mirësi pa pritur shpërblim për të, duke mos harruar, megjithëkëtë, se kjo është e pamjaftueshme për të shpëtuar nga mëkati dhe faji i cenimit të së drejtës së personit.

4. Akaparimi dhe tregu i zi (ihtikar)

Treg i zi quhet shitja e mallrave me çmime të larta pasi ato janë akaparuar (grumbulluar) duke shkaktuar krizë pra dhe ngritjen artificiale të çmimit të 'tyre në treg.

Jo çdo grumbullim malli dhe jo çdo mall i grumbulluar futen në kategorinë e akaparimit e të tregut të zi. Që grumbullimi i mallit të konsiderohet akaparim, duhet që:

a) Malli i grumbulluar dhe i vënë në ruajtje për t'u nxjerrë në treg më vonë, të futet në produktet e nevojës së parë e të përditshme dhe që tregu të ketë nevojë për atë mall;

b) Kur grumbullimi i këtij malli të shkaktojë krizë, për pasojë, kur malli të nxirret në treg, t'u shkaktojë dëm blerësve për shkak të çmimit të lartë.

Ndryshe, grumbullimi i një malli, veçanërisht i një malli të nevojës së përditshme, me qëllim për të siguruar furnizimin ritmik të tregut jo vetëm me qëllim për të plotësuar kërkesat e përditshme, por edhe për të parandaluar akaparimin dhe tregun e zi, është një veprim i drejtë.

Në lidhje me këtë çështje, Profeti ynë ka thënë kështu: *"Ç'njeri i keq është spekulatori i tregut! Kur dëgjon se bien çmimet dëshpërohet, kurse kur dëgjon se ngrihen, gëzohet!"*⁵⁹

Në një hadith tjetër, Profeti thotë kështu: *"Ai që grumbullon dhe fsheh një lëndë ushqimore dyzet ditë (kur populli ka nevojë për të), largohet nga Allahu. Edhe Allahu e largon atë nga vetja!"*⁶⁰

Juristët Islamë, të mbështetur në këto dy hadithe, kanë thënë se akaparimi dhe tregu i zi janë haram, sepse, duke penguar furnizimin e rregullt të tregut dhe plotësimin e nevojave të shoqërisë, shkaktojnë prishjen e marrëveshjes dhe harmonisë shoqërore.

59 Texhridi sarih, IV, 549.

60 Ahmed ibn Hanbel, II,33.

B. ÇËSHTJE AKTUALE LIDHUR ME TREGTINË

1. Këmbimi i devizës dhe monedhës (sarf)

Këmbimi i monedhave prej ari e argjendi si dhe i çdo lloj monedhë (ose kartmonedhë) tjetër me monedhë ose kartmonedhë të të njëjtit lloj ose të llojeve të tjera quhet me termin sarf.

Në veprimin e këmbimit të monedhës (kartmonedhës) me monedhë (kartmonedhë) vihen si kushte që të mos ketë kamatë dhe që këmbimi të bëhet në dorë, aty për aty, pa shtyrje afati.

Në lidhje me këtë çështje, Profeti ka porositur: *"Mos e shitni arin dhe argjendin peshin (në dorë, efektiv) me ar e argjend jo peshin (jo në dorë, jo efektiv)!"*⁶¹ Prandaj, shitja e arit dhe argjendit me pagesë të afatizuar nuk është e lejueshme (xhaiz).

Të gjitha monedhat (devizat) që ndodhen në treg mund të këmbëhen me njëra-tjetrën meqë janë të të njëjtit lloj, por ky këmbim duhet të bëhet vetëm në mënyrë efektive, me të parë.

Si përfundim, këmbimi i monedhës (devizës) është i lejueshëm (xhaiz) kur bëhet me të parë, pa shtyrje afati.

2. Bursa, senedet (vërtetimet) dhe dividendët e aksioneve

Bursa është institucioni tregtar i ngritur dhe i kontrolluar nga shteti, ku bëhet shitblerja e mallrave. Ndërsa në fillim në bursë bëhej shitblerja e mallrave të tilla si ari dhe produktet bujqësore, (në ditët e sotme bursa është kthyer në institucionin ose tregun ku bëhet shitbleria jo e mallrave vetë, por e letrave me vlerë që i përfaqësojnë ato.

Në bursë ka lloje të ndryshme letrash me vlerë që shiten e blihen. Një nga këto është edhe senedi (vërtetimi) i pjesës aksionare ose, thjesht, aksioni (aksionet), fitimi i nxjerrë prej të cilëve quhet dividend. Aksioni është letra me vlerë që vërteton pjesën që zotëron pjesëtari i një ortakërie. Tregu ku bëhet shitblerja e aksioneve quhet Bursa e Vlerave të Tundshme!

Shitblerja e aksioneve është e lejueshme (xhaiz), sepse kjo është një ortakëri fitimi dhe humbjeje. Ndërkaq veprimtaria e ortakërisë përkatëse duhet të shtrihet

61 Buhari, Buju, 78; Muslim, Musakat, 81, 83.

në fusha që janë të lejueshme nga feja Islame. Nëse në veprimtarinë e ortakërisë në fjalë përdoren kamata, gënjeshtria, mashtrimi, akaparimi dhe tregu i zi, prodhimi dhe tregtimi i pijeve alkoolike, i produkteve narkotike e stupefiantë, etj. në përgjithësi, po që se për arritjen e fitimit përdoren rrugë, mënyra e mjete të konsideruara haram nga feja Islame, edhe shitblerja e aksioneve të ortakërisë në fjalë si dhe fitimi i nxjerrë konsiderohen haram.

Si përfundim, ndarja e pasurisë së një ortakërie (shoqërie apo ndërmarrjeje prodhuese apo tregtare) në pjesë (njësi vlerash) dhe shitja e tyre në formë aksionesh është e lejueshme (xhaiz). Ndërkaq, është një e vërtetë se, me anë të lajmeve dhe informacioneve mashtruese që ndikojnë në veprimtarinë e bursës, çmimi i aksioneve ngrihet apo ulet artificialisht, gjë që quhet spekulim burse. Dhe nuk duhet harruar se një praktikë e lejueshme (xhaiz) në parim, për shkaqe të tilla që lidhen me korrupsionin në bursë dhe që bien në kundërshtim me rregullat e përgjithshme tregtare Islamike, është bërë e dyshimtë.

3. Sigurimet

Sigurimet janë një sistem i mbështetur në pagesën reciproke që ka për qëllim të paguajë dhe kompensojë dëmet e shkaktuara nga aksidentet si dhe humbjet dhe nevojat e kuotapaguesve. Mes shoqërisë së sigurimeve dhe personit që kërkon të sigurohet në një fushë të caktuar, lidhet një marrëveshje sigurimi ku përcaktohen kuotat dhe detyrimet e të siguruarit si dhe detyrimet e shoqërisë së sigurimeve.

Janë tre lloje sigurimesh:

a) *Sigurimet shoqërore.* Është një sistem shtetëror sigurimi, ku përfshihen të gjithë nënshtetasit. Qëllimi i sigurimeve shoqërore është mbrojtja e nënshtetasve në gjendje të tilla, si: zjarri, aksidentet, sëmundjet, papunësia, etj. Në këtë mënyrë, shteti siguron solidaritetin dhe unitetin shoqëror. Për këtë, shteti i ngarkon nënshtetasit me disa përgjegjësi të drejta e të matura. Ky është një sistem sigurimi i përshtatshëm me parimet e përgjithshme të Islamit.

b) *Sigurimet e anëtarësisë profesionale e të punës.* Anëtarët e një profesioni ose veprimtarie bashkohen mbi bazën e kushteve, përgjegjësi dhe të drejtave të barabarta e reciproke për t'u mbrojtur nga dëmtimet e ndryshme. Meqë një sistem i tillë fuqizon solidaritetin dhe ndihmën reciproke mes anëtarëve të një profesioni ose pune, edhe ky lloj sigurimi është konsideruar i lejueshëm (xhaiz) nga Islami.

c) *Sigurimet individuale të paguara.* Në këtë sistem sigurimesh, siguruesi merr përsipër të dëmshpërblejë të siguruarin në raste të tilla, si: aksidentet, zjarret, vdek-

jet, etj. Ndërsa i siguruari i paguan kuotat rregullisht, siguruesi nuk i paguan të siguruarit asgjë jashtë kushteve të parashikuara në marrëveshjen e sigurimit. Në këtë lloj sigurimi ka disa aspekte që bien në kundërshtim me parimet e Islamit, si: gënjeshtria dhe mashtrimi, prandaj, shumica e juristëve Islamë e kanë konsideruar si të palejueshme (jo xhaiz) këtë lloj sigurimesh.

C. ÇËSHTJE TË NDRYSHME LIDHUR ME JETËN SHOQËRORE

1. Qiraja

Qiraja është dhënia e një malli dikujt për ta përdorur përkohësisht kundrejt një pagese të caktuar.

Veprimi i dhënie-marrjes me qira kryhet duke lidhur një marrëveshje mes palëve. Në marrëveshje duhet që të shënohen qartë dhe me hollësi kushtet e qirasë, si afati i dhënies me qira, kuota e qirasë, qëllimi i përdorimit, kushtet e dorëzimit dhe rikthimit, etj. Pasqyrimi me shkrim dhe në mënyrë të qartë në marrëveshje i të drejtave dhe detyrimeve të qiradhënësit e qiramarrësit është edhe domosdoshmëri e porosive të Profetit, edhe shprehje e natyrshme e sigurimit të një fitimi hallall dhe e respektimit të të drejtave të personit.

Juristët Islamë kanë kërkuar që, gjatë hartimit të marrëveshjes të parashikohen hollësisht të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin më vonë dhe të parandalohen ato duke shënuar çdo gjë me hollësi.

Në krye të përgjegjësisë së qiradhënësit është dhënia e mallit (objektit) në gjendje të mirë, të gatshme për t'u përdorur, kurse qiramarrësi ka për detyrë kryesore që ta përdorë mallin (objektin) me kujdes, me përkushtim si dhe t'i paguajë kuotat e qirasë brenda afatit të parashikuar në marrëveshje.

Nëse qiramarrësi i shkakton ndonjë dëm mallit (objektit) të marrë me qira si pasojë e përdorimit të tij në kundërshtim me kushtet e parashikuara në marrëveshje dhe të normave përkatëse të pranura nga shoqëria, është i detyruar ta paguajë dëmin. Për shembull, nëse një person ka zënë me qira një dyqan për argjendari dhe e përdor, pastaj, këtë, për shitje peshku, është i detyruar ta dëmshpërblejë qiradhënësin për të gjitha shkeljet dhe dëmet e shkaktuara.

Sipas shumicës së juristëve Islamë, një mysliman mund t'ia japë një truall me qira një jomyslimani me kusht që qiramarrësi të mos ta përdorë atë për të pirë pije alkoolike, si kishë, etj.

Po qe se pronari i objektit të dhënë me qira ia shet objektin një personi të tretë, ky person i tretë që është blerësi, është i detyruar ta presë mbarimin e afatit të qirasë për ta marrë në dorëzim objektin e blerë.

Kur qëllimi i marrjes së një malli (objekti) me qira, asgjësohet për shkak të tjetërsimit të mallit (objektit) dhe humbjes nga ana e tij e cilësive për të cilat është marrë me qira, si përmbytja e (përhershme ose e përkohshme - sipas marrëveshjes) e truallit, ngordhja e kalit, etj., marrëveshja e qirasë bie ose merr fund vetvetiu.

Fakti që pagesa e qirasë është shumë e ulët apo e lartë nuk e prish marrëveshjen po qe se nuk është pasojë e një gënjeshtre ose mashtrimi. Ndërkaq, nuk është mirë që mallrat (objektet) shtetërore, vakfnore ose të jetimëve të jepen me qira të ulët ose shumë të ulët në krahasim me tregun. Në këtë rast, marrëveshja e qirasë nxirret e pavlefshme dhe qiramarrësi duhet të paguajë dëmin e shkaktuar.

2. Marrëdhëniet punëtor-punëdhënës

Njeriu nuk mund t'i prodhojë vetë produktet dhe shërbimet për të cilat ka nevojë, prandaj janë të domosdoshme ndarja e punës dhe ndryshimi në produktet dhe shërbimet në mënyrë që secili veç e veç të plotësojë nevojat e veta. Në Kuran, duke tërhequr vëmendjen mbi urtësinë e krijimit të njerëzve me aftësi, mundësi dhe nevoja të ndryshme, është bërë e ditur se kjo ka krijuar mundësi që njerëzit t'i shërbejnë njëri-tjetrit.⁶² Ky sqarim që u jep karakter themelor ndarjes së punës mes njerëzve dhe marrëdhënieve punëtor-punëdhënës, reflekton, njëkohësisht, edhe qëndrimin e përgjithshëm të Islamit ndaj njeriut dhe marrëdhënieve detyrimore mes njerëzve.

Në Kuran, në lidhje me marrëdhëniet punëtor-punëdhënës, është përqendruar mbi parimet dhe qëllimet e përgjithshme dhe është përpjekur për të ngritur një bazë të shëndoshë për zhvillimin e marrëdhënieve detyrimore. Konkluzionet dhe praktikrat e detajuara që zënë vend në sunnetin e Profetit në lidhje me të drejtat e punëtorit, punëdhënien dhe përdorimin e fuqisë punëtore, janë zbatime praktike të këtyre parimeve të përgjithshme. Këto janë shembuj të reflektuar në jetë të mënjanimi të padrejtësive dhe ngritjes së marrëdhënieve të drejta e njerëzore si dhe të mënyrës së zgjidhjes së problemeve brenda formulës së njeriut të mirë e të myslimanit të mirë.

62 Kurani, Zuhruf: 32.

Në themel të jetës së punës ndodhet "kontrata e punës", që shpreh shërbimin e një njeriu ndaj një tjetri me shpërblim në produkte në natyrë ose monedhë. Kontrata e punës e hartuar sipas kushteve të caktuara, është e detyrueshme për të dy palët dhe lind një sërë të drejtash dhe përgjegjësisish. Edhe vlerësimi i Islamit ndaj marrëdhënieve punëtor-punëdhënës është i ngritur mbi të drejtat dhe përgjegjësitë reciproke.

a) Të drejtat dhe përgjegjësitë e punëdhënësit

Detyrimi themelor i punëdhënësit është t'ia japë punëtorit pagën ashtu siç është vendosur në kontratë, kurse e drejta themelore, kryerja e shërbimit apo punës që kërkon ai, të bëhet me cilësinë dhe në kohën e duhur. Punëtori që punon në bazë orari, fiton të drejtë page, duke punuar brenda atij orari dhe duke e plotësuar atë orar, kurse punëtori që punon në bazë norme, fiton të drejtë page pasi të plotësojë normën.⁶³ Profeti ynë ka porositur "të paguhet punëtori (t'i jepet haku punëtorit) pa iu tharë djersa"⁶⁴ dhe ka bërë të ditur se ata që nuk ia japin punëtorit pagën, në ditën e kiametit kanë për t'u përballur me Allahun!⁶⁵

Mes detyrimeve (përgjegjësi) themelore të punëdhënësit janë edhe sjellja e mirë ndaj punëtorit, njohja e të drejtave dhe lirive të punëtorit dhe krijimi i mundësive që punëtori t'i përdorë të drejtat dhe liritë e veta. Në një hadith, duke bërë fjalë për punëtorët, Profeti ka tërhequr vëmendjen edhe mbi aspektin njerëzor dhe moral të kësaj: "Ata që janë si vëllezërit tuaj, Allahu i ka vënë nën përgjegjësinë tuaj. Ai që ka nën vete një vëlla të tillë të fesë, ta ushqejë me atë që ha vetë dhe ta veshë me ç'vishet vetë. Mos i ngarkoni ata aq sa s'kanë fuqi dhe, po t'i ngarkoni, shkojuni në ndihmë!"⁶⁶

Kur punëdhënësi është shteti ose një institucion publik, merr një rëndësi të posaçme përgjegjësi për t'ia ngarkuar punën personit që është i specializuar dhe

63 Në punën me normë futet edhe puna, norma e së cilës është ditore, edhe puna, norma e së cilës përbën gjithë masën e punës që zgjat një kohë çfarëdo. Në këtë rast, shpërblimi i punëtorit përcaktohet sipas masës së përgjithshme të punës, pavarësisht se brenda sa ditëve do të kryhet ajo (ndonëse kontrata e asaj pune përcakton një numër optimal ditësh apo orësh) dhe i paguhet vetëm në mbarim të të gjithë masës së punës. Kurse në rastin e parë, paga ditore e punëtorit përcaktohet sipas normës ditore, megjithëkëtë, përgjithësisht, punëtori nuk mund të largohet nga vendi i punës pa mbaruar orari, veçanërisht kjo në ndërmarrjet ekonomike-prodhuese. Në këtë rast, punëtorit i kompensohet puna mbi normë me pagesë suplementare ose bëhen rregullime të normave sipas kategorive të aftësisht profesional në mënyrë që norma të përputhet me orarin dhe kompensimi përkatës bëhet sipas kategorive e jo sipas orëve.

64 Mexhmau'z-Zevahid, IV, 97.

65 Buhari, Ixhare, 10.

66 Buhari, Itk, 16.

kompetent, pra të aftë për atë punë. Profeti ka porositur: "Ai person, i cili punëson dikë tjetër sepse e njeh ose e ka të afërt, kur ka njerëz më të aftë, më kompetentë e më të denjë, ai i bën pabesi Allahut, të Dërguarit dhe të gjithë myslimanëve!"⁶⁷

b) Të drejtat dhe detyrat e punëtorit

Detyrimi më i rëndësishëm i punëtorit, i lindur nga kontrata e punës, është ta kryejë punën e përcaktuar në kontratë siç e do punëdhënësi, kurse e drejta më themelore është ta marrë pagën që i takon për punën e bërë.

Punëtori është i detyruar ta kryejë punën që ka marrë përsipër me kujdesin dhe korrektesën e duhur, të punojë gjatë gjithë orarit me përjashtim të plotësimit të nevojave legjitime dhe ta plotësojë përgjegjësinë që i takon. Profeti ynë ka porositur: "Pa dyshim, Allahu kënaqet kur njëri prej jush e kryen saktë punën që bën!"⁶⁸ Sjellja e një punëtori që, brenda kohës së punës, merret me punë të tjera jashtë dijenisë së punëdhënësit e në kundërshtim me porositë e tij ose nuk punon, është konsideruar, në një kuptim, si vjedhje e mallit të punëdhënësit.

Punëtori mban përgjegjësi për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e veglave të punës, materialeve të tjerave dhe rrobave që i janë dhënë për të punuar. Punëtori është i detyruar ta dëmshpërblejë punëdhënësin nëse e dëmton si rrjedhojë e mungesës së kujdesit të duhur për mirëmbajtjen e materialeve që i janë dhënë në ngarkim ose i dëmtimit të qëllimshëm të tyre.

Kur i mbajmë parasysh këto të drejta dhe detyra mes dy palëve, shihet se marrëdhëniet punëtor-punëdhënës nuk duhen menduar të ndryshme nga marrëdhëniet njerëzore dhe të drejtat e punëtorit, të ndryshme nga të drejtat njerëzore. Edhe parimet dhe qëllimet e përgjithshme të Islamit janë jo që një pjesë e shoqërisë të jetojë në mirëqenie apo vuajtje, por për t'i ndarë së bashku dhe në mënyrë të drejtë vështirësitë dhe mirëqenien. Nga ana tjetër, në shoqëri duhet vendosur një kriter drejtësie dhe të drejtash të mbështetura mbi parime të shëndosha. Prandaj, parimet e Islamit që u japin orientim dhe kuptim jetës dhe marrëdhënieve njerëzore, duhen përvetësuar mirë. Nuk duhet harruar se feja i përfshin si një të tërë ndërgjegjen e njeriut dhe jetën individuale e shoqërore. Këto parime kanë një rëndësi shumë të madhe që marrëdhëniet punëtor-punëdhënës të fitojnë një strukturë të shëndoshë të mbështetur mbi respektin, dashurinë dhe dinjitetin.

67 Ibni Haxher, el-Metalibu'l-aliye, II, 233.

68 Sujuti, el-Xhamiu'l-Kebir, I, 354.

3. Dhënia e bukur (kard-i hasen)

Në përdorimin e përditshëm, kard do të thotë mall ose para (pa interes) të dhëna dikujt me të drejtë rikthimi.

Në Kuran, fjala *kard* do të thotë, më shumë, dhënia borxh nevojtarëve për hir të Allahut ose ndihmë (dhurim) për të varfërit vetëm për hir të Allahut

Si ndihma pa shpërblim, edhe dhënia borxh nevojtarëve është konsideruar si virtyt. Me të vërtetë, në Kuran thuhet: **"A ka kush t'i japë një borxh të bukur Allahut (borxh pa interes ose kamatë nevojtarit) për t'ia kthyer Ai pastaj shumëfish?"**⁶⁹

Edhe Profeti ynë ka bërë të ditur se sadakaja e dhënë do të përftojë mirësi (the-vab) dhjetëfish, kurse borxhi i dhënë me qëllim të mirë, tetëmbëdhjetëfish. Gjithashtu, ka hadithe që thonë se myslimanit që i jep borxh dikujt që ndodhet në gjendje të vështirë, do t'i shkruhet nga një mirësi për çdo ditë gjersa t'i kthehet borxhi dhe, po qe se, pasi të mbushet afati i kthimit, nuk e shtrëngon borxhliun, do t'i shkruhet mirësi sa masa e borxhit ose edhe dyfishi i saj.⁷⁰

Nëse veprohet me mirëkuptim reciprok, *kard-i hasen* ose dhënia e bukur është një ndihmë shoqërore që forcon miqësinë dhe vëllazërinë, që shton besimin dhe sigurinë. Kjo frymë ndihme pa shpërblim në shoqëri duhet të ruhet patjetër, duhet të zhvillohet, madje të institucionalizohet.

4. Amaneti

Lënia amanet e një gjëje duke u mbështetur në besimin reciprok, është diçka që haset vazhdimisht mes njerëzve. Kur personi, të cilit i është lënë një gjë amanet, tregon kujdesin më të madh për të, nuk bëhet përgjegjës për dëmtimin e asaj gjëje pavarësisht nga kujdesi i treguar prej tij. Por nuk është e drejtë që personi, të cilit i është lënë një gjë amanet, ta përdorë atë vetë ose t'ua japë të tjerëve në përdorim pa lejen e të zotit.

Në Kuran thuhet: **"Ata (besimtarët) që e respektojnë fjalën e dhënë dhe amanetin..."**⁷¹ Si dhe: **"Kur t'i lini ndonjë amanet njëri-tjetrit, mbajtësi i amanetit t'ia kthejë atë të zotit dhe për këtë të keni frikë Allahun!"**⁷² Edhe Profeti ynë, në një

69 Kurani, El-Bekare: 245.

70 Ibni Maxhe, Sadakat, 19.

71 Kurani, Muminun: 8.

72 Kurani, El-Bekare: 283.

hadith, ka bërë të ditur se ai që nuk e respekton amanetin, nuk mund të jetë mysliman i vërtetë, kurse, në një hadith tjetër, ka bërë të ditur se mosrespektimi i amanetit është një ndër tri shenjat kryesore të hipokrizisë.⁷³

Nuk duhet harruar se, ashtu si çdo drejtim (administrativ, ekonomik, politik, shoqëror, fetar, etj.), edhe punët që i interesojnë shoqërisë si arsimi dhe edukimi, janë nga një amanet më vete, për rrjedhojë, u duhen dhënë njerëzve të drejtë, kompetentë e të besueshëm, sepse qetësia dhe lumturia e vërtetë arrihen vetëm në një shoqëri të përbërë prej njerëzish të besueshëm.

5. Malli i gjetur

Mall i gjetur quhet malli i humbur nga i zoti dhe i gjetur nga një person tjetër. Rregullimet ligjore të së drejtës Islame mbi mallrat e gjetura quhen, me një term, *lukata*.

Feja Islame ka vënë si synim që myslimanët të ngrenë një regjim shoqëror të sigurtë e të qetë e të jetojnë në një shoqëri të tillë. Prandaj, çështjet shoqërore me të cilat është përballur, e drejta Islame është përpjekur përgjithësisht t'i trajtojë në dimensionet e tyre morale, fetare e juridike duke dashur të sigurojë qëndrueshmërinë dhe stabilitetin në shoqëri.

Në kuadër të këtij synimi, Kurani i ka urdhëruar myslimanët të jenë të drejtë, të ndershëm e dinjitozë e t'ia japin amanetin të zotit. Kurani ka ndaluar dhënien e mangët të së drejtës që i takon tjetrit dhe ngrënien (përdorimin, shfrytëzimin, konsumimin) e padrejtë të mallrave që u përkasin te tjerëve.

Edhe Profeti ka vënë disa parime në lidhje me gjërat dhe kafshët e humbura nga sahabët e të gjetura nga të tjerët dhe ka dhënë disa urdhra e porosi. Kur e kanë pyetur sahabët se ç'duhet të bëjnë me gjënë e gjetur, ai u ka thënë që ta mbajnë në ruajtje për një vit me radhë duke lajmëruar dhe duke hetuar pronarin e saj. Po qe se brenda një viti del i zoti i gjësë, u ka thënë t'ia kthejnë gjënë dhe, po s'doli brenda kësaj kohe, edhe ta ruajnë si amanet, edhe ta përdorin. Ndërkaq, po qe se i zoti del një ditë pasi ta kenë përdorur, t'ia kthejnë. Profeti ka porositur: "*Kush gjen një gjë të humbur, ta deklarojë para dy dëshmitarëve e jo ta fshehë dhe, kur të dalë i zoti, t'ia kthejë. Po s'u gjend i zoti i mallit, ai mall bëhet i Allahut, i cili ia jep kujt të dojë!*"⁷⁴

73 Buhari, Iman, 24.

74 Ebu Davud, Lukata, 1.

Parimet e vëna nga Profeti lidhur me këtë çështje janë masa dhe zgjidhje që synojnë edhe t'i bëjnë myslimanët ta besojnë njëri-tjetrin e të kenë siguri te njëri-tjetri, edhe ta ruajnë mallin e humbur nga prishja.

Pikëpamjet e juristëve Islamë rreth çështjes së gjësë së humbur (lukata), mund të përmbliidhen kështu: Gjetja mund të bartë konkluzione të ndryshme në vartësi të gjendjes së mallit dhe qëllimit të gjetësit. Po qe se kur malli i humbur i gjetur nuk merret, prishet e shkon kot, marrja është më e drejtë dhe e pëlqyeshme (mendub). Madje, sipas dijetarëve, në këtë rast, marrja është domosdoshmëri (vaxhib). Kurse marrja e mallit të humbur të gjetur me qëllim për ta përvetësuar, është haram.

6. Vakfeti

Vakfi që do të thotë lënia, kushtimi i pronësisë ose i të ardhurave të një pasurie Allahut, është forma e institucionalizuar e mëshirës dhe dashurisë ndaj krijesave për hir të Krijuesit. Synimi dhe qëllimi i lënies së një pasurie si vakf është dhurimi bujarisht për krijesat nevojtare, trajtimi i tyre me dhembshuri për të fituar pëlqimin e Allahut.

Sipas themelimit, vakfi ka katër elementë:

a) Personi dhurues (që lë vakf); ky person duhet të ketë mbushur moshën e pubertetit, të ketë zhvillim mendor normal dhe të jetë i lirë (të mos i jetë hequr ose kufizuar liria).

b) Megjithëse për mallin e lënë si vakf, rregullisht kërkohet si kusht të jetë pasuri e patundshme, në praktikën e sahabeve është parë e lejueshme (xhaiz) edhe pasuria e tundshme duke u mbështetur në zakonet dhe traditat e vendit.

c) Vakfi mund t'i lihet një personi apo një grupi të caktuar që nuk është kusht të jetë apo të jenë myslimanë.

d) Akt-dhurimi i vakfit i përgatitur nga dhuruesi përmban kushtet e përdorimit të tij që janë legjitime e të pranueshme.

Malli ose të ardhurat e tij që lihen (dhurohen) si vakf, dalin nga pronësia e dhuruesit dhe kthehen në një pasuri të përbashkët nga e cila përfitojnë krijesat, pra, pas kësaj, kjo pasuri e përbashkët nuk mund t'i kalojë në pronësi askujt. Edhe kushtet e vëna nga dhuruesi, meqë janë të pakontestueshëm si urdhrat fetare, nuk mund të ndryshohen.

Në Kuran këshillohet shpenzimi në rrugë të Allahut dhe për të mirën e përbashkët të të gjithë njerëzve, këshillohet solidariteti dhe ndihma shoqërore. Për

shembull, në një ajet thuhet: **"Nuk mund ta arrini mirësinë e vërtetë pa shpenzuar nga gjërat e dashura në rrugën e Allahut!"**⁷⁵ Kjo lloj shprehje dhe nxitje e përdorur në Kuran ka formuar themelin e mendësisë dhe praktikës së vakfit në shoqëritë myslimane.

Profeti ka bërë të ditur se, kur vdes personi, i mbyllet libri i punëve, por, po që se ka lënë pas ndonjë të mirë pasvepruese (sadaka-i xharije), do të vazhdojë të fitojë mirësi (thevab).⁷⁶ Edhe vetë, pjesën e tij në trojet Fedek dhe Hajber ua pati lënë myslimanëve.⁷⁷ Edhe Hz. Omeri, Hz. Osmani dhe sahabët e tjerë janë bërë, me vepërimet e tyre, shembull për njerëzimin.

Feja Islame është fe ndihme, solidariteti dhe vëllazërie. Ajo e quan për detyrë t'ua shtrijë dorën e ndihmës jo vetëm anëtarëve të saj, por gjithë njerëzimit, madje gjithë qenieve. Vakfet e krijuara si rezultat i parimit të ndihmës Islame ekzistojnë në të gjitha vendet Islame në një numër aq të madh sa s'mund të numërohen dhe kanë kryer shërbime të ndryshme e të çmuara. Pas vakfeve të ngritura nga Profeti dhe kalifët, çdo mysliman që ka pasur mundësi është përpjekur me zell të madh për të ngritur një institucion të tillë.

Vakfet vazhdojnë të ekzistojnë dhe funksionojnë edhe sot si institucione që plotësojnë nevojat e njerëzve, që lidhin plagët e shoqërisë dhe i mbajnë gjallë vlerat moralo-shpirtërore të saj.

Vakfet janë institucioni më me rëndësi që e dallon qytetërimin Islam nga qytetërimet e tjera. Në asnjë qytetërim nuk mund të haset në një humanizëm të tillë të lartë si humanizmi i shfaqur prej myslimanëve!

Në shoqëritë dhe shtetet Islame është treguar kujdes i veçantë për mbrojtjen e tokave, veçanërisht pyjeve si pronë e përbashkët e shoqërisë Islame, për mbrojtjen e pasurive të vakfeve dhe të personave të dobët, të vetmuar e të pafuqishëm. Fakti që këto lloj pronash e pasurish janë arritur të mbrohen ndaj një sërë veprimesh grabitqare, është një nga treguesit më të rëndësishëm të qytetërimit të arritur nga ajo shoqëri.



75 Kurani, Al-i Imran: 52.

76 Ebu Davud, Dijat, 5.

77 Buhari, Vasaja, 1.

Lexim letrar Dhënia e bukur

Kurani thotë: **"Kurrë s'mund të arrini te e mira e vërtetë po të mos shpenzoni në rrugën e Allahut nga gjërat që doni më shumë!"** (Kurani, Al-i Imran-192)

Pas zbritjes së këtij ajeti, mes sahabeve filloi një garë e madhe për të dhuruar nga gjërat më të dashura.

Ebu Talhai kishte pranë faltores profetike një pemëtore shumë të çmuar prej afro gjashtëqind rrënjë hurmash. Ai e donte shumë këtë bahçe. Herë pas herë e ftonte Profetin aty, e gostiste me hurma dhe, kështu, prodhimi i shtoej ca më shumë!

Një ditë, Ebu Talhai i tha kështu Profetit:

"O i Dërguari i Allahut! Gjëja më e çmuar e pasurisë sime është bahçeja e hurmave këtu që e di edhe ti. Nga ky çast e tutje, për hir të Allahut, po ta lë ty! Përdore si ta duash dhe jepi cilit të varfër që të duash!"

Pas këtyre fjalëve, Ebu Talhai shkoi menjëherë në kopshtin e hurmave për t'ia treguar edhe të shoqes vendimin e marrë. Të shoqen e gjeti tek po rrinte aty në anë, nën hijen e një hurme. Ebu Talhai nuk hyri brenda. E shoqja e pyeti:

- Ç'pret aty jashtë, Ebu Talha? Hyr brenda!

Ebu Talhai i tha:

- Unë s'mund të hyj, por edhe ti, mblidhi gjërat e dil jashtë!

- Po pse, o Ebu Talha? - E pyeti e shoqja e habitur nga një e papritur e tillë. - A s'është kjo bahçeja jonë?

- Jo, kjo s'është më bahçeja jonë, por e të varfërve të Medines!

Dhe Ebu Talhai i foli të shoqes me gëzim për ajetin e Kuranit dhe vlerën e madhe të dhuratës që kishte bërë nën frymëzimin e atij ajeti.

- Mirë, po a e dhurove në emër të të dyve ne, apo vetëm në emrin tënd? - E pyeti e shoqja.

- Në emër të të dyve! - Iu përgjigj Ebu Talhai.

- Allahu qoftë i kënaqur me ty, o Ebu Talha! - Ia ktheu tërë gëzim e shoqja. - Edhe unë kam kohë që po e mendoj këtë gjë kur shoh gjithë këta të varfër rreth nesh, por nuk kam guxuar të ta them. Allahu na e pranofte këtë mirësi! Ja, edhe unë po dal!

Ja, pra, nuk është aspak e vështirë ta mendosh se ç'lumturi do të sundonte në botë po të rrënjosej në zemra një dëshirë e tillë mirësie dhe po të përhapej një moral i tillë i bukur!



PËRMBLEDHJE

1. A është vënë në Islam ndonjë kufi për fitimin?
2. Shpjegojëni shkurt se ç'është mashtrimi i skajshëm.
3. Ç'janë gënjeshtra dhe mashtrimi në tregti?
4. Shpjegoni dëmet e akaparimit e të tregut të zi.
5. Shpjegoni se në ç'kushte është i lejueshëm (xhaiz) këmbimi i monedhës dhe i devizës.
6. Përcaktoni konkluzionin e të drejtës Islame mbi bursën dhe ak-sionin.
7. Cili është konkluzioni fetar mbi sigurimet?
8. Shpjegoni çështjet që duhen mbajtur parasysh nga qiradhënësi dhe qiramarrësi gjatë nënshkrimit të aktit të dhënies me qira.
9. Cilat janë në Islam të drejtat dhe përgjegjësitë themelore të pu-nëtorit dhe punëdhënësit?
10. Shpjegojëni konceptin e dhënies së bukur.
11. Shpjegojëni nën dritën e një ajeti rëndësinë e respektimit të ama-netit.
12. Cili është konkluzioni mbi mallin e gjetur?
13. Ç'është vakfi? Ç'gjëra të mira i sjell shoqërisë vakfi?

PJESA VI

E DREJTA PENALE ISLAME

FAJET DHE NDËSHKIMET

ÇËSHTJET

- A. Vështrim i përgjithshëm mbi fajet dhe ndëshkimet
- B. Qëllimet e sistemit penal Islam
- C. Fajet dhe ndëshkimet

PUNË PËRGATITORE

1. Kërkoni në një enciklopedi konceptet "faj" dhe "ndëshkim".
2. Kërkoni të mësoni se ç'lloj ndëshkimesh jepen në sistemet e ndryshme të së drejtës për faje të tilla, si: vjedhja, pirateria, pija, marrëdhënia seksuale e paligjshme, vrasja dhe terrori.
3. Diskutoni me shokët mbi shkaqet që i shtyjnë njerëzit të kryejnë faje.
4. Nga përkthimi shqip i Kuranit, veçoni ajetet mbi fajet dhe ndëshkimet që jepen për to.

A. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI FAJET DHE NDËSHKIMET

Feja Islame e dërguar për t'i bërë njerëzit të fitojnë lumturinë e kësaj bote e të jetës tjetër (ahiret), e ka përfshirë njeriun në të gjitha aspektet dhe, me parimet që ka sjellë, ka ngritur një rend shoqëror të caktuar. Ka shqyrtuar veç e veç marrëdhëniet e njeriut me të gjitha qeniet e tjera dhe ka sjellë rregulla të caktuara për të gjitha fushat. Ndërsa ka miratuar kryerjen e disa akteve, ka ndaluar kryerjen e disa akteve të tjera. Ka bërë të ditur se njerëzit që do të respektojnë rregullat e vëna, do të shpërblehen në këtë botë ose në botën tjetër (ahiret), kurse ata që do t'i, shkelin rregullat e do të bëjnë faje, do të ndëshkohen.

Islami u jep një rëndësi të posaçme edukimit të vetvetes, mbushjes së zemrës me dashurinë për Allahun ndjenjës së përgjegjësisë për jetën e pasme (ahiret) dhe zgjimit të prirjes për bindje ndaj Allahut dhe Profetit si dy domosdoshmëri themelore të besimit. Pas kësaj, Islami paralajmëron njeriun mbi pasojën e keqe të kryerjes së akteve të ndaluara, mbi dëmet që u sjell kjo edhe personit që i kryen, edhe vëllezërve të tij të besimit. Krahas këtyre, Islami ka marrë të gjitha masat paraprake që sigurojnë mbajtjen e njeriut larg akteve të ndaluara. Kështu, Islami nuk lë as hapësirë për dëmtim, as nevojë për kryerjen e akteve të ndaluara.

Nga ana tjetër, feja Islame ka bërë të ditur se do të ndëshkojë personat që nuk i njohin këta kufinj dhe pengesa, që e dëmtojnë veten duke vepruar sipas dëshirave dhe pasioneve vetjake si dhe që veprojnë në dëm të interesit të përgjithshëm. Pikërisht kjo është në përputhje me të drejtën dhe drejtësinë. Në të kundërt, një pjesë njerëzish që e përdorin për të keq një dhunti të tillë të madhe e të bukur si mendja, shndërrohen në individë të dëmshëm si për vete, ashtu dhe për shoqërinë.

B. QËLLIMET E SISTEMIT PENAL ISLAM

Si rezultat i natyrshëm i të qenit hallka e fundit e kumtimit hyjnor të nisur me Hz. Ademin dhe fe mëshire për të gjitha krijesat, Islami ka ngritur drejtpeshim dhe unitet mes botës dhe ahiretit, individit dhe shoqërisë, kompleksit besim-adhurim-moral dhe drejtësisë juridike. Krahas marrëdhënieve të individit me krijuesin, ka trajtuar dhe rregulluar, në linjat kryesore, edhe marrëdhëniet shoqërore (Me anë të parimeve dhe urdhrave shumë herë të përgjithshme, kur duhet, edhe të posaçme, ka vënë si synim të zhvillojë dhe mbrojë jetën shoqërore, ekonomike e juridike.

Si burimi kryesor i fesë Islame, Kurani dhe Sunneti është edhe burimi bazë i të drejtës penale Islame, prandaj dhe përcakton parimet themelore dhe qëllimet në këtë fushë. Nisur nga përfundimi, ndëshkimet e përcaktuara nga Kurani dhe Sunneti synojnë mbrojtjen e pesë vlerave themelore, mendjes (arsyes), fesë, jetës, nderit dhe pasurisë, mbrojtjen e të cilave Islami e ka për parim, synojnë ruajtjen në ekuilibër të dobive të përgjithshme dhe private të njerëzve. Këto ndëshkime janë pjesë e parimit dhe përpjekjes së Islamit për ta parandaluar të keqen dhe për ta bërë sunduese të mirën.

Feja Islame i jep më shumë rëndësi organizimit të një mënyre jetë dhe formë shoqërie ku kryerja e fajit të zbritet në minimum, parandalimit të së keqes dhe legjitimizimit të saj. Prandaj, sistemi fetar dhe moral i sjellë nga Islami synon më shumë se sa ndëshkimin e fajit, mënjanimin e shkaqeve që e lehtësojnë kryerjen e fajit.

Ndëshkimi nuk është qëllim, por një mjet i përdorur si zgjidhje e fundit për realizimin dhe mbrojtjen e synimeve të vëna nga Islami. Pra, Islami e përdor metodën e ndëshkimit në kushtet kur të gjitha masat e tjera që pengojnë shkeljen e të drejtave të të tjerëve, mbeten të pamjaftueshme. Qëllimi i ndëshkimit është, në përgjithësi, mbrojtja e rendit shoqëror si pengesë për kryerjen hapur dhe përhapjen e fajit, kurse, në veçanti, parandalimi i fajit dhe përmirësimi i fajtorit. Për rrjedhojë, ndëshkimi që do t'i jepet fajtorit, duhet të jetë në atë masë dhe formë që t'i mbrojë të drejtën juridike dhe vlerat e përbashkëta të shoqërisë, të pengojë kryerjen dhe përsëritjen e fajit, ta riedukojë fajtorin, ta kënaqë ndërgjegjen shoqërore për ta shuar ndjenjën e viktimës për hakmarrje. Ndëshkimi i dhënë në këtë kuadër përbën një pjesë të drejtësisë dhe mëshirës hyjnore.

C. FAJET DHE NDËSHKIMET

A. Fajet që kërkojnë dënim të rëndë (hadd)

B. Fajet që kërkojnë dënim analog (kisas)

C. Fajet që kërkojnë dënim me riedukim (tazir)

A. Fajet që kërkojnë dënim të rëndë

Dënimi i rëndë jepet për shkelje të së drejtës së rendit të përgjithshëm shoqëror me vrasje, pirateri e grabitje, marrëdhënie seksuale të paligjshme, vjedhje dhe pije alkoolike. Kompetenca e dënimit të rëndë i takon drejtpërsëdrejti Allahut; forma dhe ekzekutimi i saj janë përcaktuar në Kuran. Organet kompetente shtetërore ose gjykatësi (kadiu), ose viktimat e drejtpërdrejtë e fajit as mund t'i lehtësojnë këto faje, as mund t'i shtojnë, as mund t'i ndryshojnë e as t'i falin.

Arsyetimi i pranimit nga e drejta Islame të dënimit të rëndë për këto lloj fajesh është ky: këto fajë bartin një rrezik evident për shoqërinë, sepse përbëjnë rrezik kundër mbështetjeve themelore të çdo shoqërie. Prandaj, sjellja me mirëkuptim ndaj këtyre fajëve i hap rrugë pa diskutim prishjes së moralit, lëkundjes së rendit dhe sigurisë së shoqërisë, gjë që çon në copëtimin dhe shthurjen e shoqërisë. Mirëpo e drejta Islame është një sistem drejtësie që ka për qëllim t'i mbrojë shoqëritë nga rënia në një përfundim të tillë. Prandaj, qëllimi i dhënies së një përgjigjeje të ashpër për këto lloj fajesh është mbrojtja e moralit, rendit dhe stabilitetit të shoqërisë. E thënë ndryshe, është dobia e përgjithshme.

Fajet që kërkojnë dënim të rëndë janë:

1. Vjedhja
2. Marrëdhënia seksuale e paligjshme (zina-adulter)
3. Shpifja për nder
4. Grabitja dhe pirateria
5. Pirja e pijeve alkoolike
6. Kthimi nga feja (irtidat)
7. Kryengritja dhe revolucion

1. Vjedhja

Faji i vjedhjes për të cilin kërkohet dënim i rëndë, është përkufizuar kështu: përvetësim i një malli të një mase të caktuar në ruajtje, që nuk priset (shpërbëhet) në çast ose shpejt, që i përket një tjetri, nga ana e një personi me gjendje mendore normale dhe që ka arritur moshën e pubertetit.

Sipas përkufizimit të mësipërm kushtet e rëndësishme të vjedhjes për të cilën kërkohet dënim i rëndë, janë këto:

1. Vjedhësi duhet të jetë me gjendje mendore normale e të ketë arritur moshën e pubertetit.

2. Malli i vjedhur nuk duhet të jetë nga gjërat që prishen shpejt, si mishi, perimet, etj.

3. Malli i vjedhur duhet të jetë i një sasive të konsiderueshme (që të përbëjë vlerë), Mes shkollave juridike ka ndryshime pikëpamjesh mbi përcaktimin e masës minimale që përbën vlerë. Sipas hanefitëve, masa minimale është 10 dërhëm (në periudhat e para, me 10 dërhëm bliheshin 2 dele).

4. Malli duhet të jetë i vjedhur nga vendi ku është vënë nën ruajtje.

Dënimi:

Dënimi për vjedhjen është përcaktuar me këtë ajet:

"Mashkullit dhe femrës që vjedhin, pritjuani duart si ndëshkim për aktin që kanë bërë dhe si mësim nga Allahu (për të tjerët)?"⁷⁸

Sipas këtij ajeti, dënimi për fajin e vjedhjes është prerja e dorës së vjedhësit.

Urtësitë e dënimit për vjedhje

Islami ka për synim të krijojë një shoqëri që t'i plotësojë njeriut jo vetëm nevojat shpirtërore, por, në të njëjtën kohë, edhe ato trupore e mendore. Çdo anëtar i shoqërisë Islame i takon një pjesë nga burimet ekonomike të shoqërisë dhe, kështu, ka të drejtë të përfitojë nga sigurimi shoqëror. E thënë ndryshe, çdo qytetari duhet t'i sigurohet një standard jetese me drejtësi në përputhje me burimet që zotëron shoqëria.

Rregullimet shoqërore të Islamit synojnë një strukturë administrative që t'i sigurojë çdo mashkull i femre të rritur dhe çdo fëmijë, a) ushqim të mjaftueshëm, b) banesë të mjaftueshme, c) barazi rastesh dhe mundësish arsimimi dhe d) shërbim miekësor falas. Për rrjedhojë, çdo anëtar i shoqërisë duhet t'i sigurohet, kur ka arritur moshën për punë dhe është i shëndoshë, e drejta për të punuar, prodhuar dhe fituar, kurse, në kushtet e sëmundjes, varfërisë, papunësisë së detyrueshme, pleqërisë ose pamundësive për shkak të moshës së vogël, ushqyerje e mjaftueshme, strehim, etj., nga ana e shoqërisë apo shtetit. Në kushtet e rendit ekonomik dhe shoqëror të sjella nga Islami, nuk mund të mendohet që dikush të mbetet i detyruar që, për shkak të urisë, të vjedhë. Islami e ka pranuar shoqërinë si një të tërë të pandarë.

Fakti që Kurani ka vënë për vjedhjen prerjen e dorës si dënim me forcë të madhevepruese e parandaluese, është domosdoshmëri e këtij programi sigurie të parashikuar nga Islami. Në një shoqëri, ku për çdo individ është garantuar një siguri dhe drejtësi shoqërore e plotë, tentativa e një individi për të arritur fitim të lehtë e të padrejtë në dëm të individëve të tjerë duhet parë si sulm ndaj tërë sistemit dhe sipas kësaj duhet ndëshkuar.

Ndërkaq, nëse shoqëria nuk e kryen detyrën e saj dhe individit nuk i sigurohen kushtet e domosdoshme të përshkruara si më sipër, për çka individ i mbetet i detyruar që, për uri apo nevoja të tjera të ngjashme, të vjedhë, nuk zbatohet dënimi i rëndë. Kështu, në një vit krize, Hz. Omeri e pati pezulluar këtë dënim të rëndë. Por, në kushtet normale kur s'paraqitet nevoja dhe kur shkaqet për vjedhje në shoqëri janë zbritur në minimum, vjedhja konsiderohet një faj i rëndë dhe ndëshkimi i saj i tillë duhet të jetë.

2. Marrëdhënia seksuale e paligjshme (Zina-Adulter)

Faji

Është marrëdhënia seksuale e vullnetshme mes një mashkulli dhe femre, që nuk janë të lidhur mes tyre me kurorë martesore.

Për dhënien e dënimit të rëndë për fajin e zinasë (adulter) sipas përshkrimit të mëposhtëm, është vënë si kusht pohimi i hapur i autorëve të aktit ose vërtetimi i katër dëshmitarëve.

Dënimi

Dënimi për fajin e zinasë është përcaktuar në Kuran kështu:

"Secilin prej mashkullit dhe femrës që kanë bërë zina, qëllojini me nga 100 shkopinj. Po qe se i besoni Allahut dhe Ditës së Ahiretit, duhet të mos ju rrëmbejë ndjenja e keqardhjes kur duhet zbatuar feja e Allahut. Dhe një grup myslimanësh të vëzhgojnë si dëshmitarë zbatimin e dënimit!"⁷⁹

Sipas këtij ajeti, dënimi i personave që bëjnë zina (adulter), është 100 shkopinj. Por Profeti e ka zbatuar këtë ndëshkim për beqarët, kurse për të martuarit ka zbatuar dënimin me vdekje. Kështu, dënimi me vdekje është vendosur sipas praktikës së Profetit.⁸⁰

Urtësitë e dënimit për zinanë (adulter)

Sipas fesë Islame, marrëdhënia seksuale e paligjshme (zina-adulter) është një gjynah (mëkat) shumë i shëmtuar, sepse ky akt jo vetëm e cenon nderin dhe dinjitetin e njeriut, por prish edhe rendin shoqëror. Gjithashtu, zinaja është shkak i prishjes së brezit. Vendet, ku përqindja e akteve të zinasë është e lartë, janë plot me fëmijë të hedhur në rrugë ose të braktisur nëpër shtëpitë e fëmijës, të cilët, meqë rriten jashtë familjes dhe pa dashurinë prindërore, bëhen fajtorë potencialë për shoqërinë.

Njëri prej synimeve kryesore të Islamit është mbrojtja e mendjes, brezit, qenies njerëzore, fesë dhe nderit, gjë që është synim edhe i të gjitha feve qiellore si dhe ligjeve të qytetëruara, sepse kjo është domosdoshmëri për vazhdueshmërinë e jetës së njeriut. Meqë mbrojtja e brezit bart një rëndësi të madhe, Islami ka vënë dënime me qëllim për të parandaluar prishjen e tij, madje për të mënjanuar plotësisht rrezikun e prishjes së tij. Me këto ndëshkime, ai ka synuar, njëkohësisht, të realizojë stabilitetin dhe sigurinë në shoqëri.

79 En-Nur, 2.

80 Buhari, Hudu'd, 21, 30, 32; Ebu Davud, Hudud, 23, 25.

Synimi themelor i Allahut për t'u dhënë njerëzve dëshira seksuale është mbrojtja e brezit njerëzor dhe sigurimi i vazhdueshmërisë së tij, gjë që është e mundur vetëm me anë të fëmijëve familjarë të lindur si rezultat i një martesë të shëndoshë. Lidhur me këtë, Allahu i Lartë thotë:

"Allahu krijoi për ju një shoqe nga vetja juaj dhe ju dha juve nga shoqet bij, nipër e mbesa. Dhe ju furnizoi ju me dhunti nga më të mirat. A po i besojnë ata tani të shtrembrës dhe po tregohen mosmirënjohës ndaj dhuntive të Allahut?"⁸¹

Sipas fesë Islame, marrëdhënia seksuale e jashtëligjshme (zina-adulter) është jo vetëm shkalla më e ulët e imoralitetit, por edhe mëkati më i dëmshëm nga ana shoqërore. Prandaj, për parandalimin e këtij faji duhen marrë masa të ashpra.

Për ta shpëtuar njeriun nga e keqja e zinasë, krahas ligjeve penale, Islami merr, në shkallë të gjerë, edhe masa konstruktive, rregulluese e parandaluese. Islami i drejtohet ndëshkimit si zgjidhje e fundit. Synimi i vërtetë i Islamit është që të arrijë që ky faj të mos kryhet kurrë dhe që askush të mos ndëshkohet me këtë dënim të rëndë. Prandaj, para së gjithash, Islami e pastron njeriun dhe i shtreson në zemër frikën ndaj Allahut që di çdo gjë dhe ka mundësi për çdo gjë. E pajis njeriun me ndjenjën se ka për të dhënë llogari në jetën e pasme (ahiret) për ato që ka bërë. I shtreson njeriut në zemër më parë një besim të vërtetë, pastaj domosdoshmërinë e bindjes ndaj ligjshmërisë hyjnore. Dhe, pastaj, në vende të ndryshme, Kurani e shpreh në mënyrë të përsëritur se zinaja dhe pandershmëria janë faje të rënda e të shëmtuara që Allahu ka për t'i ndëshkuar në një mënyrë të ashpër.

Feja Islame që ka sjellë ndëshkim të rëndë për fajin e zinasë, ka siguruar të gjitha lehtësitë për martesë. Madje ka dhënë leje për martesë gjer me katër gra për ata që kanë mundësi materiale dhe mund të sigurojnë drejtësinë mes tyre si dhe për ata që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mjaftohen me një grua. Nëse gruaja dhe burri nuk mund të kalojnë me fytyrë të qeshur dhe fjalë të ëmbël, janë përgatitur mundësitë dhe lehtësitë e domosdoshme për ndarje. Në kushtet e mosmarrëveshjes mes bashkëshortëve, ekzistojnë gjithmonë zgjidhje si ndërmjetësim me anë të anëtarëve të të dy familjeve, në pamundësi të kësaj, ndarje dhe rimartesë.

Vetëm pas gjithë këtyre masave është shpallur se zinaja është një faj që duhet ndëshkuar dhe është ndaluar përhapja e imoralitetit, pavarësisht nga forma. Meshkujt dhe femrat janë urdhëruar që t'i zotërojnë shikimet me qëllim për të mos u hapur derën epshit dhe dashurive apo iudhjeve jolegjitime. Dhe vetë dënimi përkatës është për ata persona që, pas gjithë këtyre urdhrave dhe masave parandaluese

81 En-Nahl, 72.

të sjella për përmirësimin e individit dhe shoqërisë, vazhdojnë të përdorin rrugë të ndaluara (haram) për të kënaqur dëshirat seksuale.

Për ta quajtur një person fajtor për zina (adulter) dhe për ta ndëshkuar, duhet që të vërtetohet në mënyrë të prerë se ai e ka kryer aktin me vullnetin e tij të lirë. Po që se personi e ka kryer aktin në kushte shtrënguese, nuk dënohet. Kjo mbështetet në parimin e të drejtës Islame që nuk e bën personin përgjegjës për aktet e tij, kur i ka kryer ato nën shtrëngim.

Në të drejtën Islame, dënimi nuk jepet dhe nuk ekzekutohet pa u vërtetuar faji në mënyrë të prerë. Kjo mbështetet në thënien e Profetit: *"Sa të keni mundësi, mos i ndëshkoni myslimanët. Po që se ekziston një rrugëdalje, personin lëreni të lirë, sepse gabimi i imamit (gjykatësit) duke e falur gabimin (e bërë) është më i mirë se gabimi duke e ndëshkuar fajin (e pabërë)"*⁸² Prandaj, për vërtetimin në mënyrë të prerë të fajit të zinasë, Islami ka vënë si detyrim dëshminë e katër dëshmitarëve okularë të besueshëm ose pohimin e sinqertë për të cilin nuk kihet dyshim.

Pasi çështja merr formë të prerë dhe gjykatësi ka informacion të plotë për këtë, ekzekutimi i dënimit bëhet i detyrueshëm e i pashmangshëm. Sjellja e plogësht në zbatimin e urdhrave të Allahut, në rastin konkret, do të thotë keqardhje për fajtorin, gjë që është padrejtësi ndaj shoqërisë, rregullave të edukatës dhe ndërgjegjes njerëzore. Kjo keqardhje është e shtirur, sepse Allahut të Lartë i vjen më shumë keq për robtë e vet! Ai këtë ka zgjedhur për ta. "Pasi Allahu dhe i dërguari i Tij të kenë konkluduar për një çështje, asnjë besimtar mashkull apo femër nuk ka të drejtë të bëjë një zgjedhje tjetër!"⁸³ Sepse Allahu i Lartë e di më mirë se cila është natyra e robve të vet, interesi i tyre. Sado i ashpër e i rëndë që të jetë ky ndëshkim, është shumë më i lehtë se fundi i hidhur që e pret jetën e një shoqërie ku është prishur natyra e krijimit, ku është shembur foleja familjare.

Dënimi i dhënë për fajtorin është, në të njëjtën kohë, një faktor psikologjik pengues për ata që kanë të njëjtën prirje. Ky nuk është një dënim i dhënë vetëm për fajtorin, por, në të njëjtën kohë, një shpallje se, në shoqërinë Islame, askush nuk mund të bëjë një jetë dëfrimi e kënaqësie të pakufi!

3. Shpifja për nder

Faji

Shpifje për një femër myslimane të ndershme se ka kryer marrëdhënie seksuale të paligjshme (zina).

⁸² Tirmidhi.

⁸³ Ahzab, 36.

Për formimin e fajit të shpifjes për nder (zina) duhet të plotësohen këto kushte:

1. Shpifësi duhet të ketë gjendje mendore normale dhe të ketë arritur moshën e pubertetit.

2. Viktima e shpifjes duhet të jetë femër myslimane, me gjendje mendore normale, e pjekur (seksualisht), e lirë dhe e virtytshme.

3. Marrëdhënia seksuale për të cilën akuzohet femra, të mos jetë vërtetuar (të mos jenë sjellë katër dëshmitarë që të dëshmojnë dhe vërtetojnë se femra në fjalë e ka kryer aktin për të cilin akuzohet).

Dënimi

Dënimi për shpifësin për nder (zina) është përcaktuar kështu në Kuran:

"Atyre që fajësojnë femrat e ndershme (për zina) dhe nuk i vërtetojnë dot thëniet e tyre me katër dëshmitarë, bjeruni tetëdhjetë shkopin. Pas kësaj, mos e pranoni më dëshminë e tyre. Ata janë njerëz të mbrapshtë e mëkatarë. Përveç atyre që bëjnë pendesë dhe përmirësohen. Allahu është falës e mëshirues i madh!"⁸⁴

Sipas këtij ajeti, dënimi i shpifjes për nder (zina) është tetëdhjetë shkopin. Në mënyrë të veçantë, pas kësaj, shpifësi e humb të drejtën për të dëshmuar.

Urtësitë e dënimit për shpifje për nder (zina)

Akuzimi shpifës i femrave të lira e të ndershme bëhet shkak për lindjen e shumë fatkeqësive të mëdha në shoqëri. Shpifja e hedhur për një femër të lirë, të virtytshme e të ndershme, fillon të merret nëpër gojë, gjë që njollos jo vetëm atë, por dhe gjithë farefisën dhe të afërmit.

Shkaqet psikologjike të shpifjes për nder mund të jenë të ndryshme. Kryesoret janë ndjenjat e zilisë, smirës, mosdurimit dhe hakmarrjes, që kanë vetëm një synim: ta bëjnë viktimën të vuajë, ta ulin gjer në fund vlerën dhe autoritetin e saj para shoqërisë.

Ja, pra, duke përcaktuar dënimin e shpifjes për nder, feja Islame nisat nga parimi për t'iu kundërvënë këtij synimi. Shpifësi synon ta bëjë viktimën të vuajë, prandaj dhe ai dënohet me goditje me shkopin me qëllim që të heqë një vuajtje të ngjashme edhe trupërisht, edhe psikologjikisht.

Nga ana tjetër, synimi i shpifësit është ta ulë dhe poshtërojë viktimën, Edhe dënimi që i jepet shpifësit, bën që ai të ulet e të poshtërohet në sy të shoqërisë. Veç kësaj, atij i hiqet e drejta për të dëshmuar.

Në të drejtën Islame, për shpifësit për nder janë vënë tre dënime të ndryshme në përshtatje me fajin: e para, ndëshkim trupor me goditje me shkopinj, e dyta, heqja e së drejtës për të dëshmuar dhe, e treta, duke e cilësuar si të mbrapshtë (pervers), shpallja e daljes së tij nga konsiderata e Allahut (xh.xh.). Sëmundshmëria e personave të prirur për shpifje, e cila përbën një sulm dhe përdhunim të qenies individuale dhe shoqërore të njerëzve, mund të mënjanohet vetëm duke praktikuar dënime të tilla.

4. Grabitja dhe pirateria

Faji

Prerja e rrugës të tjerëve, grabitja e tyre me anë të kërcënimit me armë, vrasja e njerëzve të pafajshëm dhe rrëmbimi i mallit që kanë në dorë.

Dënimi

Dënimi i këtij faji përshkruhet në Kuran kështu:

"Dënimi i atyre që luftojnë kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe i atyre që bëjnë të këqija, është ose vrasja e tyre, ose varia, ose prerja tërthore e duarve dhe këmbëve, ose internimi nga vendbanimi. Kjo është për t'i turpëruar ata në botë. Edhe në ahiret për ta ka ndëshkim të madh. Përveç atyre që pendohen para se të kapen."⁸⁵

Sipas shumicës së dijetarëve zbatimi i dënimeve të përcaktuara në Kuran bëhet kështu:

- a) Personat që ngrenë krye haptaz ndaj shtetit mysliman dhe grabisin, dënohen me vdekje vetëm nëse kanë varrë.
- b) Nëse edhe kanë grabitur, edhe kanë varrë, dënohen me vdekje ose me varje.
- c) Personat që grabisin duke e shoqëruar këtë akt me terror dënohen me prerje të një dore dhe të një këmbë të alternuar. Nëse vetëm kanë grabitur, internohen.
- d) Po qe se grabitësi (ose pirati) dorëzohet vetë dhe pendohet për ato që ka bërë rifiton të drejtat e paprekshmërisë së jetës.

Urtësia e dënimit për pirateri dhe grabitje

E drejta Islame jo vetëm mbron nderin dhe dinjitetin e personit, por quan si gjynah (mëkat) të madh edhe sulmin (dhunën) ndaj jetës, pasurisë dhe nderit të tij. Ata që e teprojnë dhe derdhin gjak në shoqëri, dënohen me vdekje. Me ndësh-

85 El-Maide, 33-34.

kimin e personave që kryejnë këto faje, synohet të pastrohet shoqëria nga njerëzit e dëmshëm. Për sigurinë e individit dhe shoqërisë, dënimet e rënda janë të pashmangshme.

Po qe se këto dënime që urdhëron Islami, nuk zbatohen, në shoqëri përhapen anarkia dhe terrori, njerëzit vriten pa vend e pa bërë faj, gratë dhe fëmijët sulmohen e përdhunohen, banesat digjen e shkatërrohen. Kështu, duke marrë masat e duhura për të parandaluar përhapjen e anarkisë dhe terrorit, e drejta Islame ka siguruar formimin e një shoqërie të qetë.

5. Pirja e pijeve alkoolike

Faji

Pirje e pijeve që përmbajnë alkool e që shkaktojnë dehje.

Ajeti që ndalon pirjen e pijeve alkoolike, është kështu:

"O ju që keni besuar! Pijet alkoolike, kumari, falli dhe lojrat e shansit janë punë të fëlliqta të djallit. Qëndroni larg tyre që të shpëtoni. Me pijen dhe kumarin, djalli kërkon të fusë ndërmjet jush urrejtje dhe armiqësi, t'ju pengojë ta përmendni Allahun dhe të faleni. A po hiqni dorë, më në fund, prej tyre?"⁸⁶

Që pija alkoolike të jetë haram dhe faj, nuk varet nga lloji dhe sasia e saj. Profeti ynë (a.s.) ka thënë: *"Çdo pije që jep dehje, është haram!"⁸⁷*

Dënimi

Në Kuran dhe Sunnet është ndaluar haptazi pirja e pijeve alkoolike dhe dehja. Por dënimi nuk është përcaktuar konkretisht. Në kohën e Profetit është zbatuar dënimi me shkopinj në një masë relative sipas vlerësimit të kryetarit të shtetit. Hz. Ebu Bekri ka dhënë dënim me dyzet shkopinj, kursë Hz. Omeri, për analogji me shpifjen për nder, tetëdhjetë shkopinj. Në ekzekutimet e mëvonshme është zgjedhur, përgjithësisht, dënimi me tetëdhjetë shkopinj.

Urtësitë e dënimit për pirjen e pijeve alkoolike dhe dehjen

Feja Islame ka urdhëruar përdorimin e gjërave të dobishme dhe, nga ana tjetër, ndalimin e gjërave të dëmshme. Shqyrtimi mjekësor i ndalimeve të Islamit tregon se ato janë në dobi të individit dhe shoqërisë. Kështu, nga specialistët përkatës janë

86 El-Maide, 90.

87 Muslim, Tirmidhi, Ebu Davud.

treguar dëmet e mëdha materiale e shpirtërore të përdorimit të pijeve alkoolike dhe mishit të derrit.⁸⁸

Allahu i Lartë e ka ndaluar pijen (e ka bërë haram) sepse u shkakton dëme të mëdha mendjes dhe pasurisë së njeriut si dhe jetës së familjes. Para së gjithash, pija dëmton mendjen dhe anormalizon lëvizjet, pastaj vepron mbi sistemin e tretjes dhe të qarkullimit të gjakut. Shpesh pija bëhet shkak për vdekje të çastit. Hadithi profetik thotë: *"Pija është nëna e të këqijave!"*

Çdo produkt që e çrregullon aktivitetin mendor duke e bërë njeriun të mos e dallojë dot të mirën nga e keqja, konsiderohet pije, pavarësisht nëse është produkt i lëngshëm ose i thatë. Edhe të gjitha drogat si opiumi, heroina, etj. kanë të njëjtën cilësi. Në ndryshim nga alkooli, drogat ose të gjitha lëndët narkotike e stupefiantë kanë edhe veprime të posaçme si toksikomania që e rëndojnë edhe më tepër gjendjen e përdoruesve të tyre.

Islami ka ndaluar jo vetëm përdorimin e pijeve alkoolike, por edhe tregtimin e tyre. Hz. Muhammedi (a.s.) ka thënë: *"Allahu ka mallkuar dhjetë vetë për pijet: atë që shtrydh, atë që është shtrydhur për të, atë që pi, atë që transporton, atë që është transportuar për të, atë që jep për të pirë, atë që shet, atë që ha paranë e fituar nga pija, atë që blen dhe atë që është blerë për të..."*⁸⁹

Pas ardhjes së ajetit të sures El-Maide që njoftonte ndalimin kategorik të pijeve alkoolike, Profeti pati thënë kështu: *"Pa dyshim, Allahu e ka ndaluar pijen. Personi që e merr këtë lajm dhe pranë ka pije, të mos pijë e të mos shesë prej saj..."*⁹⁰

6. Kthimi nga feja (irtidat)

Faji

Është kthimi përsëri në mohim dhe ateizëm ose ndërrimi i fesë nga një person pasi e ka mësuar dhe njohur mirë më parë dhe e ka pranuar fenë Islame.

Dënimi

Po qe se ka një shkak shpirtëror ose një dyshim që e ka shtyrë personin të kthehet nga feja, në fillim bëhen përpjekje për mënjanimin e këtyre faktorëve dhe personi ftohet përsëri në Islam. Po u desh, i jepet mundësi për t'u menduar. Po qe se, pavarësisht nga të gjitha këto, personi ngul këmbë për t'u kthyer nga feja, i jepet

88 Shih Jusuf el-Kardavi, el-Helal ve'l-Haram fi'l-Islam, f. 50-53, 75-88.

89 Tirmidhi, Byjy, 59; Ibn Maxhe, Eshribe, 6

90 Muslim, Musakat, 67; shih Buhari, Megazi, 51; Byjy, 93; Fer', 8; Ibni Maxhe, Tixharat, 11; Ahmed b.

dënim me vdekje. Ndërkaq, Ebu Hanife ka pasur opinionin se femrat që kthehen nga feja nuk mund të dënohen me vdekje.

Urtësitë e dënimit për fajin e kthimit nga feja

Feja Islame nuk e shtrëngon askënd të bëhet mysliman si dhe asnjë anëtar të një feje tjetër që ta braktisë fenë e vet. Feja Islame kërkon që personi të bëhet mysliman me vullnetin dhe dëshirën e tij të lirë. Ndërkaq, feja Islame u ka vënë myslimanëve për detyrë që t'u flasin anëtarëve të feve të tjera për të mirat dhe bukuritë e Islamit dhe ka bërë të ditur se kjo detyrë që quhet ftesë dhe kumtim (teblig), është e miratuar nga Allahu.

Myslimani që e ka pranuar Islamin me vullnetin e tij të lirë dhe me dëshirë, nuk mund të largohet nga Islami për të hyrë në një fe tjetër. Kjo liri nuk i është njohur myslimanit. Në Islam, ky largim ka të njëjtën vlerë si tradhtia ndaj atdheut (tradhtia e lartë) në sistemet jomyslimane dhe, si në to, dënohet me vdekje. Në një shoqëri myslimane, personi nuk mund të dalë nga feja dhe pastaj të shëtisë lirisht duke u bërë, me shembullin e tij të keq, element shkatërrues. Ose do të marrë dënimin kapital, ose do të ikë jashtë vendit për të shpëtuar kokën.

7. Kryengritja dhe revolucioni

Faji

Kundërvënien kolektive kundër shtetit, regjimit dhe përpjekje për t'i përmbysur ato me armë.

Dënimi

Në të drejtën Islame, dënimi i fajit të kryengritjes dhe revolucionit është me vdekje.

Kundër kryengritësve veprohet me forcë dhe me armë gjersa kryengritja të shtypet. Por, në ndryshim nga lufta me mohuesit, kryengritësit e ikur nga lufta nuk ndiqen, nuk persekutohen, nuk u merret pasuria, gratë dhe fëmijët nuk u zihen rob. Në lidhje me këtë çështje, në Kuran thuhet:

"Nëse dy grupe myslimanësh përleshën me njëri-tjetrin, pajtojini. Po që se njëri grup e sulmon tjetrin, luftoni kundër tij gjersa të kthehen nën urdhrin e Allahut..."⁹¹

Urtësitë e dënimit për kryengritje dhe revolucion

Faji i kryengritjes është një faj i kryer kundër shtetit Islam dhe atyre që e drejtojnë këtë shtet. Në të drejtën Islame janë marrë masa të ashpra kundër këtij faji sepse kryengritja dhe revolucioni i hapin rrugë çrregullimit, destabilizimit dhe përmbysjes së rendit.

Falja për fajet që kërkojnë dënim të rënde

E drejta Islame nuk i ka njohur askujt kompetencën për të falur fajet që kërkojnë dënim të rëndë. As kryetari i shtetit, as pala e dëmtuar dhe as kujdestari i saj nuk kanë kompetencë për faljen e këtyre fajeve. Edhe nëse pala e dëmtuar ose kujdestari i saj e falin fajtorin, kjo nuk e pengon ekzekutimin e dënimit, sepse ekzekutimi i dënimit është një nevojë dhe domosdoshmëri shoqërore.

B. Fajet që kërkojnë dënim analog

Dënim analog do të thotë dënimi i fajtorit me të njëjtin dëm që i ka shkaktuar viktimës.

Burimi i ndëshkimit analog janë Kurani dhe Sunneti.

Në Kuran thuhet kështu:

"O ju që keni besuar! Në rastet e krimit të vrasjes, juve ju bë farz (detyrim) dënimi me kisas (me të njëjtën mënyrë)..."⁹²

"O ju që mendoni! Në dënimin kisas (me të njëjtën mënyrë) për ju ka jetë. Zbatojini urdhrat që ta ruani veten (nga të këqijat)." ⁹³

Në lidhje me këtë çështje, edhe Profeti ka thënë kështu:

"Kush vret njeri me qëllim, dënimi i tij është kisas (dënim analog)." ⁹⁴

Në të drejtën Islame, fajet që kërkojnë dënim analog janë vrasja me qëllim dhe plagosja apo gjymtimi me qëllim.

1. Vrasja me qëllim

Faji

Vrasja e padrejtë dhe me paramendim e një besimtari. Nuk ka rëndësi nëse vrasja është planifikuar ose jo më parë. Ka rëndësi që, në çastin e kryerjes së krim-

92 El-Bekare, 178.

93 El-Bekare, 179.

94 Ebu Davud, Dijat, 5.

it, personi të niset me paramendim për ta kryer atë. Ndërkaq, meqë paramendimi është një çështje e botës së brendshme të njeriut, për ta kuptuar dhe vërtetuar atë, shihen mjetet e përdorura për vrasjen. Personi që ka përdorur kundër viktimës mjet vdekjeprurës duke i shkaktuar vdekjen pa pasur të drejtë për këtë, konsiderohet kriminel.

Krimi është faji më i rëndë që mund të kryejë një njeri kundër njerëzimit. Prandaj, krimi i vrasjes është trajtuar nga Allahu i Lartë dhe i Dërguari i Tij me urrejtje të madhe.

Kurani e shpreh kështu se krimi i vrasjes me paramendim është një faj i rëndë:

"...Kush vret një njeri që s'ka vrarë e s'ka prishur, ka vepruar sikur të kishte vrarë të gjithë njerëzit. Dhe kush shpëton një njeri, ka vepruar sikur t'i kishte shpëtuar të gjithë njerëzit!.."⁹⁵

"Mos e godisni pa shkak jetën që Allahu e ka bërë të bekuar..."⁹⁶

Për zbatimin e dënimit analog për një person që ka kryer krimin e vrasjes me paramendim, duhet të plotësohen këto kushte:

- a) Fajtori duhet të jetë me zhvillim mendor normal e të ketë mbushur moshën e pubertetit.
- b) Vrasja të jetë bërë me paramendim.
- c) Fajtori ta ketë bërë vrasjen me vullnetin e tij të lirë.
- d) Nuk duhet që vrasja të jetë bërë për shkaqe të tilla si vetëmbrojtja.

Dënimi

Në Kuran është bërë e ditur se personi që ka vrarë një besimtar pa të drejtë dhe me paramendim, në këtë botë, sipas kërkesës së të afërmeve të viktimës, do të marrë dënimin analog me vdekje, kurse në jetën e pasme (ahiret) do të dënohet me ndëshkimin e xhehennemit dhe se, në përgjithësi, mbi të do të bjerë mallkimi dhe ndëshkimi i Allahut:

"O besimtarë! Në ngjarjet e vrasjes, kisasi (dënimi analog) u bë për ju farz. Për të lirin, (vritet) i liri, për skllavin, skllavi, për femrën, femra. Kisasi bie nëse trashëgimtari i viktimës e fal vrasësin..."⁹⁷

95 El-Maide, 32.

96 Isra, 33.

97 El-Bekare, 178.

"Kush vret një besimtar me paramendim, dënohet me xhehenem, ku ka për të mbetur përjetësisht. Allahu e ka dënuar, e ka mallkuar dhe ka përgatitur për të një ndëshkim të madh!"⁹⁸

Juristët Islamë janë të një mendimi për ekzekutimin e dënimit analog për krimin e vrasjes me paramendim.

Krimi i vrasjes vjen në krye të akteve që kërkojnë dënimin analog. Ngjarjet e vrasjes në të drejtën Islame mund të mblidhen në tre grupe:

1) Vrasje me paramendim.

2) Vrasje aksidentale.

3) Shkaktim i vdekjes së një njeriu për një gabim, pakujdesi dhe nënvleftësim, si dhe moskryerje e një veprimi të caktuar. (I tillë është rasti i hapjes pa leje të një grope në një vend që i përket përdorimit publik, lënies hapur të saj dhe, si pasojë, i rënies së një personi në të dhe i vdekjes së tij).

Ndër këto tre raste, vetëm për rastin e parë jepet dënimi analog (me vdekje).

2. Plagosja dhe gjymtimi

Faji

Plagosje ose gjymtim i një apo disa organeve.

Dënimi

Në të drejtën Islame, edhe për plagosjen apo gjymtimin zbatohet dënimi analog (kisas).

Në Kuran urdhërohet:

"...për jetën, me jetë; për syrin, me sy; për veshin, me vesh; për dhëmbin, me dhëmb (dënohet). Edhe plagosjet dënohen me kisas..."⁹⁹

Organet ku zbatohet dënimi analog në ngjarjet e plagosjeve dhe gjymtimeve, përcaktohen me hadithe. Ndëshkimet që jepen për raste të tjera veç këtyre, i janë lënë vlerësimit të gjykatësve.

Falja në fajet që kërkojnë dënim analog

Në ngjarjet e vrasjeve me paramendim kujdestarëve të viktimës (të afërme që marrin pjesë nga trashëgimia e tij) u është lënë kompetenca për të kërkuar për fajto-

98 En-Nisa, 93.

99 El-Maide, 45.

rin dënim analog dëmshpërblim material ose falje. Organet shtetërore nuk kanë kompetencë për të dhënë falje për këto dënime. Nëse njëri prej kujdestarëve të viktimës nuk e kërkon zbatimin e dënimit analog, dënimi analog bie.

Lidhur me këtë çështje, në Kuran urdhërohet kështu:

"O besimtarë! Në ngjarjet e vrasjes, kisasi (dënimi analog) u bë për ju farz. Për të lirin, (vritet) i liri, për skllavin, skllavi, për femrën, femra. Kisasi bie nëse trashëgimtari i viktimës e fal vrasësin. Pas kësaj duhet parë e mira, kujdestarit të të vrrarit i duhet paguar një dëmshpërblim i mirë e i plotë. Kështu, këto janë një lehtësi dhe mëshirë nga Zoti juaj. Dhe, për atë që, pas kësaj, ngrihet për të goditur, ka, pa dyshim, një ndëshkim të dhimbshëm!"¹⁰⁰

Dëmshpërblimi material

Dëmshpërblimi material është një sasi e caktuar vlere materiale në mall ose monedhë, që u jepet të afërmeve të viktimës së plagosur, të gjymtuar apo të vrrarë.

Në lidhje me çështjen e dëmshpërblimit, Kurani urdhëron:

"Me përjashtim të rasteve pa dashje, një besimtar nuk ka të drejtë të vrasë një besimtar tjetër. Kush vret një besimtar pa dashje, duhet të çlirojë një skllav (ose rob) dhe, në mënyrë të posaçme, t'i japë një dëmshpërblim familjes së të vrrarit. Po qe se familja e të vrrarit e fal dëmshpërblimin, nuk e jep."¹⁰¹

Në Kuran është përcaktuar dënimi i vrasjes pa dashje të një besimtari.

Po qe se familja e të vrrarit është myslimane, vrasësi i nënshtrohet dy lloj dënimeve: i jep dëmshpërblim familjes së të vrrarit dhe, si kundërvlerë të aktit (keffaret), çliron një skllav (rob). Me këtë çlirim, vrasësi i zëvendëson shoqërisë jetën që i ka marrë pa dashje. Po qe se nuk ka mundësi të çlirojë një skllav (rob), jep dëmshpërblim dhe agjëron dy muaj pandërprerë.

Nëse i vrari i përket një popullate jomyslimane armike, vrasësi nuk jep dëmshpërblim për të mos e fuqizuar ekonomikisht armikun.

Por po qe se i vrari i përket një popullate me të cilën myslimanët janë në marrëveshje, vrasësi jep dëmshpërblim dhe kundërvlerë (keffaret).

Qysh në krye është bërë e ditur se dënimi që i jepet personit që vret padrejtësisht dhe me paramendim një mysliman, është analog (kisas). Kurse kompetenca për falje i është dhënë vetëm të afërmeve (trashëgimtarëve) të të vrrarit, të cilët, po të

100 El-Bekare, 178.

101 En-Nisa, 92.

duan, mund të kërkojnë, në vend të dënimit analog të vrasësit, dëmshpërblim. Madje mund të mos kërkojnë as dënimin analog të vrasësit, as dëmshpërblim. Në këtë rast, shteti ka kompetencën për të dhënë një dënim më të lehtë.

Në përgjithësi, masa e dëmshpërblimit që përshkruhet në tekstet e shenjta (nass) është njëqind deve ose kundërvlera e tyre në produkte të tjera. Kjo masë quhet "dëmshpërhiim i plotë". Gjykatësi nuk ka kompetencë për ta ndryshuar këtë masë. Në plagosjet apo gjymtimet, masa e dëmshpërblimit ndryshon në vartësi të rëndesës së fajit të kryer. Për organet tek jepet dëmshpërblim i plotë, kurse për secilin nga organet çift jepet gjysmë dëmshpërblim. Kurse në situatat, të cilat nuk trajtohen në tekstet e shenjta, masën e dëmshpërblimit e përcakton gjykatësi.

Urtësitë e dënimit analog (kisas)

E drejta penale Islame ka pranuar një sistem ndëshkimi, që synon ndëshkimin e fajtorit, mbrojtjen e të drejtave të viktimës kënaqjen e ndërgjegjes publike dhe parandalimin e përsëritjes së fajit.

Allahu i Lartë e ka bërë detyrim (farz) dënimin analog (kisas) me qëllim për ta mbrojtur jetën e njerëzve, për t'i marrë nën mbrojtje njerëzit e mirë dhe për ta parandaluar mosmarrëveshjen (që mund të çojë gjer në vrasje) kur ajo është ende e vogël. Parandalimi i krimit, moskryerja e tij bëhet pretekst edhe për shpëtimin e vrasësit të mundshëm nga rënia në një krim të tillë, edhe për shpëtimin e njerëzve të tjerë nga rënia në një krim të tillë, edhe për ndalimin mes popullit të veprimeve armiqësore e dhunuese.

Personi i cili, duke u frikësuar nga dënimi analog, heq dorë nga vrasja e vëllait mysliman, e shpëton edhe jetën e vet, edhe jetën e personit që kishte ndërmend të vriste.

Nëse një person që ka bërë vrasje, shëtit i lirë pa u ndëshkuar, kjo bëhet pretekst për përhapjen e mosmarrëveshjeve, grindjeve dhe krimeve, për zhdukjen e sigurisë së jetës dhe derdhjes së gjakut me anë të ndjenjës së hakmarrjes, sepse armiqësia ndaj vrasjes është në natyrë të njeriut. Islami ka vënë dënimin analog (kisas) me qëllim për të mënjанuar urrejtjen, armiqësinë dhe dhunën.

Pasi e ka bërë detyrim (farz) dënimin analog, feja Islame, nga ana tjetër përvi-
jon kufinjte e këtij dënimi dhe nxit e inkurajon faljen. Pasi ka bërë të ditur vendimin për dënimin analog, nxitja dhe inkurajimi që i bën Allahu i Lartë anës së vik-
timës për ta falur fajtorin, është ftesë për sigurimin e drejtësisë dhe për lartësimin
shpirtëror të anës së viktimës në rrugën e besimit dhe bindjes ndaj Zotit, sepse falja
është një ndër atributet e Tij. Në Kuran thuhet: "... dhe, po qe se viktimës i dhuro-

het diçka nga i vëllai (mysliman), kjo le të përcillet me të mirë..."¹⁰² Me këtë ajet, dënimi analog është kthyer, nga urrejtje dhe armiqësi, në një kuptim të lartë. Popujt e shkuar, me qëllim për të marrë shpagim nga fajtori apo fajtorët, nuk pranonin në asnjë mënyrë të falnin apo të merrnin dëmshpërblim. Ata e ndëshkonin fajtorin. Shpesh herë, për një të vrarë vriteshin njëqind vetë duke u krenuar për këtë.

Allahu i Lartë, i cili na thotë, "**në kisas për ju ka jetë**" dhe jo shpagim, e ka fjalën për paqen shoqërore që siguron ky lloj dënimi.

Në shikim të parë, ekzekutimi i vrasësit mund të duket si veprim i dhunshëm dhe mund të mendohet se ai duhet të shpëtohet nga vdekja duke u treguar të mëshirshëm ndaj tij. Mirëpo, më parë dhe posaçërisht duhet treguar mëshirë për të vrarin. Po që se tregohet mëshirë për vrasësit dhe kriminelët, nuk tregohet mëshirë për viktimat dhe gjithë shoqërinë, inkurajohen elementët destruktivë, kriminelë dhe shoqëria vihet para një dhune edhe më të madhe. Atëherë, pengimi i ngjarjeve të përdhunshme e kriminale që vijnë gjithmonë duke u shtuar, bëhet i pamundur.

C. Fajet që kërkojnë dënim me riedukim

Fjala *tazir* do të thotë urtësim, sjellje në rrugë të drejtë, edukim (riedukim). Kurse në terminologjinë e të drejtës Islame, me termin *tazir* emërtohen dënimet që cakton dhe zbaton shteti Islam për fajet për të cilat nuk ka dënime në Kuran ose hadithe, si dhe për disa mëkate (gjynahe). Duke i caktuar këto dënime, organet e shtetit Islam janë të detyruara t'u mbeten besnike parimeve dhe rregullave të fesë.

Fajet që futen në grupin e fajeve, për të cilat jepen dënime të nivelit dhe karakterit *tazir*, *riedukues*, janë këto:

1. Moszbatimi i një urdhri çfarëdo ose mosrespektimi i një ndalimi çfarëdo të fesë Islame, si: kamata, tradhtimi i amanetit, fyerja, mita (rushfeti), mashtrimet në matje dhe peshim, shmangia nga dhënia e zeqatit, përvetësimi dhe përdorimi i mallit haram dhe moskryerja e adhurimeve të formave të përcaktuara në shariat.

2. Mosrespektimi i rregullave (nënligjeve) të nxjerra nga organet kompe- tente të shtetit me qëllim për të siguruar rendin shoqëror, pra, fajet (kundër- vajtjet) që përbëjnë prishje të rendit shoqëror dhe publik, si të qarkuliimit rrugor, sistemit mësimor-edukativ; fajet (kundërvajtjet) ndaj rregullimeve ndërprofesionale, rregullave dhe udhëzimeve për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore, për luftën kundër sëmundjeve, etj.

102 El-Bekare, 178.

3. Fajet që kërkojnë dënim të rëndë apo analog, por që, për shkak të mosplotësimit të kushteve përkatëse, mbeten të pavërtetuara (parealizuara), si faji i vjedhjes së frutave që janë produkte që prishen për një kohë të shkurtër. Fajtorit nuk i jepet dënimi i rëndë përkatës, por edhe pa u ndëshkuar nuk mund të lihet, prandaj, sipas vlerësimit të gjykatësit, personi merr një dënim të karakterit riedukues (tazir).

Juristët Islamë kanë pranuar se për fajet që kërkojnë ndëshkime të karakterit riedukues, mund të jepen ndëshkime të tilla, si: gjobë, burgim, goditje me shkopinj, kufizim lirie, heqje nga detyra ose internim. Por dënimet e këtij karakteri nuk janë të kufizuara me këto. Organet e shtetit mund të përcaktojnë dënime në përputhje me kushtet e kohës. Ndërkaq, në dënimet me goditje (rrahje) me shkopinj, masa e dënitimit nuk duhet ta kalojë kufirin e poshtëm të masës së ndëshkimit përkatës në dënimet e rënda.

Ashtu si dënimet e rënda, edhe dënimet riedukuese ekzekutohen nga shteti.

Falja për fajet që kërkojnë dënim me riedukim

Në fajet që kërkojnë dënim riedukues, kryetari i shtetit ka kompetencë për të falur. Ndërkaq, kjo kompetencë e kryetarit të shtetit është e kufizuar nga tekstet e shenjta, nga parimet dhe rregullat e përgjithshme të fesë. Falja e dhënë duhet të synojë dhe shpresojë ose një përfitim publik, ose parandalimin e një dëmi të mundshëm. Në mënyrë të veçantë, falja e dhënë nga kryetari i shtetit nuk duhet të jetë në dëm të palës së dëmtuar.

Por nuk ka falje për fajet që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të personit, sepse gjykatësi nuk e ka një kompetencë të tillë. Vetëm pala e dëmtuar ose kujdestari i saj e kanë në dorë për të falur një shkelje të të drejtave të personit.



Lexim letrar

Edhe sikur ime bijë Fatime të ishte ...

Në Islam, të gjithë janë të barabartë para ligjit. Askujt nuk i njihet e drejta e paprekshmërisë. Ndoshta në këtë pikë shfaqen përgjegjësitë më themelore e më të mëdha të administratës, qeveritarëve dhe nëpunësve. Një trajtim i një rasti nga Profeti ka vlerë të madhe domethënëse e përgjithësuese.

Fatime bin Esved e familjes së fuqishme kurejshe të të bijve Mahzum kishte vjedhur, gjë që i kishte dëshpëruar shumë dhe i kishte vënë në lëvizje kurejshët. Ata nisën të kërkojnë një zgjidhje dhe vendosën të dërgojnë te Profeti si ndërmjetës Usame bin Zejdin që ai e donte shumë.

Usame bin Zejdi (r.a.) ia parashtroi çështjen Profetit (a.s.). Profeti ia tërhoqi vërejtjen Usames kështu:

"... Ti po merr përsipër të ndërmjetësosh për një dënim të rëndë të urdhëruar nga Allahu?.."

Usame kërkoi falje.

Më pas, në një bisedë me myslimanët, Profeti e parashtroi çështjen kështu: **"O myslimanë! Allahu i ka shkatërruar ata që kanë jetuar para jush sepse, kur një njeri i pasur, fisnik e i fuqishëm vidhte, e falnin, kurse kur vidhte një njeri i varfër, i zakonshëm e i dobët, i jepnin menjëherë dënim të rëndë! Beto hem në Allahun se edhe sikur të ishte ime bijë Fatime, do t'ia kisha prerë dorën!"**¹⁰³

Hz. Aisheja tregon se ajo grua bëri një pendim të mirë, u martua dhe pati vajtje-ardhje me të.¹⁰⁴

103 Buhari, Hudud, 12; Megazi, 53; Muslim, Hudud, 8, Ebu Davud, Hudud, 4; Nesai, Sarik, 6; Ibni Maxhe, Hudud, 6; Darimi, Hudud, 5; Ahmed b. Hanbel, VI, 162.

104 shih Muslim, Hudud, 9.

Në një hadith të tij, Profeti (a.s.) porositi:

"Ai, ndërmjetësimi i të cilit bëhet pengesë për zbatimin e njerit prej urdhrave të Allahut, i kundërvihet urdhrin të Allahut!"¹⁰⁵

Ashtu siç nuk mund të ndërmjetësohet në asnjë mënyrë për dënimet e caktuara nga Allahu dhe i Dërguari i Tij, ashtu dhe për asnjë arsye nuk duhet shmangur nga ekzekutimi i tyre. Në këtë çështje nuk duhet parë as identiteti dhe personaliteti i fajtorit. Autoriteti dhe konsiderata që gëzojnë administrata, qeveritarët dhe nëpunësit, mbështetet në drejtësinë e tyre ndaj qytetarëve, në mbrojtjen e të drejtës dhe ligjeve. Allahu i Lartë ka thënë: **"Personi që shkel kufirin (ligjin) e caktuar nga Allahu, i bën padrejtësi vetvetes!"¹⁰⁶** Kështu, mosekzekutimi i një vendimi do të thotë, të paktën, mospëlqim i atij vendimi. Robi nuk e ka të drejtën për të mbajtur një qëndrim të tillë negativ ndaj vendimeve të Allahut!

Të gjitha këto vlerësime tregojnë në mënyrën më të hapur se me ç'seriozitet trajtohet në Islam çështja e të drejtës, se para urdhrave dhe ndalimeve të Allahut të gjithë janë të barabartë dhe se askujt nuk i njihet ndonjë përjashtim apo privilegj.



105 Ebu Davud, Akdije, 14; Ahmed b. Hanbel, II, 70, 83.

106 Kurani, Et-Talak, 1.

PËRMBAJTJA

PJESA I

FAMILJA NË ISLAM

A. RËNDËSIA E FAMILJES	9
B. DOBITË E MARTESËS	9
C. CILESITË THEMELORE QË DUHET TË KETË FAMILJA	12
D. RËNDËSIA E EDUKIMIT TË FËMIJËVE NË FAMILJE	14
Lexim letrar: <i>Mirëkuptimi në familje</i>	16

PJESA II

KURORA DHE SHKURORËZIMI	19
A. TERMI DHE KUADRI I KURORËS (NIKAH)	21
B. ARGUMENTET MBI LEGJITIMITETIN E MARTESËS	21
C. KUSHTET E VLEFESHMËRISË SË KURORËS	22
D. TË DRETAT DHE PËRGJEGJËSITË E LINDURA NGA MARTESA LEGJITIME	24
Lexim letrar: <i>Detyrat në familje</i>	26
E. MEHRI DHE NAFKA	28
1. Mehri	28
2. Nafaka	30
Lexim letrar: <i>Molla</i>	34

F. NDARJA (TALAK)	36
A. Ndarja me kthim të mundshëm ose të pamundshëm	36
B. Ndarja sipas rregullave e jo sipas rregullave	37
C. Ndarja me kundërshtëpërbim (muhalaa).....	38
D. Zgjidhja e martesës (me anë të gjykates).....	39
Lexim letrar: <i>Bëhu mysliman, të martohem</i>	40
Lexim letrar: <i>Shko pajtohu!</i>	42

PJESA III

TREGTIA NË ISLAM	45
A. TREGTIA NË KURAN DHE SUNNET	47
B. TREGTIA DHE RRUGËT E FITIMIT NË ISLAM	48
C. GJËRAT QË DUHET TË KETË KUJDES TREGTARI MYSLIMAN	50
D. POROSITË E PROFETIT TONË MBI TREGTINË	53
Lexim letrar: <i>Shko pajtohu!</i>	55

PJESA IV

SHITBLERJA DHE ORTAKËRITË TREGTARE	57
A. KUSHTET E SHITBLERJES	59
B. FORMAT E SHITBLERJES	60
C. ORTAKËRITË (SHOQËRITË) TREGTARE	61
1. Kuptimi i ortakërive (shoqërive) tregtare	61
2. Llojet e ortakërive	62
Lexim letrar: <i>Allahu mjafton si dorëzanës!</i>	63

PJESA V

ÇËSHTJE TË NDRYSHME TË JETËS TREGTARE E SHOQËRORE.... 67

A. ÇËSHTJE TË NDRYSHME LIDHUR ME TREGTINË	69
1. Kufiri i fitimit (Sâr haddi)	69
2. Mashtrimi i skajshëm (gabn-i fahish)	69
3. Gënjeshtra dhe mashtrimi i qëllimshëm (tagrir)	70
4. Akaparimi dhe tregu i zi (ihtikar)	71
B. ÇËSHTJE AKTUALE LIDHUR ME TREGTINË	72
1. Këmbimi i devizës dhe monedhës (sarf)	72
2. Bursa, senetet (vërtetimet) dhe dividendët e aksioneve	72
3. Sigurimet	73
C. ÇËSHTJE TË NDRYSHME LIDHUR ME JETËN SHOQËRORE	74
1. Qiraja	74
2. Marrëdhëniet punëtor-punëdhënës	75
3. Dhënia e bukur (kard-i hasen)	78
4. Amaneti	78
5. Malli i gjetur	79
6. Vakfet	80
Lexim letrar: <i>Dhënia e bukur</i>	82

PJESA VI

E DREJTA PENALE ISLAME FAJET DHE NDËSHKIMET..... 85

A. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI FAJET DHE NDËSHKIMET	87
B. QËLLIMET E SISTEMIT PENAL ISLAM	87

C. FAJET DHE NDËSHKIMET	88
A. Fajet që kërkojnë dënim të rëndë	88
B. Fajet që kërkojnë dënim analog	100
C. Riedukimi dhe fajet që kërkojnë riedukim	105
Lexim letrar: <i>Edhe sikur ime bijë Fatime të ishte</i>	107
PËRMBAJTJA	109

[illegible]